



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

PUNIM
MAGJISTRATURE

TEMA: "Procesi i organizimit të politikës së jashtme dhe diplomacia e Kosovës që nga shtetformimi"

Mentori:
Prof. dr. Veton Latifi

Studentja:
Laura Laçi
ID:117684

Shkup, 2019

Përmbajtja

Abstrakt

Hyrje

Pjesa 1. Vështrim i shkurtër mbi historinë e diplomacisë shqiptare

1.1. Zhvillim historik i diplomacisë shqiptare

1.2. Detyrat e diplomacisë

1.3. Diplomacia e Kosovës që nga organizimi i luftës së UÇK-së e deri në shpalljen e pavarësisë

1.3.1. Diplomacia në rrethana lufte

1.3.2. Diplomacia nën administrimin e UNMIK-ut

1.4. Pavarësia dhe formimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme

Pjesa 2. Diplomacia dhe politika e jashtme

2.1. Ç'është politika e jashtme?

2.2. Procesi i organizimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës

2.2.1. Organizimi i rrjetit diplomatiko-konsullor

2.3. Politika e jashtme e Kosovës në periudhën 2008-2017

2.4. Sfidat aktuale të politikës së jashtme të Kosovës

Pjesa 3. Pjesa empirike - intervistat

3.1. Sfidat e formësimit të diplomacisë së Kosovës

3.2. Diplomacia dhe politika e jashtme e Kosovës pas pavarësisë

3.3. Një dekadë rezultate dhe ngecje

3.4. Konkluzionet e intervistave

4. Përfundime

5. Literaturë e shfrytëzuar

Abstrakt

Diplomacia është bërë një lëmi shumë atraktive për studiuesit, por edhe në praktikë nga zbatuesit e saj. Ky hulumtim fokusohet kryesisht në diplomacinë dhe politikën e jashtme të Kosovës që nga shtetformimi në tërësi, zanafillën e diplomacisë, politikën e jashtme dhe rolin e tyre në konsolidimin e paqes dhe shtetësisë së Kosovës.

Në hulumtimin tonë është studiuar diplomacia dhe mënyra e organizimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës. Ky hulumtim ofron disa argumente teorike dhe praktike, që kanë të bëjnë me diplomacinë dhe politikën e jashtme dhe rolin e saj, veçanarisht në rastin e Kosovës. Qëllimi kryesor i këtij punimi hulumtuesh-kencor është që të krijojë një perceptim të plotë për procesin e organizimit të politikës së jashtme dhe për diplomacinë e Kosovës që nga pavarësimi i saj, përmes rrugës së komparacionit, analizave dhe intervistave. Gjithashtu, punimi jep një perceptim të plotë të nocionit diplomaci dhe politikë e jashtme, gjatë të cilit kjo magjistraturë do të paraqiste një punim të krijuar dhe të përpiluar në mënyrë të shkëlqyer, i cili në të ardhmen do të ofronte informacione dhe shembuj të mirë, si dhe të dhëna për temën e cila është lëndë e këtij hulumtimi.

Andaj, një ndër objektivat parësore të këtij hulumtimi, janë ato që kanë të bëjnë me përpjekjen për t'u ofruar lexuesve një sfond të përmbledhur analitik dhe profesional lidhur me diplomacinë dhe politikën e jashtme të Kosovës që nga shtetformimi.

Fjalët kyç: Diplomaci, politika e jashtme, arena ndërkombëtare, shtetformësimi

Abstract

Diplomacy has become a very attractive field for researchers but also in practice by its implementers. This research is mainly based on the diplomacy and foreign policy of Kosovo since the statehood as a whole, the origin of diplomacy, foreign policy and their role in consolidating Kosovo's peace and statehood.

Our research focuses on studying the diplomacy and the Ministry of Foreign Affairs of Kosovo. It provides some theoretical and practical arguments that relate to diplomacy and foreign policy and its role, especially in the case of Kosovo. The main purpose of this research work is to create a complete perception of the process of organizing foreign policy and diplomacy of Kosovo since its independence through the way of comparison, analysis and interviews. In addition, the paper gives a complete perception of the notion of diplomacy and foreign policy, during which this master's degree would be a well-created and compiled work that would in the future provide good information and examples, as well as data on the subject that is the subject of this research.

Therefore, one of the primary goals of this research is that of trying to provide readers with a comprehensive analytical and professional background on Kosovo's diplomacy and foreign policy since its statehood.

Hyrje

Tema e magjistraturës "Procesi i organizimit të politikës së jashtme dhe diplomacia e Kosovës që nga shtetformimi" synon një hulumtim të gjerë dhe gjithëpërfshirës mbi diplomacinë si një veprimtari shumëdimensionale, por edhe specifike në rrethanat e studimit tim që ndërlidhet me shtetin e Kosovës. Tashmë e kemi të qartë se Kosova si entitet politiko-shtetëror ka kaluar nëpër disa faza, të cilat shënojnë edhe një rrugëtim me shumë sfida për atë që njihet si funksion i diplomacisë.

Pikërisht për ta studiuar shumë më thellë dhe për ta përfshirë gjithë suazën teorike-konceptuale të diplomacisë, si dhe për ta vendosur atë si një platformë për punimin tonë, ne kemi shfrytëzuar disa burime teorike duke e shtrirë hulumtimin ndër vite dhe në përvojat e mëhershme të diplomacisë, përkatësisht të vetë fillimit të shfaqjes së saj si një veprimtari esenciale në raportet ndërnjerëzore, dhe më vonë, edhe në raportet ndërmjet shteteve.

Studimi dhe shpalimi i diplomacisë së Kosovës, në asnjë rast nuk mund të kuptohet pa këto aspekte të përgjithshme dhe historike të saj, të cilat më pas marrin trajtë edhe në rrethanat specifike të ndërtimit të diplomacisë së Kosovës. Janë disa periudha të cilat realisht e reflektojnë formësimin e diplomacisë së Kosovës, të cilat bartin në vete specifikat e tyre. Periudha para luftës së Kosovës i ka specifikat e veta dhe gjen shtrirje edhe në vitet e një rezistence që nga koha e ish Jugosllavisë, kur realisht shfaqet edhe ideja për një shtet të pavarur, ndërkohë që fillon të performohet një komunikim ndërkombëtar i përfaqësuar nga Ibrahim Rugova si bartës i këtij procesi të pavarësisë nëpërmjet obsionit politik paqesor të kultivuar prej tij dhe LDK-së të cilën e udhëhiqte.

Fazë tjetër e diplomacisë së Kosovës është ajo e periudhës së luftës, e cila gjithashtu i ka specifikat e veta. Në këtë fazë një rol vendimtar merr përfaqësimi ndërkombëtar nga ana e përfaqësuesve të luftës, përkatësisht të UÇK-së, por edhe subjekteve të tjera të Kosovës, gjithnjë në rrethanat specifike të asaj kohe.

Diplomacia kosovare e pasluftës gjithashtu mbetet një fazë tjetër deri në shpalljen e pavarësisë kur edhe realisht nis të konstituohet Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, e cila tashmë në mënyrë profesionale fillon ta kultivojë përfaqësimin

ndërkombëtar. Kjo është faza e institucionalizimit të plotë të diplomacisë së Kosovës e cila njih shumë sfida, por njëkohësisht edhe shumë suksese që ndërlidhen me procesin e njohjes së subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit më të ri në Evropë, pra Kosovës.

Pikërisht duke u përvijuar në këtë materie dinamike të diplomacisë së Kosovës, ne gjatë punimit tonë këto i kemi trajtuar në kapituj të veçantë, gjithnjë duke pasur si mbështetje materialet e grumbulluara, autorët që kanë shkruar për diplomacinë përgjithësisht, por edhe intervistat me shumë protagonistë të politikës së jashtme të Kosovës, që si material empirik e kemi gërshetuar me gjithë suazën teoriko-konceptuale të studimit të diplomacisë së Kosovës.

Për të krijuar një pasqyrë sa më të plotë mbi diplomacinë e Kosovës, në punimin tonë kemi sjellë edhe aspekte të diplomacisë shqiptare, duke filluar që nga kohët më të hershme e deri në formimin e shtetit modern shqiptar. Kjo trashëgimi e diplomacisë shqiptare është gërshetuar më pas edhe me trashëgiminë diplomatike në Kosovë, si dhe me formulimet teorike-historike të diplomacisë në rrafshin e trashëgimisë botërore, përkatësisht të shfaqjeve të para të diplomacisë.

Diplomacia konsiderohet si forma më e vjetër e komunikimit të ndërsjellë ndërmjet shteteve. Format e para të krijimit të diplomacisë i hasim qysh në periudhën e bashkësive fisnore të cilat kanë qenë të afta jo vetëm për komunikime luftarake, por edhe për negociata e marrëveshje. Për zhvillimin e diplomacisë rol të rëndësishëm kanë patur qytetet-shtete greke.

Faza fillestare e diplomacisë përfshin periudhën deri më vitin 1648, pra deri në Kongresin e Uestfalisë.¹ Prej vitit 1648 e deri më vitin 1920 kemi diplomacinë klasike me karakteristikat e saj. Diplomacia moderne përfshin periudhën prej vitit 1920 e deri në vitin 1989, ku prej vitit 1989 e deri në ditët e sotme kemi të bëjmë me diplomacinë postmoderne e cila është diplomaci e hapur.²

¹ Milan Jazbec, "Bazat e Diplomacisë", Kolegji Universitar "Victory" dhe Instituti i Hulumtimeve Shkencore "Victory", Prishtinë, 2008, fq. 26.

² Aty, fq. 38.

Siç e theksuam, me qëllim që të krijojmë suazën e nevojshme, kemi shfrytëzuar një sistem referencial të gjerë për ta strukturuar në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse lëndën e trajtuar në këtë punim.

Pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ka patur një proces shumë të suksesshëm të njohjeve të saj, më pastaj ka ngelur komuniteti i shteteve që nuk kanë interes të mjaftueshëm për ta njohur shtetësinë e saj, si dhe i disa shteteve të cilat, për arsye të ndryshme, janë totalisht kundër njohjes së Kosovës. Rrjedhimisht çështja e njohjes nga këto shtete bëhet më e vështirë dhe më sfiduese. Mosnjohja nga pesë vende të BE-së paraqet një problem të veçantë dhe e bën edhe më të komplikuar procesin e konsolidimit të pozitës ndërkombëtare të shtetit të ri të Kosovës.

Politika e jashtme është një strategji e qeverisë të cilën e përdorë për t'i drejtuar aksionet e veta në arenën ndërkombëtare në raport apo përballë shteteve të tjera.

Për sa i përket politikës së jashtme të Kosovës, kjo fillon pas pavarësimit më 2008, megjithatë aktivitete diplomatike janë zhvilluar edhe në periudhën e paraçlirimit në kuadër të institucioneve paralele të qeverisë Bukoshi dhe presidentit Rugova, pastaj gjatë periudhës së luftës kur UÇK-ja i kishte përfaqësuesit e vet. Kosova pas çlirimit, sigurisht me Rezolutën 1244 nuk kishte kompetenca në politikën e jashtme, por aktiviteti diplomatik nuk mungoi nga institucionet që u krijuan, sidomos gjatë periudhës rreth dyvjeçare të negociatave para statusit që e sollën Pakon e Ahtisarit dhe pastaj shpalljen e pavarësisë. Sot, nëntë vite pas pavarësisë, Kosova ende përballet me vështirësi dhe duhet të përfitojë nga përvojat e vendeve të tjera, në mënyrë që të identifikojë ndonjë segment më specifik që do ta ketë prioritet në politikën e vet të jashtme. Politika e jashtme e Kosovës është orientuar për arritjen e objektivave të veta si anëtarësimi në OKB dhe fitimi i njohjeve të reja ndërkombëtare.

Lënda e hulumtimit të këtij punimi për magjistraturë paraqet politikën e jashtme të Kosovës dhe diplomacinë e saj që nga shtetformimi, me theks të veçantë për procesin e organizimit të diplomacisë dhe politikës së jashtme të Kosovës pas pavarësisë së saj.

Krijimi i Ministrisë së Jashtme menjëherë pas aktit të pavarësisë, duke vazhduar më pas me ndërtimin e rrjetit të misioneve diplomatike dhe konsullore, janë sfida e madhe për shtetin e ri për shkak të kufizimeve me kuadër, me financa dhe organizim.

Duke u nisur nga lënda dhe qëllimet e kësaj magjistrature, si dhe kompozimit të saj në përgjithësi, krahas hyrjes dhe shqyrtimeve përfundimtare, punimi është strukturuar në tri pjesë të tjera. Secila nga këto njësi paraqet një hulumtim dhe analizë më vete, dhe në të njëjtën kohë shënon konceptualisht edhe fazat e formësimit të diplomacisë së Kosovës.

Pjesa e parë “Vështrim i shkurtër mbi historinë e diplomacisë shqiptare” jep një pasqyrë më të gjerë të saj, duke u ndalur veçmas në shpjegimin edhe formulimin e nocionit diplomaci, rolin dhe karakteristikat e saj, si dhe shtrirjen diakronike në realitetin historik shqiptar.

Pjesa e dytë “Diplomacia dhe politika e jashtme ” trajton trajektoren e zhvillimit të diplomacisë dhe politikës së jashtme të Kosovës me gjithë sfidat dhe rrugëtimin që ka bërë. Kjo njësi në punimin tonë përpiket t’u japë përgjigje të gjithë shfaqjeve të diplomacisë dhe politikës së jashtme tashmë të konsoliduar në aspektin institucional.

Pjesa e tretë është ajo e intervistave me protagonistë të jetës diplomatike, e cila përmban qasje me të cilat në bazë të pyetësorit hulumtohen të dhënat, informacionet, mendimet për lëndën e saj. Intervistat si material empirik sigurojnë më tepër informacion për të gjitha fazat e diplomacisë së Kosovës dhe njëkohësisht shpalosin edhe qasjen, angazhimet, horizontin e politikës së jashtme të saj.

Për nevojat e përgjithshme të kësaj magjistrature janë përdorur të dhëna primare dhe sekondare. Kështu të dhënat e nevojshme janë siguruar nga literatura profesionale, e cila tërësisht është e përshtatshme dhe e lidhur me problematikën e lëndës së punimit në fjalë. Gjatë përgatitjes kam shfrytëzuar literaturë relevante, botime, intervista, tekste shkencore etj. Po ashtu, në përgatitjen e këtij punimi janë përdorur metodat kualitative si dhe kuantitative, siç janë:

- ❖ Analiza
- ❖ Komparacioni
- ❖ Intervista

Qasja dhe metodologjia e aplikuar në këtë punim krijon suazën e domosdoshme të strukturimit të lëndës, por edhe procedimin me hipotezat fillestare, të cilat në këtë rast, përmes analizës, komparacionit dhe intervistave, marrin kuptimet dhe argumentimin e duhur në gjithë planimetrinë e organizimit të mëtejshëm. Gërshetimi i metodologjive i jep punimit tonë reflektimin e duhur në trajtim dhe mundësinë për t'u shtjelluar në mënyrë objektive teza në dy aspektet e tij, si koncept dhe si shtrirje kohore.

Ne jemi të bindur se, në qoftë se teza e këtij punimi analizohet nga aspekti konceptual, gjithsesi do të krijojë një perceptim shumë më kualitativ për diplomacinë si një fushë specifike dhe në të ardhmen do t'i shërbejë një numri të madh studentësh dhe personash që merren me sferën ndërkombëtare dhe atë të diplomacisë.

Ky punim hulumtues-shkencor sjell një perceptim të plotë për procesin e organizimit të politikës së jashtme dhe diplomacinë e Kosovës, që nga pavarësimi i saj, përmes rrugës së komparacionit, analizave dhe intervistave. Gjithashtu jep edhe një perceptim të plotë të nocionit diplomaci dhe politikë e jashtme.

Të arriturat specifike të këtij punimi janë të dhënat dhe momentet e zhvillimit të diplomacisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës që nga shtetformimi e deri më tani, të cilat bëhen të dukshme nëpërmjet intervistave të realizuara. Me anë të intervistave në fjalë, të cilat i kam zhvilluar me njerëz kompetentë të kësaj fushe, unë kam nxjerrë në pah të gjitha vështirësitë dhe sfidat që i ka kaluar Kosova deri në dhjetëvjetorin e saj më 17 shkurt të vitit 2018.

Shikuar në përgjithës, kjo është struktura e punimit tonë të magjistraturës, e cila ngërthen në vete shumë të dhëna, burime, krahasime, por njëkohësisht edhe procedon me të gjitha elementet specifike të cilat e kanë përcjellë diplomacinë dhe politikën e jashtme të Kosovës. Shtrirja kohore, analogjitë, specifikat, materiali empirik që vjen nëpërmjet intervistave, si dhe suazat teorike, janë elementet kryesore mbi të cilat ngrihet punimi im mbi politikën e jashtme të Kosovës.

Pjesa 1

1. Vështrim i shkurtër mbi historinë e diplomacisë shqiptare

1.1. Zhvillim historik i diplomacisë shqiptare

Diplomacia si një veprimtari njerëzore daton që nga kohët e lashta. Të gjitha dimensionet e saj kanë fituar dinamika të reja varësisht nga periudhat kohore, përkatësisht nga ato të evoluimit historik.

“Dimensioni i diplomacisë si formë e komunikimit në mes shteteve ka ekzistuar qysh nga koha e krijimit të tyre. Edhe pse forma e këtij komunikimi ka ndryshuar vazhdimisht nëpër kohë, prapëseprapë ajo e ka ruajtur karakterin bazë të idesë së diplomacisë: krijimin e raporteve ndërmjet shteteve”.³

Historia e diplomacisë është shumë më e lashtë, ndërsa gjurmët e saj i hasim edhe në periudhën parahistorike. Synimi kryesor i diplomacisë është që t’ua bëjë të mundur shteteve për t’i realizuar qëllimet e veta të politikës së jashtme duke mos e përdorur forcën, propagandën ose ligjin, por në mënyrë paqesore t’i zgjidhin problemet që ekzistojnë. Sipas shumë studiuesve të kësaj fushe, detyra kryesore e diplomacisë është që t’i menaxhojë marrëdhëniet ndërmjet shteteve të pavarura me anë të negociimit. Gjurmët e diplomacisë, fjalori diplomatik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare janë më të hershme sesa vetë krijimi i shtetit dhe i sistemit të së drejtës.

Edhe diplomacia shqiptare ka rrugëtimin dhe specifikat e veta. Ajo shfaqet pikërisht atëherë kur fillon të ngjizet ideja kombëtare dhe në kohën kur kjo ide nis të shtrihet në planimetrinë ndërkombëtare.

“Dalja e çështjes shqiptare në planin diplomatik është pasojë e drejtëpërdrejtë e zhvillimit të lëvizjes kombëtare. Ajo merr një dimension të ri në çerekun e fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, që është periudha vendimtare e Rilindjes.

³ Kicmari, Sabri, “Hyrye në Diplomaci”, Kolegji Universitar “Victory”, Mars, 2011, fq. 11

Në literaturën e huaj është pohuar shpesh se periudha pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit shënon një pauzë në historinë e lëvizjes sonë kombëtare; rrjedhimisht, ajo paraqitet si një periudhë “e bardhë” edhe në historinë diplomatike të çështjes shqiptare.

Në janar të vitit 1912, me nismën dhe kryesimin e Ismail Qemalit në Stamboll u mbajt mbledhja e një grupi personalitetesh politike, deputetë të Parlamentit, ku u vendos që realizimi i të drejtave kombëtare nuk mund të sigurohej më përmes luftës parlamentare dhe asaj politike, se e vetmja rrugë e mundshme ishte organizimi i kryengritjes së përgjithshme”.⁴

Në këtë moment realisht kemi një qasje të re ndaj çështjes shqiptare, dhe bashkë me këtë edhe të diplomacisë, e cila fillon të marrë përmasa të tjera. “Me këtë rast u shtrua nevoja e një veprimtarie diplomatike që do të kryhej si pranë përfaqësuesve të kombësive të ndryshme nën Turqinë, ashtu edhe pranë qarqeve drejtuese të shteteve të Ballkanit dhe madje në kancelaritë e mëdha evropiane”.⁵

Sipas studiuesve, të dërguarit me misione diplomatike quheshin dhiakë (ata ishin klerikë, njëri prej të cilëve ishte Pal Engjëlli), të cilët ishin përfaqësues të misioneve diplomatike *ad hoc*. Studiuesi Eqrem Zenelaj thekson se në aspektin ndërkombëtar duhet përmendur një fakt shumë të rëndësishëm për historinë e diplomacisë i cili nuk është evidentuar deri më sot, se krahas Dukës së Florencës që kishte themeluar në Milano (Nicodemusin) si një përfaqësues i përhershëm diplomatik që shërbeu për 30 vjet me radhë, dhe të përfaqësuesve diplomatik të Medičëve, edhe shteti shqiptar i Skënderbeut kishte instaluar një përfaqësi të përhershme diplomatike në Urbino të Italisë te Federiko Montefeltro dhe djali i tij Guidobaldo Montefeltro në vitin 1464.

Është fjala për dy ushtarakë – kapitenë të ushtrisë së Skënderbeut – Gjergjin dhe Filipin – dy bijtë e Mikel Lazit, të cilët ishin dërguar nga Gjergj Kastrioti – Skënderbeu dhe ishin vendosur si diplomatë në Urbino në vitin 1464 me detyra të caktuara të përhershme diplomatike e ushtarake.

⁴ Puto, Arben, “Historia Diplomatike e Çështjes Shqiptare”, Tiranë, 2003, fq.8,77

⁵ Z. Cana, “Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912, Tiranë”, 1982, fq.186-187.

“Përveç të tjerash, Skënderbeu në shtetin e tij kishte formuar edhe sistemin e legatëve dhe të diplomacisë përfaqësuese. Gjergj Kastrioti dërgonte dhe priste vazhdimisht legatët e huaj, si dhe diplomatët e ndryshëm që vinin në Shqipëri nga shtetet e tjera. Përfaqësimi diplomatik i shtetit shqiptar të Skënderbeut bëhej me anë të “prokurës” – karakteristikë e kohës për tërë Evropën e mesjetës”.⁶

Nga këto të dhëna mund të konstatojmë se fillet e diplomacisë i gjejmë qysh në kohën e Gjergj Kastriot - Skënderbeut. Ai kishte një organizim shumë të mirë shtetëror, ushtarak, por edhe diplomatik të shtetit të tij, të cilin e realizonte në mënyrën e duhur.

Njerëz të dërguar, marrëdhënie diplomatike, kontakte dhe bisedime paqesore ose lajmëtarë kishte qysh në kohën e klaneve dhe fiseve, duke filluar nga bashkësia e parë primitive e këndeje, pra edhe atëherë kur njerëzit jetonin ende nëpër shpella ose rreth lumenjve, duke mbijetuar nga gjahu dhe peshkimi.

Që atëherë ata binin shpesh në konflikte me grupe e fise të tjera për territore gjahu apo peshkimi, dhe ato, më në fund, mbylleshin me ndonjë marrëveshje paqesore, e cila arrihej me anë të të dërguarve, ose lufta dhe paqja ndërmjet tyre shpallehin drejtpërdrejt.

⁶ Zenelaj, Eqrem “Historia e Diplomacisë”, Shtëpia botuese “Vatra”, Prishtinë, 2013 fq. 96- 101

Shumë teoricienë dhe ambasadorë të karrierës, njëri prej tyre ishte edhe ambasadori i njohur britanik, Harold Nikolson, mendojnë se veprimtaria diplomatike është e lashtë sa vetë historia. Historinë e diplomacisë ai e ndan në këto katër epoka:

1. Diplomacia e grekëve dhe romakëve,
2. Diplomacia e sistemit italian (qyteteve-shtet italiane),
3. Diplomacia e shtetit francez dhe
4. Diplomacia aktuale e kohës së re.

Ndërkaq prof. Milan Jazbec, duke marrë për bazë ndryshimet e praktikave diplomatike, historinë e diplomacisë e karakterizon si një zhvillim në shtatë periudha:

1. Periudha e bashkësive fisnore,
2. Periudha e qytet-shteteve greke (poliseve),
3. Periudha e mesjetës
4. Periudha e shekujve XVII-XIX,
5. Periudha nga mes i shekullit XIX deri nga çereku i fundit i shekullit XX,
6. Periudha e çerekut të fundit të shekullit XX,
7. Periudha e fillimshekullit XXI.⁷

Sipas shumë studiuësve, duke e parë në aspektin e praktikës, fillet e diplomacisë shkojnë deri te fiset e lashta, të cilat për nevoja të ndryshme kishin kontakte ndërmjet tyre. Dhe pikërisht këtu kishte lindur nevoja për një relacion tjetër të komunikimit, i cili do të ishte më i kuptueshëm dhe pa konflikte – pra relacioni diplomatik që realizohej përmes emisarëve, për marrëveshje ose për përcjellje të qëndrimeve. Mirëpo këtyre diplomatëve duhej t'u garantohej një status më i veçantë, përkatësisht duhej t'u garantohej siguria. Vetëm me krijimin e shteteve diplomacia mori një status më të mirëfilltë.

⁷ Abazi, Hajdin, "Diplomacia –Disiplinë e mëvetësishme", Hajdin Abazi, Trendi Global, Revistë Shkencore, Prishtinë, 2009 fq 82

Sipas studiuesit Zenelaj, me kërkesë të Turqisë së dobësuar në Luftën e Parë Ballkanike kundër shteteve të këtij rajoni, u organizua Konferenca e Ambasadorëve të Londrës e vitit 1913, në të cilën merrnin pjesë përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha të Evropës.

Sipas tij, konferenca i kishte zhvilluar punimet nga data 16 dhjetor 1912 deri më 2 gusht 1913. Konferenca e Ambasadorëve e Londrës më 17 dhjetor vendosi që të formohej Shqipëria Independentë.

“Me nenin 3 përcaktohen kufijtë e Shqipërisë nga një komision ndërkombëtar si dhe të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me të.

Konferenca e Ambasadorëve e Londrës nuk e njohu as “Qeverinë e Përkohshme të Vlorës”, në krye të së cilës ishte Esad Pashë Toptani. Shqipëria u vu në mbrojtje dhe nën kontrollin e gjashtë Fuqive të Mëdha të Evropës, duke caktuar organin mbikëqyrës që quhej “KNK” (Këshilli Ndërkombëtar i Kontrollit). E tërë ajo që solli Konferenca e Ambasadorëve e Londrës e vitit 1913, si dhe Protokolet e Firencës në vitin 1914, ishte formimi – njohja e parë e një shteti shqiptar në Ballkan, një njohje e cunguar, e cila do të vinte pas shumë shekujsh historie peripecish, kryengritjesh, luftërash, dhe përpjekjesh të shqiptarëve për krijimin e shtetit të tyre të pavarur dhe për lirinë e shumëpritur”.⁸

Nga një numër i madh studiuesish theksohet fakti se në procesin e krijimit të shtetit shqiptar dhe në fazën e parë pas pavarësisë së Shqipërisë ka pasur një numër të konsiderueshëm diplomatësh të angazhuar e të suksesshëm, të cilët e kanë ndihmuar të mbahet gjallë shtetësia e Shqipërisë. Gjithashtu pohohet se në vitet '30 të shekullit të kaluar vjen deri te rënia e trajektores së diplomacisë e cila rezulton me nënshtrim ndaj Italisë fashiste në vitin 1939.

“Periudha pas Luftë së Dytë Botërore karakterizohet me një ideologjizim të skajshëm të politikës së jashtme dhe me një pasiguri të plotë për orientimin strategjik, që si rrjedhim pati mbylljen e vendit nga të gjitha anët. Pas vitit 1990 ringjallet veprimi diplomatik edhe në Kosovë dhe në Shqipëri.

⁸ Zenelaj, Eqrem, “Historia e Diplomacisë”, Shtëpia botuese “Vatra” Prishtinë 2013, fq. 281-284

Thjesht pason një orientim i përbashkët drejt vlerave perëndimore të lirisë dhe demokracisë. Rezultat i këtij orientimi është demokratizimi i Shqipërisë dhe liria e pavarësia e Kosovës, e fituar edhe me mbështetjen e perëndimit. Diplomatët e angazhuar në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës kanë dhënë kontribut të çmur në këto procese të mëdha. Orientimi strategjik i gjithë shqiptarëve drejt BE-së, NATO-s dhe vlerave perëndimore është një arritje që e garanton paqen, prosperitetin dhe mirëqenien afatgjatë për të gjithë shqiptarët“.⁹

Sipas studiuesit Veton Latifi, politika shqiptare brenda njëqind viteve të kaluara, që nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë e deri më sot, duhet shikuar para së gjithash si një proces politik me të gjitha fazat që zakonisht i përmban një proces. Në fakt, vë në dukje ai, të kuptuarit e thelbit të zhvillimeve politike dhe sistemit politik të një shteti apo kombi bazohet në njohjen e fazave të atij procesi.

“Procesi politik njëqindvjeçar i shqiptarëve është një rrugëtim shumë i gjatë, tejet dinamik dhe aspak i rëndomtë. Procesi i politikës shqiptare fillon shumë më herët se në vitin 1912. Ky proces fillon prej atëherë kur nis rrugëtimi i gjatë i idejimit të projekteve për themelimin e shtetit shqiptar dhe kur nis beteja disashekullore për liri. Kështu, viti 1912 duhet të konsiderohet si vit i zyrtarizimit dhe përmbylljes së simbolikes në shpalljen e pavarësisë së shtetit shqiptar modern. Me këtë vit nis rrugëtimi i politikës moderne shqiptare”.¹⁰

Format më të qëndrueshme të diplomacisë, sipas studiuesit Lisen Bashkurti, mund t'i gjejmë në vitet e ashtuquajtura të “Detantes”, që përbënin një moment të favorshëm për strukturimin e një diplomacie më profesionale.

“Vitet e “Detantës” përbënin në përgjithësi një klimë të favorshme botërore për vendosje, normalizime dhe zhvillime të marrëdhënieve diplomatike dypalëshe dhe shumëpalëshe. Diplomacia shqiptare në vitet e “Detantes” pati një ngritje të dukshme si në rolin e saj aktiv në marrëdhëniet ndërkombëtare, ashtu edhe në nivelin profesional të saj. Karakteri më aktiv dhe më profesional i diplomacisë shqiptare në

⁹ Intervistë e zhvilluar me Ambasadorin e parë të Kosovës në Australi, Sabri Kiçmari-27.08.2017

¹⁰ Latifi, Veton, “Shekulli i ri i Politikës Shqiptare”, Tiranë, 2014 fq.13 -15

vitet '70 erdhi si pasojë e përgatitjes së një brezi të kualifikuar diplomatësh, si produkt i rritjes së eksperiencës së tyre, por ishte edhe rrjedhim i nevojave përherë më të mëdha që kishte Shqipëria për botën e bashkëpunimit me të. Sidoqoftë, e parë në tërësi diplomacia gjatë viteve '70 zgjeroi dhe përmirësoi hapësirat dhe bashkëpunimin me jashtë të Shqipërisë. Në vitin 1975 Shqipëria arriti të kishte marrëdhënie diplomatike me 72 shtete të shtrira në të gjitha kontinentet”.¹¹

Nga e gjithë kjo që u tha më sipër mund të konkludojmë se diplomacia ka pasur një rëndësi të madhe në të gjitha kohët për arritjen e marrëveshjeve në mënyrë paqesore. Çdoherë e më shumë i është kushtuar rëndësi e madhe duke e parë rolin e saj pozitiv të cilin ajo e ka në kapërcimin e situatave konfliktuoze, por edhe në afirmimin e raporteve jo të dhunshme mes palëve.

Princ Leka II rrëfen në një intervistë eksklusive për gazetën “Shqip” se koha e Mbretit Zog, edhe në mënyrën e zbatimit të drejtimit nga ana e politikës, sidomos nga ana e politikës së jashtme, ka qenë e spikatur nga të gjitha drejtimet. “Unë besoj se sot për sot ajo kohë ka ndryshuar. Politika duhet të bazohet mbi çështjet sociale, ekonomike dhe elementet e politikës, d.m.th. duhet ta shikojmë situatën me një sy tjetër. Ne nuk mund të harrojmë historinë dhe duhet të vazhdojmë përpara. Duhet të kujtojmë dhe të mësojmë mësimet më të rëndësishme të kohës së Mbretit Zog. Ajo kohë mbetet një nga kohët e arta të diplomacisë shqiptare. Është koha e një vetëdijeje të lartë kombëtare dhe dëshire për shtetformimin, por shumëçka ka ndryshuar, dhe ne kemi kaluar kohë të vështira, sot duhet t’u përshtatemi kushteve të reja social-ekonomike dhe t’u përgjigjemi nevojave të bashkëkombësve tanë. Koha e Mbretit Zog na ka dhënë një shembull se si duhet ndërtuar një shtet dhe sakrificat që duhet t’i bëjmë për vendin tonë. Sot ne e kemi dhe duhet të punojmë për të, ta mbrojmë pavarësinë si atë administrative, politike, ashtu edhe atë ekonomike”.¹²

¹¹ Bashkurti, Lisen, “Diplomacia Shqiptare”, Diplomacia e Vetëizolimit , Vëllimi III, Geer, 2004 fq. 453-459

¹² <http://forumi.shqipëria.com/threads/mbreti-ahmet-zogu.15392/page-3>, rigjetur më 08.09.2017

Që në kohë të lashta, vë në dukje studiuesi Zeqirija Idrizi, diplomacia konsiderohej shumë e rëndësishme për shmangien e luftës dhe forcimin e paqes. Diplomacia, thekson ai, konsiderohej forca e politikës, e dialogut, e fjalës, e arsyes për të shmangur politikën e forcës, të imponimit, të dhunës. Diplomacia është çelësi i suksesit për imazhin e një vendi. Sipas Idrizit, një prej sfidave të diplomacisë shqiptare gjatë viteve të tranzicionit, krahas hapjes dhe demokratizimit të shërbimit të saj, ishte *korrektimi* i keqkuptimeve apo moskuptimeve të ndryshme, që lidheshin kryesisht me të kaluarën e vendit tonë, si pasojë e vetizolimit të tij dhe ndikimit të ideologjisë komuniste, duke shprehur kështu nevojën për një *diplomaci ndryshe*.

“Historitë e brendshme kanë patur në fakt impakt te të tjerët, dhe kjo ka ndodhur me Shqipërinë për arsye të izolimit të gjatë dhe mënyrës së zhvillimit, ku munguan edhe komunikimet strategjike që kanë të bëjnë me dhënien e mesazheve strategjike për Shqipërinë, për shembull: në turizëm, investime, marrëdhënie kulturore, tregti, lehtësime fiskale, ekonomi etj. Shumëfishimi i mesazheve nga ngjarje që konsiderohen pozitive për vendin dhe që ndryshojnë perceptimet për të, veçanërisht pas vitit 1990, ndikojnë në opinionin publik të vendeve të huaja. Zhvillimi i ri i diplomacisë ka fuqizuar aktorët joshitetërorë, rolin dhe legjitimitetin e tyre në politikën ndërkombëtare, me rrjete dhe aktorë të shumëfishtë. Diplomacia publike nuk mund të jetë më tej e qendërzuar kryesisht te shteti, por të përhapet dhe të ndahet me një mjedis gjithnjë e më fluid global dhe në kontekste të reja. Prandaj në këtë kontekst lind nevoja për më shumë lidhje e kontakte të diplomacisë publike dhe ekonomike me disiplina akademike, për një komunikim tjetër me historinë tonë”.¹³

Autori Gani Mehmetaj vë në dukje se diplomacia shqiptare ka ndihmuar shumë, sidomos në fazën fillestare shpesh i ka hapur rrugët, mirëpo edhe diplomacia shqiptare vuan nga sindroma e vuajtjes së shtetit shqiptar, i ka kufizimet e veta, ngurtësinë, paaftësinë dhe shtrëngesat e shtetit që ka turbulenca të brendshme. “Megjithatë raportet dëshmojnë se diplomacia shqiptare, që kishte përvojë shumë më

¹³ Intervistë e zhvilluar me Prof.dr Zeqirija Idrizi, 05.10.2017

të madhe, e dha kontributin e vet. A kishte mundësi të bënte më shumë? Sigurisht që po, por janë turbulencat e kufizimet që e penguan”.¹⁴

Diplomacia, që nga format e para të krijimit të saj e deri më sot, ka pësuar ndryshime të shumta. Njëri nga këto ndryshime ka të bëjë me metodat e veprimit të përfaqësuesve. Përderisa në kohën e monarkive feudale kërkohet që të jenë oborrtarë të gatshëm për realizimin me sukses të detyrave, sot nga një diplomat kërkohet të ketë një arsim të gjerë, të flasë gjuhë të huaja, të ketë njohuri për rrethanat politike, ekonomike, kulturore etj.

1.2. Detyrat e diplomacisë

Për studiuesin Zeqirija Idrizi, në të gjitha fazat e historisë së njerëzimit diplomacia ka pasur karakteristikat e saj specifike, por disa veçori të qëndrueshme janë gjithmonë të pranishme në ushtrimin e detyrave diplomatike. “Pa marrë parasysh se si përkufizohet diplomacia, ajo është kurdoherë shprehje e veprimitarisë së përgjithshme të të gjithë pjesëmarrësve të jetës politike ndërkombëtare, të cilët në përputhje me mundësitë dhe nevojat e veta dhe kohën e veprimit, angazhohen në realizimin e qëllimeve optimale në planin ndërkombëtar”.¹⁵

Sipas këtij përkufizimi, diplomacia mundëson që qëllimet e një vendi të realizohen në planin ndërkombëtar, gjithashtu krijon dhe promovon imazh të caktuar ose perceptim të dëshiruar për shtetin.

“Prej detyrave më të rëndësishme të diplomacisë mbetet vëzhgimi dhe informimi i Ministrisë së Jashtme lidhur me ngjarjet dhe proceset e ndryshme që ndodhin në vendet e tjera. Shtetet e vogla e kanë të vështirë realizimin e vëzhgimit të një numri të madh të çështjeve ndërkombëtare, detyrë kjo e cila për realizimin efikas kërkon angazhim, staf të konsiderueshëm dhe mjete financiare vështirë të përballueshme për shtetin e vogël”.¹⁶

¹⁴ Intervistë e zhvilluar me autorin Gani Mehmetaj, 16.09.2017

¹⁵ Idrizi, Zeqirija, “Historia e Diplomacisë” Prishtinë, 2013, fq. 7

¹⁶ Haxhimeteti, Gjenis, “Politika e Jashtme e Shteteve të Vogla”, ISPN, Shkup, 2016, fq. 102

Diplomacia multilaterale mbetet një model funksional i diplomacisë i theksuar nga shumë studiues. Këtë model të diplomacisë mund ta hasim më herët, por prania e tij më tepër ndërlidhet me shtetet më të vogla.

“Sipas këtij definicioni informimi dhe vëzhgimi kanë një rëndësi shumë të madhe duke pasur parasysh se informimi ka ndikim të madh në formulimin e politikës së jashtme. Diplomacia multilaterale përfshin aktivitetin kryesor përmes të cilit shteti i vogël mundohet t’i realizojë interesat e veta, madje mundësi praktike për shtetet e vogla është që temat bilaterale të diskutohen në forume multilaterale. Diplomacia multilaterale është e përshtatshme edhe për shtetet e mëdha”.¹⁷

Sipas këtij eksplorimi vijmë në përfundim se diplomacia multilaterale është një mundësi më e mirë për një shtet të vogël që ta garantojë sigurinë e vendit të vet në raport me shtetet e tjera.

Barstoni në pikënisjen e analizës së tij mbi diplomacinë moderne e jep definicionin e saj siç vijon: “Diplomacia merret me menaxhimin e marrëdhënieve ndërmjet shteteve, si dhe ndërmjet shteteve dhe faktorëve të tjerë”.¹⁸

Duke e parë nga ky këndvështrim, diplomacia merret me realizimin e politikës së jashtme. Ajo merret me realizimin e politikës së jashtme, dhe si e tillë është mjet përmes së cilës shtetet me anë të përfaqësuesve, marrëveshjeve zyrtare, komunikimit të zyrtarëve të emëruar për ta zhvilluar politikën e jashtme, sigurojnë interesat e vendit të cilin e përfaqësojnë. “Ndonëse në rastin Kosovë – Serbi shënohet shmangie nga termi përfaqësi diplomatike (madje nuk përdoren as simbolet shtetërore), fusha e detyrave të këtyre entiteteve përfaqësuese nuk lë dyshime se bëhet fjalë për përfaqësi diplomatike, pasi që përfaqëson vendet respektive, mbron interesat e dy vendeve, si dhe kryen proceset informative-komunikuese si në çdo përfaqësi diplomatike”.¹⁹

Sipas këtij përkufizimi arrijmë në konkludim se përfaqësimi luan një rol të rëndësishëm në përcjelljen e imazhit pozitiv të shtetit dërgues.

¹⁷ Po aty, fq.120

¹⁸ Eric Neumayer, “Distance, power and ideology: diplomatic representation in a world of nation-states”, UK, 2008, p.228

¹⁹ Haxhimehmeti, Gjenis, “Politika e Jashtme e Shteteve të vogla” ISPN, Shkup, 2016 fq. 99

Diplomatët duhet të jenë të parët që vënë re procese të caktuara, për të cilat duhet t'i informojnë autoritetet e veta të punëve të jashtme. Pa marrë parasysh llojin e informimit, me rëndësi është që vendi të informohet me shpejtësi për çdo problematikë.

Në praktikën e sotme diplomatike janë të njohura tri lloje kryesore të përfaqësimit:

- ❖ Ambasada
- ❖ Misioni diplomatik në një organizatë ndërkombëtare dhe
- ❖ Konsullata²⁰

Ambasadat e para u krijuan në shekullin e trembëdhjetë. Rolin prijtar në këtë drejtim e luan Milano, nën udhëheqjen e Francesco Sforzës. Milano ishte qytet-shteti i parë që dërgon një përfaqësues diplomatik në oborrin mbretëror të Francës në vitin 1455. (Nicolson 2005 : 39)

I dërguari i parë diplomatik ishte Hercogu i Milanos. Me këtë fillon edhe forma e parë e akreditimit të një ambasadori te shefi i shtetit të vendit pranues. Kjo praktikë do të vazhdonte të shpërndahej pastaj edhe në shtetet e tjera të Evropës. “Në të njëjtin vit Venediku e emëron të ngarkuarin e tij në Londër, në oborrin e mbretit Maksimilian, kurse Spanja e dërgon misionin e parë diplomatik në oborrin mbretëror të Anglisë në vitin 1487”.²¹

Pikërisht mbi këtë analogji fillestare janë krijuar edhe lidhjet e para diplomatike të shtetit të Kosovës. Pas formimit të MPJ-së (pavarësia u shpall më 17 shkurt 2008) ka pasuar kontakti zyrtar me vendet e OKB-së, me të cilin janë bërë shpjegime për shpalljen e shtetit të ri të Kosovës, është kërkuar njohja e Kosovës nga këto vende dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike. Siç dihet tashmë, dhe siç sqaron diplomati Skënder Durmishi, pati një valë të shpejtë njohjesh.

“Ambasadat e para të shtetit të Kosovës janë hapur në tetor të vitit 2008, në ato vende që kishin rëndësi të veçantë për shumë aspekte, raporte miqësore, raporte strategjike. Pas Uashingtonit e Nju Jorkut (dihet merita e SHBA-së për shtetin e Kosovës dhe raportet e veçanta të Kosovës me të), u kemi dhënë rëndësi të

²⁰ Kiçmari, Sabri, “Bazat e Diplomacisë” Kolegji Universitar “Victory”, Mars, 2011 fq.121

²¹ Po aty, fq. 30

veçantë Evropës dhe vendeve të fqinjësisë imediate, pra në ato vende që na kishin njohur si shtet. Londra ishte në grupin e ambasadave të para, po ashtu Parisi, Berlina, Roma, Berna, Vjena, Praga, Haga, Stokholmi, Sofja, Budapesti, Lublana, Zagrebi, Tirana. Kemi vazhduar me hapje të ambasadave në vende më të largëta, siç është Riadi, Tokio, Kanbera, më vonë Panamaja, Kanada, etj. Shërbimet konsullore, në rastet më të shumta, janë ofruar në ambasada. Nga stafi i akredituar si diplomat, ngarkohej dikush për t'u marrë me çështje konsullore. Por, me kalimin e kohës, janë hapur e vazhdojnë të hapen misionet konsullore (Konsullata të Përgjithshme), varësisht nga nevojat dhe kërkesat, si në Stamboll, Strazburg, disa të tilla janë në Zvicër e në Gjermani".²²

Njësoj si në politikën e jashtme, edhe në diplomaci mund të dallohen tri rrafshet analitike për shqyrtimin teorik të veprimit praktik:

- Rrafshi individual,
- Rrafshi shtetëror,
- Rrafshi ndërkombëtar.

"Rrafshi individual: Në këtë rrafsh analizohet roli i individit, konceptet, idetë dhe perceptimi i ambasadorit ose diplomatit.

Rrafshi shtetëror: Në këtë rrafsh analizohet roli i institucioneve shtetërore në përcaktimin e veprimeve në diplomaci.

Rrafshi ndërkombëtar: Ka të bëjë me ndikimin e dyanshëm në sjelljen e faktorëve diplomatikë".²³

Andaj mund të potencohet se nëpërmjet diplomacisë krijohen sistemet e komunikimit në mes të subjekteve të marrëdhënieve ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë të shtetit, e gjithë kjo me qëllim që të mundësohen raporte më të mira ndërmjet shteteve. Diplomacia i shërben realizimit të qëllimeve të politikës së jashtme.

²² Intervistë e zhvilluar me diplomatën e parë të Kosovës në Maqedoni, Skender Durmishi, 27.08.2017

²³ Kiqçari, Sabri, "Hyrije në Diplomaci", Kolegji Universitar "Victory", Mars, 2011 fq.21

Sipas Sër Harold Nikolsonit, detyra e diplomacisë është menaxhimi i marrëdhënieve ndërmjet shteteve të pavarura me anë të negociatave. “Diplomati profesionist është shërbyesi i pushtetit sovran në vendin e tij. Në vendet demokratike, ai pushtet përfaqësohet pikësëpari prej një shumice në Kuvend të cilit ajo i jep pushtetet ekzekutive”.²⁴

Sipas këtij definicioni, diplomacia ka për detyrë të vendosë, të ndërtojë dhe të përforcojë marrëdhënie më të mira nëpërmjet bashkëpunimit me diplomatët e vendeve të tjera, madje me anë të komunikimit të drejtpërdrejtë protokollar ku jepen qëndrimet e vendit.

Radovan Vukadinoviç thotë se diplomacia konsiderohet si forma më e vjetër e komunikimit ndërmjet shteteve. Kur flitet për diplomacinë, menjëherë mendohet edhe për politikën e jashtme. Sipas tij, politika e jashtme ose politika në përgjithësi është program veprimi, të cilin e realizon një shtet në planin e marrëdhënieve ndërkombëtare, kurse diplomacia do të ishte metoda me ndihmën e së cilës kjo politikë mund të realizohet në praktikë. “Pra diplomacia nuk mund ta krijojë politikën e jashtme, por ajo transmeton, shpjegon, negocion dhe përfaqëson vijën themelore politike të një shteti”.²⁵

Diplomacia “si institucion i shtetit dhe si faktor i politikës shtetërore” (Benko, 1997. a: 257-259), pra, duhet t’i kryejë tri detyra themelore: përfaqësimin, negocimin dhe vrojtimin (po aty). “Në këtë mënyrë diplomacia i siguron qeverisë së vet informatat mbi shtetin pranues dhe kështu ofron mundësinë e vendimmarrjes më të plotë dhe më të matur mbi politikën konkrete ndaj këtij shteti. Në këtë mënyrë ajo njëkohësisht ndikon në mënyrë të veçantë në formësimin e politikës së jashtme ndaj shtetit konkret, përkatësisht ndaj qëndrimeve mbi temat aktuale”.²⁶

Diplomati Sabri Kiçmari vë në dukje se diplomacia luan një rol të veçantë në fushën e politikës së jashtme, e cila ka për qëllim përfaqësimin e shtetit, mbrojtjen e interesave të vendit dërgues, informimin, negocimin, si dhe thellimin e marrëdhënieve më të mira dhe bashkëpunimin miqësor ndërmjet shteteve dhe popujve.

²⁴ Nikolsoni, Sër Harold, “Diplomacia”, Prishtinë, 2005 fq. 85-86

²⁵ Vukadinoviç, Radovan, “Mardhëniet Politike Ndërkombëtare”, Kolegji “Victory”, Prishtinë, 2006 fq. 217

²⁶ Kiçmari, Sabri “Bazat e Diplomacisë” Kolegji Universitar “Victory”, Mars, 2011 fq. 14-15

Të gjitha këto veprimtari, sipas tij, kryhen përmes të ngarkuarve me obligime, e që janë pjesë përbërëse e trupit diplomatik, si ambasadori, atashetë, ambasadat, si dhe përfaqësues të tjerë diplomatik, pra, me një fjalë, të diplomatëve.

“Duke e marrë parasysh faktin se diplomacia e Kosovës, që në hapat e parë të saj është ndeshur me sfida që nuk janë ndeshur shumica e vendeve të tjera të reja, ka lëvizur me kujdes dhe mirë përpara. Ka shumë veprime diplomatike, për të cilat shpresoj se do të bëhen në të ardhmen, sidomos në mbulimin e hapësirës gjeografike të përfaqësimit, për për këtë çështje vendos politika dhe jo diplomacia e Kosovës”.²⁷

Sipas shumë diplomatëve të Kosovës të intervistuar për këtë punim, gjithmonë ka vend për të dëshiruar më shumë, dhe ndonjëherë ka edhe ngathtësi aty-këtu në punën e diplomatëve, por në përgjithësi, sipas tyre, kemi një shërbim dinamik diplomatik dhe konsullor të cilët po e kryejnë punën e tyre. “Do të doja të shoh më shumë aktivizëm diplomatik të të emëruarve politik në Prishtinë, nuk kam shumë ankesa për sa i përket shërbimit të tyre, është një shërbim profesional dhe nuk është politik, por te të emëruarit politik, te ministrat, zëvendësministrat, këshilltarët do të duhej të kishte më shumë aktivizëm, qasje më agresive në kuptim pozitiv, sidomos për të fituar më shumë njohje, sepse Kosova ka nevojë për njohje”.²⁸

Në të njëjtën linjë vlerësimi është edhe diplomati Enver Hoxhaj, sipas të cilit diplomacia e Kosovës posedon kapacitetet e nevojshme intelektuale dhe diplomatike për ta ushtruar denjësisht këtë veprimtari dhe qëndron më lart edhe se vendet e rajonit me një traditë më të gjatë diplomatike.

“Shërbimi i jashtëm e ka një pjesë të mirëfilltë, ndoshta diku nga 70 për qind e tyre janë top diplomatë, kanë kapacitet intelektual, kanë përgatitje gjuhësore, kanë veprim diplomatik, sjellje diplomatike për ta përfaqësuar Kosovën, janë shumë më të mirë sesa disa prej vendeve të rajonit që ekzistojnë si shtete 100 apo 200 vite”.²⁹

²⁷ Intervistë e zhvilluar me ambasadorin e parë të Kosovës në Australi, Sabri Kijmarin 27.08.2017

²⁸ Intervistë e zhvilluar me ministrin e parë të Punëve të Jashtme të Kosovës, Skender Hyseni, 05.09.2017

²⁹ Intervistë e zhvilluar me ish ministrin e MPJ-së, Enver Hoxhaj, 03.10.2018

1.3. Diplomacia e Kosovës që nga organizimi i luftës së UÇK-së e deri në shpalljen e pavarësisë

Trajektorja e veprimtarisë diplomatike të Kosovës është specifike. Pas vetes ajo nuk ka ndonjë traditë të theksuar, por ndërkohë u impenjua si një diplomaci kryesisht pas rrethanave të shfaqura me daljen në skenë të UÇK-së.

“Duke mos u pajtuar me okupimin serb të Kosovës dhe duke parë paaftësinë e zgjidhjes politike të krizës në Kosovë pas vitit 1990, filluan përgatitjet për formimin e UÇK-së si formacion i rregullt ushtarak dhe si kryengritje e armatosur për çlirimin e Kosovës. Këto përgatitje u kurorëzuan në vitin 1997, kur UÇK-ja doli publikisht në skenë dhe filloi luftën çlirimtare në Kosovë”.³⁰

Së këndejmi mund të konkludojmë se paraqitja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte një nga ngjarjet më historike të shtetit të Kosovës për të luftuar për pavarësinë dhe demokracinë e vendit ashtu sikurse të gjitha vendet e tjera. Me themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u mundësua që të krijohen raporte të mira në Kosovë dhe rajon dhe ndërkohë problemi i saj të mund të dilte në shesh me gjithë kompleksitetin e vet. Me formimin e një qëllimi të vetëm, pra për motiv çlirimtar, UÇK-ja arriti shumë shpejt të fitojë mbështetjen e popullit të Kosovës dhe të paraqitet si faktor kryesor në komunikimet me faktorin ndërkombëtar rreth zgjidhjes së krizës së saj.

“Falë përpjekjeve dhe luftës heroike të popullit shqiptar, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndërhyrjes ushtarake ajrore të NATO-s, Kosova arriti ta fitojë pavarësinë. UÇK-ja me luftën e vet çlirimtare, si e drejtë sovrane e popullit shqiptar, e realizoi ëndrrën e saj shekullore të çlirimit nga Serbia”.³¹

Gjithsesi, diplomacia e Kosovës njih edhe periudhën paraprake të identifikuar me presidentin historik, Ibrahim Rugova. Edhe gjatë kësaj periudhe, sipas shumë njohësve të rrethanave diplomatike, Kosova kishte arritur që ta krijonte një subjektivitet ndërkombëtar, i cili në njëfarë mënyre do të ishte platformë e diplomacisë për Kosovën.

³⁰ Bajrami, Arsim, “Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës”, Prishtinë, 2011 fq. 64

³¹ Hajrullahu, Ismet, “Lufta e fundshekullit XX” për Kosovën”, Prishtinë, 2012 fq. 16

“Diplomacia ka patur rëndësi të madhe për t’u ngjallur derisa ishte gjallë presidenti Rugova, Kosova ishte shumë e pranishme në skenën ndërkombëtare, sepse vetë figura e presidentit ishte emblematike dhe hapte dyer çdokund, d.m.th. nuk ka qenë problem për të hapur dyer në Uashington, Londër, Paris duke e patur në krye këtë personalitet, pra ka qenë punë e lehtë, ndërkohë që shumë më vështirë është sot, çuditërisht dhe paradoksalisht është shumë më vështirë sot të hapësh disa dyer që i pat hapur dikur Rugova gjatë vizitave të 90-tës. Dhe unë këtu flas me kompetencë, sepse e kam udhëhequr komunikimin dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në zyrën e presidentit Rugova, kam qenë këshilltar kryesor politik, por edhe këshilltar diplomatik”.³²

Pikërisht këtë periudhë të diplomacisë në raport me diplomacinë e mëpastajme dhe aktuale, e trajton edhe studiuesi Milazim Krasniqi, sipas të cilit diplomacia është larg minimumit që kërkon jeta dhe historia.

“Diplomatët e sotëm nuk kanë pse e mbajnë si sukses vetëm nëse mbërrijnë t’i ndalin kriminelët serbë që vrasin, dhunojnë e dëbojnë shqiptarët nga vatrat e tyre. Në raport me paraardhësit e tyre, ky vërtet mund të quhej një sukses, por ai është ende larg, nën pragun e minimumit që kërkon jeta dhe historia. Nga diplomatët, politikanët dhe ushtarakët e Fuqive të Mëdha sot kërkohet që ta ndëshkojnë krimin serb dhe që paralelisht me këtë akt njerëzor të pranojnë realitetin se shqiptarët e Kosovës duan të jetojnë të lirë në tokën e vet, të çlirohen nga ankthi i përhershëm, për shkak se i kërcënon doktrina serbe e gjenocidit”.³³

Pavarësia e Kosovës duhet kuptuar si një proces. Sipas studiuesve të diplomacisë së Kosovës, ky proces nënkupton shumë lëvizje diplomatike nëpërmjet të cilave Kosova fillon të njihet ndërkombëtarisht dhe fillon të gëzojë përkrahjen e faktorëve dhe të personaliteteve ndërkombëtare.

³² Intervistë e zhvilluar me ministrin e parë të Punëve të Jashtme të Kosovës, Skender Hyseni 05.09.2017

³³ Krasniqi, Milazim, “Publicistika”, Vepra 7, Tiranë 2012, fq. 100

“Lufta për pavarësinë e Kosovës ka filluar shumë më herët. Diplomacia e Ibrahim Rugovës e solli NATO-n në Kosovë. Diplomacia e tij ishte shumë më frytshme dhe shumë më aktive sesa çdo gjë tjetër më herët e më vonë. "Kosova e integruar në Bashkimin Evropian dhe në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ishte postulati kryesor i presidentit të parë të Kosovës. A thua ndiqet ende ky parim fundamental? Ai takoi dhe mori premtimin për ndihmë nga burrshtetasit më të mëdhenj të planetit: Bill Klintonit, Toni Blerit, Fransua Miteranit, Papa Gjon Palit të Dytë e dhjetëra ministrave të jashtëm të shteteve të mëdha. Autoriteti dhe qasja e tij e veçantë ndikuan që NATO-ja, forca më e madhe ushtarake në botë, të ndërhyjë kundër Serbisë, duke e çliruar Kosovën. Ishte vendimtare diplomacia e Rugovës, këtë e thonë të gjithë burrshtetasit e planetit në kujtimet e tyre. UÇK-ja s'kishte asnjë ndikim në diplomaci. S'kishte as njerëz për këto gjëra”.³⁴

1.3.1. Diplomaci në rrethana lufte

Për studiuesin Halim Bajraktari, alternativat drejt gjetjes së një modaliteti për t'i dhënë fund luftës, nuk reshtën për asnjë moment nga ana e bashkësisë evropiane, që sa më parë t'i jepnin fund dhunës serbe. Konferenca e Rambujesë, vë në dukje ai, shënoi daljen e çështjes së Kosovës në skenën evropiane e ndërkombëtare, njëherit kjo konferencë qartësonte të ardhmen e Kosovës, ku mediat ndërkombëtare e quajtën edhe si pjesë të “Dejtonit”.

“Deri te mbajtja e Konferencës së Rambujesë, Kosova asnjëherë nuk u trajtua në mënyrën të duhur meritorë”, por trajtoheshin vetëm aspektet cenuese të të drejtave të njeriut dhe asgjë më shumë, këto kategori të cilat nuk ishin në thelb të tilla dhe parësore për Kosovën. “Pikë tjetër e padiskutuar nëpër konferencat e tjera ishte edhe aspekti territorial, ku asnjëherë s'u bë temë e diskutimeve, e lëre më të zgjidheshin këto çështje, ku për Kosovën këto mosdiskutime ishin gjithmonë e më shkatërruese”.³⁵

³⁴ Intervistë e zhvilluar me autorin Gani Mehmetaj, 16.09.2017

³⁵ Bajraktari, Halim, “Roli dhe perspektiva evropiane e Kosovës”, Punim doktore, Tiranë, maj 2014, fq. 24

Çështja që ngjalli më së shumti debate, dyshime, kundërshtime, dilema e refleksione në fund të shekullit njëzet, pa dyshim ishte çështja e Kosovës. Sipas Ramë Bujës, lufta për çlirimin e popullit të saj, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte përpjekja më serioze, më e dinjitetshme, më dobiprurëse dhe me kthesëbërëse nga të gjitha luftërat pararendëse çlirimtare të popullit shqiptar.

“Kjo luftë e ashpërsisë së istikameve, transheve dhe llogoreve, gërshetuar me urtësinë praktike që kërkonte koha, dhe me sensin politik, si dhe rezonin racional diplomatik që posedonin udhëheqësit politik të saj, bëri që sakrificat të rezultojë me sukses, me organizimin dhe mbajtjen e një konference ndërkombëtare për Kosovën. Kjo konferencë e cila zhvilloi punimet nga 6 deri më 23 shkurt të vitit 1999 në qytetin Rambuje dhe që vazhdoi në Paris prej 15 deri në 19 mars të po të njëjtit vit, është e njohur me emrin Konferenca e Rambujesë. Dhe kjo bëri që, rezoni megaloman pushtues, kriminal e vrastar i politikës së Millosheviqit, të marrë fund me kapitullim më 9 qershor 1999, me nënshkrimin e Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake të Kumanovës”.³⁶

Nga ajo që u tha më lart, mund të shohim se Konferenca e Rambujesë i solli fat popullit të Kosovës, e cila përfundoi luftën çlirimtare në mënyrën e saj më të suksesshme, me ndihmën e aleancës më të fuqishme ushtarake botërore NATO-s. Konferenca e Rambujesë ka lënë gjurmë të mëdha në historinë e popullit shqiptar, për faktin e pasqyrimeve të mëtejme politike, diplomatike etj.

Populli shqiptar për herë të parë u vërejt nga bota demokratike e cila mësoi për vuajtjet dhe krimet që ishin bërë mbi të, si dhe përpjekja e tij për çlirim kombëtar e demokratik. Me Konferencën e Rambujesë shteti i Kosovës hyri në epokën e prekjes së demokracisë, lirim të vendit nga forcat serbe, duke filluar hapat e mëtejshëm të lirisë e cila ishte shumëpritur nga shqiptarët me vite e vite.

Ministri i parë i Punëve të Jashtme të Kosovës, Skënder Hyseni, në intervistën e realizuar, thekson: “Diplomacia ka bërë punë shumë të madhe në vitin 1997. Presidenti Rugova ka marrë pjesë në mbledhjen e Grupit të Kontaktit në Londër, e cila është kryesuar nga zonja Medlin Ollbrajt, e cila atëherë ishte sekretare amerikane e shtetit. Në të njëjtën javë presidenti Rugova është takuar me presidentin

³⁶ Buja, Ramë, “Konferenca e Rambujesë”, Prishtinë, 2006 fq. 11-13

Zhak Rene Shirak në Paris, të cilin atëherë nuk mund ta takonte asnjë kryetar i ndonjë vendi tjetër ballkanik”.

“Kështu Ibrahim Rugova ka bërë të jashtëzakonshmen, të pamundurën në promovimin e këtij shteti në skenën ndërkombëtare, të atij që quhej shetet paralel i shqiptarëve. Kështu quhej në botë, por për ne ishte shtet. Dhe kjo i ka ndihmuar shumë, pa këtë lufta nuk do të bënte punë, d.m.th, duhen të dyjat për të qenë të suksesshëm, edhe diplomacia edhe veprimi politik kanë puls, por në fazat e fundme edhe lufta e armatosur”.³⁷

1.3.2. Diplomacia nën administrimin e UNMIK-ut

Pavarësisht nga këto zhvillime, diplomacia e Kosovës do të kalojë nëpër sprova specifike, të cilat e bëjnë atë të jetë unike në ushtrimin e kësaj veprimtarie kaq të rëndësishme për një shtet. Diplomacia nën administrimin e UNMIK-ut, mbetet një fazë më vete, por që gjithsesi shënon edhe veprime komplementare në fuqizimin e shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

“Më mirë të kemi një kushtetutë me lëshime e të meta, të cilën pastaj në rrethana pak më normale do ta plotësojmë e do ta bëjmë më gjithpërfshirëse, sesa të mos ketë fare, ose të kemi udhëzime administrative të UNMIKU-ut e të organizmave të tjerë ndërkombëtarë. Të kesh kushtetutë, është mrekulli. Por, para se të hyjmë te vërejtjet që janë thelbësore dhe që prekin në tërësinë e jetës shtetërore e shoqërore, po ashtu jemi të vetëdijshëm se me disa kushte dhe me disa obligime që i kanë marrë institucionet tona shtetërore dhe përfaqësuesit më të lartë, na kanë pranuar shtetet më të fuqishme të botës.”³⁸

³⁷ Intervistë e zhvilluar me ministrin e parë të Punëve të Jashtme të Kosovës, Skender Hyseni, 05.09.2017

³⁸ Mehmetaj, Gani, “Sifdat e Pavarësisë”, Titanic, 2009, fq. 72

Përpara se të vendosej UNMIK-u, në bazë të Rezolutës 1244, menjëherë iu caktuan edhe rolet dhe fushëveprimtaria e këtij misioni, që ishin të shumta dhe përplot sfida për gjithë faktorin ndërkombëtar në mbështetjen e Kosovës pas luftës. Siç thoshte edhe Kofi Anan: “*Detyra që ka përpara bashkësia ndërkombëtare, është që ta ndihmojë popullin e Kosovës për të rindërtuar jetën e vet dhe të shërohen plagët e luftës*”.

“Thelbi i këtij misioni ishte vendosja në Kosovë e një misioni si mburojë, mbrojtje për këtë shtet”. Në bazë të UNSC Rezolutës 1244 u vendos Misioni Ndërkombëtar në Kosovë (UNMIK–u). Ishte ndërmarrje e hapave më të mëdhenj dhe më sfidues në fushën për administrimin territorial të Kosovës. “Një fat tjetër ishte se nga ky moment Kosova përkohësisht administrohej nga OKB-ja dhe nën administrimin e BE-së, përmes misionit të (OSBE-së)”.³⁹

Kjo është faza më delikate dhe njëkohësisht me sfida më të shumta në gjithë dinamikën e veprimtarisë diplomatike.

“Faza e parë e vendosjes së protektoriatit ndërkombëtar në Kosovë (nga qershori 1999 deri në nëntor 2001), paraqet sfidën më të madhe me të cilën u ballafaqua faktori ndërkombëtar, ngaqë ajo duhej të kalonte nëpër gjendjen e emergjencës humanitare, nëpër të cilën, një popullate të traumatizuar nga shtypja e gjatë, dhuna, shpërnguljet, e deri te lufta me pasoja të rënda shpirtërore dhe fizike, duhej t’i krijohej normaliteti jetësor si një parakusht për të ecur më tutje te krijimi i strukturave institucionale përgjegjëse për vetëqeverisje autonome”.⁴⁰

Roli i organizatave ndërkombëtare në Kosovë ishte vendimtar në raportin e shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare, por edhe të shumë komplikimeve që kalonin nëpër sfida të ndryshme strukturimi.

“Periudha pas shpalljes së pavarësisë ka përjetuar një shtim të misioneve ndërkombëtare në Kosovë. Nuk pamë një mbarim të UNMIK-ut, siç ishte pritur. Më saktë, UNMIK-u mbeti prania kryesore e OKB-së, pavarësisht rikonfigurimit dhe

³⁹ Bajraktari, Halim, “Roli dhe perspektiva Europiane e Kosovës”, Punim Doktorature, Tiranë, maj 2014, fq. 36

⁴⁰ Buxhovi, Jusuf “Kosova –VI 199-2001 Lugina e Preshevës Maqedonia”, Faik Konica, Prishtinë, 2018, fq. 315

zvogëlimit. Kemi parë një lloj beteje mes aktorëve të ndryshëm për ta plotësuar rolin e UNMIK-ut. Ai rol është marrë në masë të madhe nga misionet e Bashkimit Evropian në Kosovë”.⁴¹

Rezoluta që e la Kosovën në një gjendje paqartësie, është hartuar në atë mënyrë që të gjitha palët të mund të shpallin një fitore diplomatike. “Përderisa rezoluta përcaktonte rrugën drejt sovranitetit, ajo nuk identifikonte kritere specifike të cilat do të rezultonin me pavarësinë e Kosovës. Pa një klauzolë përmbyllëse, Rezoluta 1244 do të ekzistonte derisa KS i OKB-së të miratonte një rezolutë të re”.⁴²

Sipas studiuesit Adem Beka, fillimi i negociatave në Vjenë për të adresuar statusin e pazgjidhur të Kosovës, shënon fazën e parë të rimendimit të prezencës së fortë ndërkombëtare në Kosovë. “Nga viti 1999 bashkësia ndërkombëtare nuk kishte një strategji dalëse nga Kosova. Administrimi ndërkombëtar kishte për qëllim të ndërtonte një shoqëri paqesore, demokratike dhe multietnike, si dhe të krijonte e fuqizonte institucionet e Kosovës para se të definohej statusi përfundimtar i saj”.⁴³

Sipas diplomatit Enver Hoxhaj, institucionet e Kosovës gjatë pesë viteve të para të administrimit të UNMIK-ut kanë pasur qasje të kufizuar në rrafshin ndërkombëtar. “Ato mbanin kontakte të përhershme me përfaqësitë diplomatike të shteteve përkatëse, siç ishin ato amerikane, britanike, franceze, gjermane, italiane, të vendeve të tjera evropiane, por edhe me shumë vende të tjera si Japonia, Kanadaja, Australia. Kosova ishte investim politik i shumë shteteve dhe institucioneve ndërkombëtare”.⁴⁴

Pavarësisht nga lëshimi, kjo konsiderohet si faza e paqëndrimit në Kosovë dhe në një farë mënyre i dha shtysë zhvillimit të Kosovës dhe rumbullaksimit të mëvetësisë së saj.

⁴¹ KDI-Power in post-independence Kosovo, september, 2009, Prishtina, Kosovo, fq. 15

⁴² L. Phillips, David, “Çlirimi i Kosovës-Diplomacia këmbëngulëse dhe ndërhyrja e SHBA-ve”, Tetovë, 2015, fq. 186

⁴³ Beka, Adem, “Shtetndërtimi dhe Paqëndrimiti- Ambiguiteti kreativ si politikë e administrimit ndërkombëtar në Kosovë”, Specializim, Shkenca Politike, Qershor, 2016, fq. 154

⁴⁴ Hoxhaj, Enver „Ngritja e një shteti“- Politika e jashtme e Kosovës, Tiranë 2016, fq. 39

“Përgjatë viteve, në funksionimin e tij UNMIK-u kishte lëshime dhe dështime, por në përgjithësi konsiderohet si njëri ndër misionet e suksesshme të OKB-së në paqëndërtimin, veçanërisht në disa fusha. Ky mision ka ndryshuar gjendjen në kuptimin institucional dhe ka ndihmuar në përmirësimin e jetës së njerëzve”.⁴⁵

Për studiuesin Zeqirija Idrizi, politika e jashtme ka qenë e varur, e ngulfatur nga UNMIK-u, i cili e ka penguar punën e organizimit të politikës së jashtme për mungesë koordinimi të atij misioni me OKB-në etj. Siç dihet, për shkak të UNMIK-ut, disa vite pas lufte Kosova e ka patur të kufizuar, për të mos thënë edhe të pamundur qasjen e saj në rrafshin ndërkombëtar. “Kjo është njëra nga arsyet që ka shkaktuar probleme të mëdha. E dyta, mungesa e përvojës në ndërtimin e institucioneve, në pasjen e një platforme për një politikë të jashtme (konkretisht ministra etj) të cilët nuk kanë patur as ide se çfarë është, e lëre më se si duhet të funksionojë politika e jashtme. E katërta, diplomacia agresive e Serbisë, Rusisë dhe e disa vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën dhe që janë aleate të Serbisë, por që kanë lobuar vazhdimisht kundër Kosovës”.⁴⁶

Teksti i Rezolutës 1244 parashihte “katër shtylla” në të cilat Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) do ta mbeshtesë punën e vet:

Shtylla I: Çeshtjet humanitare të drejtuara nga UNHCR-ja;

Shtylla II: Administrata civile e drejtuar nga vetë UNMIK-u;

Shtylla III: Demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve i drejtuar nga Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Evropë (OSBE) dhe;

Shtylla IV: Zhvillimi ekonomik nën mbikëqyrjen e Bashkimit Evropian.⁴⁷

Për disa studiues, punët e jashtme dhe politika e jashtme e Kosovës në kuadër të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme është trajtuar si “kompetencë e rezervuar” e administratës së UNMIKU-ut. Sipas tyre, gjatë kësaj periudhe kohore mbizotëronin qasje konfliktuoze në punët e jashtme të Kosovës –

⁴⁵ Po aty, fq 36

⁴⁶ Intervistë e zhvilluar me prof.dr Zeqirija Idrizi, 05.10.2017

⁴⁷ Stavileci, Esat, “Vepra XVII Pavaresia e Kosoves –fakt juridik që nuk mund te zhbehet –Deshmi për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë”, Prishtine, 2013 fq. 223

qasja tradicionale e së drejtës ndërkombëtare, e manifestuar me njohjen formale të sovranitetit të Serbisë mbi Kosovën, binte në kontradiktë me njohjen praktike të UNMIKU-ut/ Kosovës si një aktor ndërkombëtar i pavarur me një marrëveshje të kufizuar në zbatimin e pushtetit.

Gjatë kësaj periudhe kohore Kosova ka arritur të hyjë dhe të bëhet pjesë e disa organizmave ndërkombëtarë në fusha të ndryshme, me fokus të veçantë në institucionet që merren kryesisht me çështje të ekonomisë, sigurisë dhe energjisë.

“Me iniciativën e vet UNMIK-u ka nënshkruar edhe marrëveshje në sferën e sigurisë me Republikën e Maqedonisë për sa i përket policisë dhe bashkëpunimit ndërkufitar, verifikimit të përbashkët të personave të fshehur dhe në kërkimin dhe shkëmbimin e ekspertizës së forensikës dhe riadhesimit ndërkufitar të mbetjeve mortore të identifikuara. Përveç faktit që administrata e UNMIK-ut arriti të nënshkruajë një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh dhe traktatesh në emër të Kosovës –marrëveshje të cilat përmirësuan ndërveprimin dhe bashkëpunimin e Kosovës me shtete, nisma dhe organizata të tjera, kryesisht në fushën e ekonomisë – kjo organizatë administruese nuk arriti të bënte vlerësimin se sa kapacitete duhen për ndërtimin e Kosovës në fushën e politikës së jashtme dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Një gjë e tillë pati edhe efektet e veta negative në vitet e mëvonshme kur edhe Kosova themeloi Ministrinë e Punëve të Jashtme, që erdhi si rezultat i shpalljes së pavarësisë së saj më 2008”.⁴⁸

⁴⁸ Marleku, Alfred, “Shtetet e Vogla dhe Siguria Ndërkombëtare”, Punim Doktorate, Shkup 2016, fq. 162-164

1.4. Pavarësia dhe formimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës si koncept dhe si veprim merr kuptim të mirëfilltë vetëm pas pavarësisë, atëherë kur edhe realisht fillon të konsolidohet në të gjitha dimensionet saj. “Ministria e jashtme është ajo pjesë e administratës shtetërore e cila është ngarkuar me realizimin e politikës së jashtme. Kjo, natyrisht, vlen për të gjitha ministritë e jashtme, pra për institucionet e secilit shtet, që janë zhvilluar për menaxhimin e realizimit të punëve të jashtme.”⁴⁹

Nga ky moment fillojnë edhe kontaktet institucionale në skenën ndërkombëtare, të cilat tashmë e njohin ministrinë e jashtme si subjekt reprezentativ mbi politikat e jashtme të shtetit të Kosovës. “Mbajtja e kontakteve, përkatësisht komunikimit me subjektet e tjera në bashkësinë ndërkombëtare është, në njërën anë, verifikim i shtetformimit vetjak: Ministria e Punëve të Jashtme është kanal nëpër të cilin do të duhet të kalonte i tërë prezentimi i qeverisë së shtetit tjetër dhe organ reprezentativ pranë organizatës ndërkombëtare.”⁵⁰

Sipas Sabri Kiçmarit, sukcesi në krijimin e shërbimit diplomatik dhe konsullor vë shtylla të qëndrueshme për zhvillim të diplomacisë efikase, kurse “zgjdhja” e problemeve të kësaj sfere, duke ndjekur një politikë improvizuese, pa shumë ide strategjike, lë pasoja afatgjata. Andaj, sipas tij, shteti i ri duhet të hartojë një strategji për themelimin, e pastaj edhe për avancimin gradual të rrjetit të vet të misioneve diplomatike dhe konsullore.

⁴⁹ Jazbec, Milan, “Bazat e Diplomacisë”, Tetovë, 2017 fq. 97

⁵⁰ Haxhimehmeti, Gjenis, “Politika e jashtme e shteteve të vogla” ISPN, Shkup, 2016, fq. 136.

“Kosova është shembulli tipik për të analizuar formimin e rrjetit të misioneve diplomatiko-konsullore. Si shtet i ri, disa muaj pas pavarësisë dhe themelimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Kosova ka dërguar dhjetë diplomatët e parë, në fillim në rangun e të ngarkuarve me punë, pastaj si ambasadorë, në disa prej shteteve kryesore që deri atëherë e kishin njohur pavarësinë e saj. Këto misione u akredituan në Uashington, Londër, Paris, Romë, Vjenë, Tiranë, Berlin, Bruksel, Ankara dhe Bernë. Më pas, misionet diplomatike gradualisht janë shtuar edhe në disa vende strategjike të rajonit (Ballkanit), në kryeqendra të tjera të mëdha të botës, si në Tokio, Kanberë etj”.⁵¹

Ky rrjet i përfaqësimit diplomatik, sipas ambasadorit të parë të Kosovës në Vjenë, Sabri Kiçmari, është themeluar dhe funksionalizuar duke u fokusuar në tri drejtime kryesore:

“- Orientimi gjeografik (mbulimi i sa më shumë vendeve të UE-së dhe NATO-s, shtrirja tejkontinentale - Uashington, Tokio, Riad dhe Kanbera);

- Orientimi politik (hapja e përfaqësive diplomatike në Bruksel dhe Vjenë, dhe përfaqësi konsullore në Nju Jork për të lobuar në organizatat ndërkombëtare të vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën);

Orientimi i kuadrit (angazhimi i stafit konform mundësive reale financiare dhe profesionale të vendit)”.⁵²

Autori Gani Mehmetaj vlerëson se në Ministrinë e Jashtme duhet të ndryshojë mendësia e rekrutimit të kuadrove, pra e diplomatëve. Sipas tij, duhet të ketë më pak interferenca politike. “E para e punës duhet të jenë të arsimuar, të kultivuar, me njohuri të thella nga marrëdhëniet ndërkombëtare, diplomatë të karrierës që e duan dhe e njohin punën. Pastaj duhet të jenë njerëz me finesa diplomatike, të nuancuar dhe të shkathët, pos faktit kryesor që duhet të dinë edhe disa gjuhë të mëdha, duhet të dinë edhe gjithçka për shtetin ku shkojnë dhe për rrjedhat ndërkombëtare”.⁵³

⁵¹ Kiçmari, Sabri, “Hyrje në Diplomaci”, Logos A, 2013, fq .125

⁵³ Intervistë e zhvilluar me autorin Gani Mehmetaj, 16.09.2017

Ne kemi bërë përpjekje që ta vendosim me çdo kusht Kosovën në hartën e botës; qoftë në hartën rajonale, qoftë në hartën evropiane, qoftë në hartën globale, vë në dukje diplomati, Enver Hoxhaj. "Viti si hapësirë kohore e punës, e kohës sa kam qenë unë ministër i jashtëm është përcjellë me një qartësi se cilat vende duhet të vizitohen, çka presim prej këtyre vizitave, cilat qëllime mund t'i përmbushim, dhe mandej kemi arritur që realisht t'i përmbushim disa prej pritjeve tona, qëllimi jonë ka qenë 2011-ta pasi është marrë vendimi nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Pritej që vetvetiu ky vendim do të prodhonte njohje të reja. Mua më është dashur të lëviz në gjeografi të ndryshme nëpër botë, me qëllim që ta rrisnim numrin e vendeve të cilat e njohin Kosovën.

Dhe jo vetem që është dashur t'i vizitojmë këto vende, por edhe ta kemi një diskurs të menduar mirë, një konstrukt të qartë mendor në takim me çdokënd, se një vend duhet ta njohë Republikën e Kosovës. Në vende të ndryshme ne kemi dëshmuar me argumente se pse duhet njohur pavarësia e Kosovës".⁵⁴

⁵⁴ Intervistë me ish ministrin e MPJ-së së Kosovës, Enver Hoxhaj, 03.10.2018

Pjesa 2

Diplomacia dhe politika e jashtme

2.1. Ç'është politika e jashtme?

Ekzistojnë shumë definime se çfarë përfaqëson politika e jashtme. Dhe këto definime variojnë nga një teori në tjetrën dhe nga një autor te tjetri. Por, gjithsesi, politika e jashtme ka të bëjë me gjithë spektrin e marrëdhënieve të një shteti si subjekt në arenën ndërkombëtare.

“Konsiderohet se politika e jashtme është një veprimtari strategjike dhe e koordinuar përmes së cilës shtetet, nga njëra anë, mbajnë linja të përhershme të komunikimit me shtetet dhe subjektet e tjera në marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe nga ana tjetër, tentojnë që të ndikojnë në sjelljet e këtyre subjekteve”.⁵⁵

Një përkufizim klasik jepet nga Walter Carlsnaes, sipas të cilit politika e jashtme paraqet „ato veprime që, të shprehura nga shtetet në formën e qëllimeve, të angazhimeve dhe/ose direktivave të deklaruara qartë, si dhe të ndjekura nga përfaqësuesit qeveritarë, që veprojnë në emër të komuniteteve të tyre sovrane, drejtohen nga objektivat, kushtet dhe aktorët qeveritarë dhe joqeveritarë - që ata dëshirojnë t'i realizojnë dhe që shtrihen përtej legjitimitetit të tyre territorial“. (Carlsnaes, 2002:335).⁵⁶

Ekzistojnë edhe definime të tjera, por që kryesisht ndërlidhen me raportet e një shteti në arenën ndërkombëtare. “Politika e jashtme është veprimtari e shtetit me të cilën ky i realizon qëllimet dhe interesat e veta në mjedisin ndërkombëtar”.⁵⁷

Benko e përcakton politikën e jashtme si „proces dhe sistem i aksioneve“ që i zhvillon shoqëria e organizuar në shtet, në mjedisin ndërkombëtar, me qëllim që të ndikojë në të, në pajtim me qëllimet dhe interesat e faktorëve politik të cilët veprojnë në emër të tij.⁵⁸

⁵⁵ Reka, Ylber, Bardhok, Bashota, Ylber Sela, “Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, Instituti për studime politike dhe ndërkombëtare, Shkup, 2016, fq. 219

⁵⁶ Smith, Steve; Hadfield, Amelia; Dunne, Tim, “Foreign policy theories, actors, cases”, Oxford, University press, 2008, fq.27

⁵⁷ Petric, Ernest, “Politika e Jashtme”, Prishtinë, 2012 fq. 15

⁵⁸ Vladimir, Benko, “Znanost o mednarodnih odnosih”, Lublanë, 1997 fq. 227

Studiuesi Abdullah Jonuzi politikën e jashtme e vendos në një kontekst më të gjerë. “Politika e jashtme e dikton një vend se si të veprojë politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht në lidhje me vendet e tjera, dhe në një masë disi më të vogël, se si ajo sillet në drejtim të aktorëve joshtetërorë”.⁵⁹

Politika e jashtme në fakt përfaqëson një kompleksitet raportesh të brendshme dhe të jashtme. “Ajo është dizajnuar me qëllim që t’i ndihmojë qeveritë për t’i mbrojtur interesat nacionale, sigurinë e vendit të tyre, pikëpamjet ideologjike, qëndrimet politike dhe prosperitetin ekonomik”.⁶⁰

Politika e jashtme, vë në dukje diplomati Hoxhaj, ndodh jashtë vendit, por natyra e saj përcaktohet brenda tij. “Ajo determinohet nga karakteri demokratik i shtetit, dinamika të tjera ekonomike, sociale dhe kulturore dhe nga zhvillimet ndërkombëtare, të kaluarës historike dhe pozitës gjeografike”.⁶¹

Hoxhaj e zgjeron edhe më tej këtë koncept duke u bazuar thellësisht në realitetin e Kosovës. “Për shkak të rrethanave Kosova ka zgjedhur të ketë një politikë të jashtme të kufizuar në çështje thelbësore për ekzistencën dhe zhvillimin e saj. Natyrisht, sot dhe në të ardhmën, mbrojtja e interesave të qytetarëve do të mbetet prioriteti i saj”.⁶²

Gjithashtu ai thekson se historia do të tregojë nëse politika e jashtme e Kosovës ka qenë në lartësinë e objektivave të përcaktuara nga realitet e brendshme dhe të jashtme.

“Historia do të vlerësojë drejt dhe me kohë nëse politika e jashtme e Kosovës ka ndjekur qëllime të qarta në mbrojtjen dhe ndjekjen e interesit shtetëror të saj. Vlerësimi më objektiv do të jetë peshorja e kohës se me sa efikasitet janë përdorur burimet e brendshme, sa janë shfrytëzuar rrethanat ndërkombëtare dhe faktorët e tjerë në përmbushjen e objektivave të përcaktuara”.⁶³

⁵⁹ Abdullahi, Jonuz, “Politika dhe Politika Publike”, Universiteti i Evropës Juglindore, Botimi i dytë, Tetovë, 2011, fq. 149-150

⁶⁰ Baliqi, Bekim, “Hyrje në Diplomaci dhe Politikë të Jashtme”, Prishtinë, 2010, fq. 24

⁶¹ Hoxhaj, Enver “Ngritja e një shteti”- Politika e Jashtme e Kosovës, Tiranë, 2016, fq. 14

⁶² Po aty, fq. 16

⁶³ Po aty, fq. 68-69

Sigurisht, definimet janë të shumëllojta, por esenca e politikës së jashtme mbetet e ndërlidhur me shtetin, me organizimin e brendshëm të tij dhe që më pas hyjnë në raport me një shtet tjetër. “Detyra e diplomacisë (shërbimit) së shtetit modern përbëhet në këtë formë: në mënyrë organizative t’ia bëjë të mundur shtetit udhëheqjen e politikës së jashtme, të ashtuquajturat punë të jashtme të shtetit. Politika e jashtme konsiston në qëllimet dhe masat të cilat kanë synimin t’i udhëheqin vendimet dhe veprimet e qeverive për sa u përket qështjeve të jashtme, sidomos marrëdhëniet me vendet e huaja. Drejtimi i marrëdhënieve të jashtme kërkon plane veprimi të menduara me kujdes, që janë të përshtatura me interesat dhe shqetësimet e jashtme – d.m.th. synimet e qeverisë”.⁶⁴

Nga kjo që u prezentua mund të konstatojmë se për politikën e jashtme ekziston një laramani qasjesh dhe konceptesh, si nga aspekti i interesit kombëtar, pozita e tij gjeopolitike, nga opinioni publik, ashtu edhe nga aspekti i analizës krahasuese të dukurive shoqërore në të kaluarën dhe interpretimin e tyre në rrethanat bashkëkohore. Thënë më shkurt, politika e jashtme varet nga raportet e politikës së brendshme në shtet.

Dihet botërisht se Kosova ka bërë një luftë çlirimtare kundër një pushtuesi shumë herë më të fortë. Pasojat e asaj lufte ishin shumë të mëdha në të gjitha aspektet. Kosova vetëm në vitin 2008 është shpallur e pavarur. Duke e ditur se krijimi i një shteti, i institucioneve të tij, duke e përfshirë këtu edhe institucionin e diplomacisë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, kalon nëpër sfida të mëdha dhe me shumë të panjohura, atëherë mund të themi se një sfidë e madhe dhe shumë e veçantë ka qenë edhe organizimi i politikës së jashtme dhe i diplomacisë. Së paku deri në vitin 2008 Kosova ka shkuar me hapa të ngadalshëm në procesin e organizimit të diplomacisë. I ngadalshëm kur kemi parasysh sfidat me të cilat u ballafaqua. Ky është perceptimi i shumë diplomatëve, por edhe i autorëve që si fokus e kanë politikën e jashtme të Kosovës.

⁶⁴ Jacson Robert & Sorensen Georg, “Hyrye në mardhëniet ndërkombëtare –Teoritë dhe qasjet”, Tiranë, 2013 fq. 264

“E para, deri në shpalljen e pavarësisë në Kosovë UNMIK-u ka qenë sovrani për çdo gjë, pra e ka kontrolluar, pse jo edhe e ka vonuar, mbase edhe penguar konsolidimin e diplomacisë për arsye të neglizhencës dhe burokracisë. Kosova ka arritur rezultate të dukshme si njohja e pavarësisë së saj nga 115 shtete, antarësimi në disa organizata dhe mekanizma ndërkombëtarë, bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve me Shqipërinë, SHBA-në, BE-në, ka krijuar raporte më relaksuese me disa shtete fqinje, si Maqedonia e Veriut, pjesërisht Mali i Zi, pastaj ka filluar dialogu mes Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin ndërkombëtar etj“.⁶⁵

Ish ministri i MPJ-së të Kosovës, Enver Hoxhaj, duke folur mbi sfidat, të arriturat dhe mangësitë aktuale të politikës së jashtme të Kosovës vë në dukje se “në këto dy vitet e fundit kemi rënie, dhe kjo paraqet një shqetësim serioz për mua. Në kohën sa kam qenë unë ministër i jashtëm, e kam thënë edhe disa herë publikisht, nuk kam pranuar që Serbia ta jetësojë një qëllim politik në raport me Kosovën, ku qëllimi i politikës së saj të jashtme ka qenë që Kosova të mos ketë fare politikën e saj të jashtme, që për ne është i vetmi dimension i komunikimit ndërkombëtar, që të jetë dialogu Kosovë - Serbi“.⁶⁶

Në vazhdim po e paraqesim skemën e shteteve që e kanë njohur Kosovën nga shpallja e pavarësisë:

Tabela nr.1

Nr.	Shteti	Data e njohjes
1.	Republika e Kosta Rikës	17.02.2008
2.	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	18.02.2008
3.	Republika e Francës	18.02.2008
4.	Republika e Shqipërisë	18.02.2008
5.	Republika e Turqisë	18.02.2008
6.	Mbretëria e Bashkuar	18.02.2008
7.	Republika e Afganistanit	18.02.2008
8.	Australia	19.02.2008

⁶⁵ Intervistë e zhvilluar me Prof.dr Zeqirija Idrizi, 05.10.2017

⁶⁶ Intervistë e zhvilluar me ministrin e MPJ-së të Kosovës Enver Hoxhaj, 03.10.2018

9.	Republika e Senegalit	19.02.2008
10.	Republika Federale e Gjermanisë	20.02.2008
11.	Republika e Letonisë	20.02.2008
12.	Mbretëria e Danimarkës	21.02.2008
13.	Republika e Estonisë	21.02.2008
14.	Republika e Italisë	21.02.2008
15.	Luksemburgu	21.02.2008
16.	Republika e Perusë	22.02.2008
17.	Mbretëria e Belgjikës	24.02.2008
18.	Republika e Polonisë	26.02.2008
19.	Konfederata e Zvicrës	27.02.2008
20.	Republika e Austrisë	28.02.2008
21.	Republika e Irlandës	29.02.2008
22.	Mbretëria e Suedisë	04.03.2008
23.	Holanda	04. 03.2008
24.	Islanda	05. 03.2008
25.	Republika e Sllovenisë	05. 03.2008
26.	Republika e Finlandës	07. 03.2008
27.	Japonia	18. 03.2008
28.	Kanada	18. 03.2008
29.	Principata e Monakos	19. 03.2008
30.	Republika e Hungarisë	19. 03.2008
31.	Republika e Kroacisë	19. 03.2008
32.	Republika e Bullgarisë	20. 03.2008
33.	Principata e Lihteshtajnit	25. 03.2008
34.	Republika e Koresë	28. 03.2008
35.	Mbretëria e Norvegjisë	28. 03.2008
36.	Ishujt Mareshal	17.04.2008
37.	Burkina Faso	23.04.2008
38.	Republika e Naurusë	23.04.2008
39.	Republika e Lituanisë	06.05.2008
40.	Republika e San Marinos	12.05.2008
41.	Republika e Çekisë	21.05.2008
42.	Republika e Liberisë	30.05.2008
43.	Republika e Siera Leones	11.06.2008
44.	Republika e Kolumbisë	04.08.2008
45.	Belize	07.08.2008
46.	Republika e Maltës	22.08.2008
47.	Shteti i Pavarur i Samoas	15.09.2008

48.	Republika e Portugalisë	07.10.2008
49.	Mali i Zi	09.10.2008
50.	Republika e Maqedonisë së Veriut	09.10.2008
51.	Emiratet e Bashkuara Arabe	14.10.2008
52.	Malajzia	30.10.2008
53.	Shtetet Federale të Mikronezisë	05.12.2008
54.	Republika e Panamasë	16.01.2009
55.	Republika e Maldiveve	19.02.2009
56.	Republika e Palausë	06.03.2009
57.	Republika e Gambisë	07.04.2009
58.	Mbretëria e Arabisë Saudite	20.04.2009
59.	Bashkimi Komorosë	14.05.2009
60.	Mbretëria e Bahreinit	19.05.2009
61.	Mbretëria e Jordanisë	17.07.2009
62.	Republika Domenikiane	10.07.2009
63.	Zelanda e Re	09.11.2009
64.	Republika e Malavit	14.12.2009
65.	Mauritania	14.09.2010
66.	Mbretëria e Suazilandit	12.04.2010
67.	Republika e Vanuatit	28.04.2010
68.	Republika e Xhibutit	08.05.2010
69.	Republika Federale e Somalisë	19.05.2010
70.	Republika e Hondurasit	03.09.2010
71.	Republika e Kiribatit	29.10.2010
72.	Tuvalu	18.11.2010
73.	Shteti i Katarit	07.01.2011
74.	Republika e Guinesë - Bisaos	10.01.2011
75.	Sulltanati i Omanit	04.02.2011
76.	Principata e Andorës	08.06.2011
77.	Republika e Afrikës Qendrore	22.07.2011
78.	Republika e Guinesë	12.08.2011
79.	Republika e Nigerisë	15.08.2011
80.	Republika e Beninit	18.08.2011
81.	Santa Luçia	19.08.2011
82.	Republika e Gabonit	15.09.2011
83.	Republika e Bregut të Fildishtë	16.09.2011
84.	Shteti i Kuvajtit	11.10.2011
85.	Republika e Ganës	23.01.2012

86.	Republika e Haitit	10.02.2012
87.	São Tomé and Príncipe	13.03.2012
88.	Brunei Darusulam	25.04.2012
89.	Republika e Çadit	01.06.2012
90.	Republika Demokratike e Timorit Lindor	20.09.2012
91.	Guinea e Re	03.10.2012
92.	Republika e Burundit	16.10.2012
93.	Republika e Fixhit	19.11.2012
94.	Shën Kits dhe Nevis	28.10.2012
95.	Komunuelthi i Domenikës	11.12.2012
96.	Republika Islamike e Pakistanit	25.12.2012
97.	Republika e Guajanës	16.03.2013
98.	Republika e Tanzanisë	29.05.2013
99.	Republika e Jemenit	11.06.2013
100.	Republika e Egjiptit	26.06.2013
101.	Republika e El Salvadorit	29.06.2013
102.	Mbretëria e Tajlandës	24.09.2013
103.	Grenada	25.09.2013
104.	Shteti i Libisë	25.09.2013
105.	Mbretëria e Tongos	15.05.2014
106.	Mbrëtëria e Lesotës	11.02.2014
107.	Republika e Togolesë	02.07.2014
108.	Ishujt Solomonë	05.08.2014
109.	Ishujt Kuk	18.05.2015
110.	Antigua dhe Barbuda	19.05.2015
111.	Niue	23.06.2015
112.	Republika e Surinamit	08.07.2016
113.	Republika e Singaporit	01.12.2016
114.	Republika Popullore e Bangladeshit	27.02.2017
115.	Madagaskari	24.11.2017
116	Barbadosi	15.02.2018

Burimi: <http://www.mfa-ks.net/?page=1,259> rigjetur më 13.10.2018 ⁶⁷

2.2. Procesi i organizimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës është themeluar më 13 mars të vitit 2008. Themelimi i saj është bazuar në Ligjin nr. 03/L-044, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi punët e jashtme dhe shërbimet diplomatike. MPJ-ja, sipas mandatit të saj, i mbrohet interesat e Kosovës në raport me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare në koordinim të plotë me ministritë e tjera, Zyrën e Presidentit dhe institucionet e tjera të Kosovës, në përputhje të plotë me Ligjin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Politika e jashtme e shteteve të vogla ndryshon në varësi të rrethanave, dhe zakonisht, interesat e tyre përfshijnë kryesisht ruajtjen e paqes dhe stabilitetit.

“Ndër detyrat kryesore të Kosovës është dhe ndërtimi dhe konsolidimi i politikës së saj të jashtme. Që nga ajo kohë politika e jashtme e Kosovës është fokusuar në disa objektiva strategjike. Mirëpo objekti themelor i saj ka qenë dhe mbetet, (siç definohet edhe në dokumentin strategjik: “Objektivat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës”), përmbyllja e procesit të njohjes ndërkombëtare të shtetit dhe anëtarësimi në orgnizatrat kryesore ndërkombëtare dhe nismat rajonale”.⁶⁸

Natyrisht fillimi ka qenë i vështirë, por edhe sfidues në të njëjtën kohë, sepse Kosova nuk ka patur asnjëherë më parë MPJ-në para shpalljes së pavarësisë, ndërkohë që i ka patur të gjitha digasteret e tjera qeverisëse pa MPJ-në.

“Avni Spahiu ka qenë ambasadori i parë i emëruar në Uashington, Muhamet Hamiti në Londër, Muhamedin Kullashi në Paris, Ilir Dugolli në Bruksel, Sabri Kiçmari në Vjenë, Albert Prenkaj në Romë, e kështu me radhë. Gjithsej kanë qenë 11 ambasada dhe 9 zyra konsullore, ose konsullata që i kemi hapur.

⁶⁸ Alfred, Marleku, “Shtetet e Vogla dhe Siguria Ndërkombëtare”, Punim Doktorate, Shkup 2016, fq. 167

Në fillim shumë shpejt kemi hapur konsullatë në Nju Jork, sepse na duhej për komunikim me vendet anëtare të OKB-së. Dhe konsullja e parë e përgjithshme në Nju Jork ka qenë Arta Rama, e cila tash është edhe kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme është krijuar dhe diplomacisë së një shteti. Kjo është ingerenca e saj, sipas organizimit të strukturës së qeverisë ose ekzekutivit të një shteti. Për shembull, në Republikën e Kosovës, udhëheqja e politikës së jashtme është kompetencë e presidentit të vendit“.⁶⁹

Ky organizim nënkupton gjithë strukturimin e politikës së jashtme të Kosovës. „Pas presidentit, një rol të rëndësishëm në politikën e jashtme e ka edhe kryeministri“.⁷⁰

Sipas Hajdin Abazit, “pavarësisht kësaj, në aspektin e parashtrimit, organizimit dhe zbatimit diplomatik, Ministria e Punëve të Jashtme është laborator kryesor dhe përmes saj duhet të kalojë dhe të materializohet e tërë diplomacia kosovare“.⁷¹

⁶⁹ Neni 84 {Kompetencat e Presidentit}, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor, 2008

⁷⁰ Neni 93 {Kompetencat e Presidentit}, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor, 2008

⁷¹ Abazi, Hajdin, “Diplomacia-disiplinë e mëvetësishme“, Trendi Global, Revistë Shkencore, Prishtinë 2009, fq. 86




Figura nr. 1.2 Organogrami i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës⁷²

Në kryje të MPJ-së është ministri dhe zëvendësit e tij. Ministri i ka këshilltarët e vet, por duhet të ketë edhe grupe projektuese të politikave të jashtme. Pas tyre vijnë strukturat e tjera, zakonisht të organizuara në sektorë të ndryshëm. Ndër sektorët më relevantë janë: sektori bilateral (për bashkëpunim me shtetet fqinje, Evropën, Amerikën, Azinë, Afrikën, Australinë dhe Oqeaninë, kulturën ndërkombëtare), sektori multilateral (për bashkëpunim me OKB-në, BE-në, politikat e sigurisë, diplomacisë ekonomike dhe për analiza dhe hulumtime), sektori ndërkombëtar, sektori konsullor, sektori diplomatik etj.⁷³

⁷² <http://www.mfa-ks.net/?page=1%2C37>, rigjetur më 17.09.2017

⁷³ Abazi, Hajdin, "Diplomacia-Disiplinë e mëvetësishtme", Trendi Global, Revistë Shkencore, Prishtinë, 2009, fq. 86

Kuptohet se secili prej këtyre sektorëve i ka fushat e veta të përcaktuara qartë dhe që merret me elaborimin e politikave përkatëse, që më pastaj ato të shndërrohen në qëndrime diplomatike. Janë tri lloje të përfaqësive diplomatike: ambasada, misionet diplomatike pranë organizatave ndërkombëtare dhe konsullata. Konsullatat mund të kategorizohen më tej në konsullata gjenerale, konsullata, nenkonsullata dhe agjenci konsullore. Natyrisht se mund të ndryshojnë emërtimet ose nivelet e ndryshme, me kompetenca dhe detyra të përgjithshme ose të veçanta.

“Rrjetet e përfaqësimit diplomatik ndërtohen mbi bazën e disa kriterëve, të cilat përcaktohen sipas nevojave të një shteti. Kriteret e tilla mund të jenë, bie fjala, kriteri gjeografik, politik, i kuadrit, organizativ, fleksibiliteti dhe reciprociteti, ku secili prej tyre i ka specifikat e veta dhe kryen funksione të veçanta”.⁷⁴

Sipas shumë autorëve, politika e jashtme është ajo që e dikton një vend se si të veprojë në sferën e politikës, ekonomisë së vendit dhe shumë sferave në lidhje me vendet e tjera, dhe në një masë disi më të vogël, se si ajo sillet në drejtim të aktorëve joshitetërorë.

2.2.1. Organizimi i rrjetit diplomatiko-konsullor

Kosova ka shtrirë rrjetin e vet modest diplomatik deri në optimum, duke mbuluar disa prej shteteve më të rëndësishme në botë, me gjithsej 26 misione diplomatike.⁷⁵

“Edhe rrjeti konsullor i Kosovës është gjeografikisht i përhapur mirë në shtetet apo qytetet ku është e përqëndruar mërgata kosovare. Momentalisht janë 27 pika konsullore të Kosovës, të cilat përfshijnë konsullatat e përgjithshme, dhe konsujt që kryejnë funksionet e tyre pranë misionëve diplomatike”.⁷⁶

Ambasada e fundit është hapur vitin e kaluar në Senegal, Afrikë. “Kjo flet për orientimin që të shtrihemi gradualisht edhe jashtë kontinentit evropian, gjithnjë duke u vënë në zbatim të atyre postulateve e premisave që janë përcaktuar me teori e me praktikë diplomatike në tërë botën, (me kodifikime përkatëse, si Konventa e Vjenës

⁷⁴ Po aty, fq. 8

⁷⁵ <http://www.mfa-ks.net/?page=1,171> dt: 03.09.2017

⁷⁶ <http://www.mfa-ks.net/?page=1,67> dt: 03.09.2017

etj.) si qëllime themelore të misioneve të tilla, pra përfaqësimi, mbrotja e interesave të vendit të dërgimit, prezantimi në vendin tonë i karakteristikave të këtyre vendeve”.⁷⁷

Barbadosi është vendi i 116-të që e njohu pavarësinë e Republikës së Kosovës. Krijimi i marrëdhënieve diplomatike ndërmjet shteteve, si dhe ngritja e misioneve apo e përfaqësive diplomatike ndërmjet tyre, pason në bazë të marrëveshjes së interesit dhe vullnetit reciprok, d.m.th. kjo çështje nuk është obliguese dhe e imponuar, por një çështje e vullnetit dhe e interesave të vetë shteteve.

“Me formimin e një misioni diplomatik në një vend të huaj apo në një organizatë ndërkombëtare, themelohet një raport apo marrëdhënie juridike në rrafshin e së drejtës ndërkombëtare, një raport në kuadër të marrëdhënieve ndërshtetërore dhe atyre ndërkombëtare. Diplomacia është njëra ndër shtyllat themelore të së drejtës ndërkombëtare. Si shkencë ajo i përket kohës së re, shekullit 18 dhe 19, ndërsa kontaktet dhe marrëdhëniet diplomatike hasen nga antika e paraantika e vjetër”.⁷⁸

2.3.Politika e jashtme e Kosovës në periudhën 2008-2017

Në intervistën e dhënë për këtë punim, autori Gani Mehmetaj vë në dukje se “politika e jashtme ka bërë përpjekje për t’u lidhur më shumë me kontinentin e vjetër të cilit i takojmë. Por shteti ka patur bredhje nga lindja, kryesisht një lidhje paksa e çoroditur me Turqinë, konkretisht me një personalitet siç është Erdogan, pa e përfillur fare opozitën turke, me të cilët diplomacia jonë duhet të ketë kontakte”.

Sipas tij, ka edhe më tutje përpjekje për integrim në BE, mirëpo ky bashkim kërkon disa kushte, të cilat shteti ynë nuk i plotëson, ashtu sikundër nuk ka gatishmëri që t’i plotësojë. Ndërkaq, Ibrahim Gashi, profesor në Universitetin e Prishtinës thekson se “përgjithësisht ka patur arritje të matshme në çështje të caktuara, por edhe ngecje përballë çështjeve shumë sfiduese”.

⁷⁷ Intervistë e zhvilluar me diplomatit e parë të Kosovës në Maqedoni, Skender Durmishi, 27.08.2017

⁷⁸ Zenelaj, Eqrem, “Diplomacia-Misionet Diplomatike dhe Konsullore”, fejtton dhe ligjëratat.

Ish ministri i parë i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Skënder Hyseni vë në dukje se “përmes komunikimit qoftë biletal, qoftë multilateral në botë, përmes ndërtimit të rrjetit diplomatik dhe punës së rrjetit diplomatik, përmes anëtarësimit të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë të bashkëpunimit, është zhvilluar një progres i lakmueshëm në diplomacinë e Kosovës”.

Duke marrë parasysh faktin se çfarë ka kaluar Kosova nëntë vite më herët, vëren diplomati Zeqirija Idrizi, pavarësia e saj është një lloj mrekullie që është arritur me shumë sakrifica gjeneratash dhe kjo vlen të mbahet mend gjithmonë në çfarëdo lloj analize kur flitet për këto vitet e paspavarësisë.

Këto nëntë vite, sipas tij, janë praktikisht kohë të konsolidimit, dhe ka ndikuar që një nga shtetet më të reja në Evropë dhe në botë të ketë përparësitë dhe karakteristikat e këtij procesi i cili ka involvuar edhe një numër të madh njohjesh. Kështuqë sot Kosova është një realitet i njohur nga më shumë se 100 shtete anëtare të OKB-së, shtetet më të mëdha të Bashkimit Evropian dhe të botës. Mirëpo, anëtarësimi në njërën nga organizatat më të rëndësishme multilaterale, mbetet të shihet më tutje për një dialog i cili ndodh në mes Kosovës dhe Serbisë, dhe kjo me siguri do të ketë dhe një epilog të mëtejshëm.

“Konsideroj se Kosova ka zgjedhur me apo pa dëshirë një politikë të jashtme të kufizuar. Nuk e di nëse kjo është e drejtë dhe rezultative, apo nëse kishte mundësi, forma dhe mënyra të tjera veprimi. Një gjë e di se ka qenë e nevojshme që politika e jashtme të ishte më energjike, më e konsoliduar, më pragmatike... Një dështim për anëtarësim në UNESKO, tash edhe në INTERPOL, pa harruar ngadalësimin e shtimit të njohjeve, nënshkrimin e marrëveshjeve për demarkacionin dhe asociacionin dhe mospërmbyjsja e detyrimeve të tjera ndërkombëtare... sikur të krijojnë përshtypjen se ka patur mundësi të bëhet më shumë dhe më mirë. Natyrisht se ka edhe të arritura, por për disa çështje lë shumë për të dëshiruar”.⁷⁹

⁷⁹ Intervistë e zhvilluar me prof.dr. Zeqirija Idrizi, 05.10.2017

2.4. Sfidat aktuale të politikës së jashtme të Kosovës

Sot për Kosovën mbetet sfida njohja e plotë ndërkombëtare. Doplmati Enver Hoxhaj pohon se njohja dhe integrimi në sistemin ndërkombëtar janë të kushtëzuara nga rrethanat e veçanta të krijimit të shtetit të Kosovës. Sipas tij, me gjithë arritjet e shumta që janë bërë, si problem mbetet njohja nga të gjitha vendet e BE-së, si dhe nga vendet e tjera në botë. Së bashku me njohjen, prioritet tjetër është edhe anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare. “Shteti i ri tashmë është anëtar i plotë i më shumë se 50 organizatave rajonale e ndërkombëtare. Megjithatë, sfida kryesore edhe më tutje mbetet pranimi në OKB. Kjo kërkon vullnet dhe mendim strategjik dhe do të përbënte një ringritje të Kosovës në planin ndërkombëtar”.⁸⁰

Sfidë tjetër për shtetin e ri, Kosovën, mbetet anëtarësimi në BE. Nëse Kosova nuk bëhet anëtare e BE-së dhe NATO-s, si vend i vogël nuk mund t’i përballojë sfidat rajonale, ato ndërkombëtare, por edhe më e vështirë është që si shtet i ri të pozicionohet përballë zhvillimeve globale.

Gjithashtu për Kosovën është me rëndësi anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ngaqë kjo ia garanton në njëfarë mënyre barazinë juridike me shtetet e tjera. Duke i patur parasysh të gjitha këto sfida që i ka Kosova si shtet i ri, nuk guxon të dorëzohet para të gjitha sfidave që e presin në të ardhmen.

Kosova si shtet i ri ka mjete të kufizuara për përdorimin në politikën e jashtme. Ajo ende nuk e ka përfunduar tërësisht konsolidimin e aparatit të vet diplomatik dhe po përballlet me “sëmundje foshnjore” të shtetndërtimit. Politika e saj e jashtme ende është e orientuar për arritjen e objektivave strategjike si antarësimi në OKB dhe fitimi i njohjeve të reja ndërkombëtare”.⁸¹

⁸⁰ Hoxhaj, Enver “Ngritja e një shteti”-Politika e jashtme e Kosovës, Tiranë 2016, fq. 15

⁸¹ Haxhimehmeti, Gjenis “Politika e jashtme e shteteve të vogla”, ISPN, Shkup, 2016, fq. 85

Ministria e Punëve të Jashtme ka qenë dhe mbetet e përkushtuar për anëtarësimin e plotë të Republikës së Kosovës në INTERPOL. “Në funksion të këtij qëllimi të përbashkët dhe në koordinim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Kosovës, kemi qenë të angazhuar dhe përkushtuar me përgjegjësinë më të lartë dhe profesionalizmin më të madh, që Kosova sa më parë ta ketë vendin e saj të merituar në këtë organizatë të rëndësishme për sigurinë tonë kombëtare, por edhe atë të vendeve fqinje dhe të rajonit”.⁸²

Bernard Kouchner, ish ministër i Shëndetësisë dhe i Punëve të Jashtme i Francës, gjatë viteve 1999-2000 ka patur postin e kryeadministratorit të Kosovës. Në një intervistë për gazetën “Express” ai është shprehur: “Pra, unë jam i kënaqur për një evolucion që do t’i duhet akoma, ndoshta dhe disa dekada, për t’u përkryer. Nuk ka mjaft investime, nuk ka mjaft zhvillim në Kosovë, për fat të mirë është diaspora kosovare që sjell para”.

“Do duhej që ky vend të mbështetej apo të përkrahej më shumë, jo vetëm me para, por edhe me iniciativa. Eh pra, unë jam i kënaqur që kam kontribuar dhe jam i lumtur që jam kthyer shumë shpesh në Kosovë”.⁸³

Sfidat janë të shumta dhe të shumëllojshme. Sigurimi i njohjes në shkallën e dy të tretave është një synim që duhet arritur. Integrimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare është një sfidë jo e lehtë për politikën e jashtme të saj, për faktin se disa prej tyre kanë mekanizma të tillë pengues në procesin e pranimit (p.sh. e drejta e vetos në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara).

“Duke marrë parasysh se Rusia mban një qëndrim shumë të ashpër kundër pavarësisë dhe integritit të Kosovës në mekanizmat dhe organizatat ndërkombëtare, dhe në të shumtën e rasteve Republika Popullore e Kinës voton kundër pranimit tonë, e komplikon shumë statusin e Kosovës në marrëdhëniet

⁸² <http://www.mfa-ks.net/?page=1,217,4447> rigjetur më 15.10.2017

⁸³ <http://www.gazetaexpress.com/intervista/bernard-kouchner-nuk-me-shqetesoine-idete-e-bashkimit-te-shqiptareve-256624/> rigjetur më 12.10.2017

ndërkombëtare. Kjo gjë varet pak nga politika e jashtme e Kosovës. Rreshtimi ynë pa ekuivoqe në drejtim të perëndimit ka si rezultat një qëndrim të tillë rigid të Rusisë. Politika jonë e jashtme përpiket të notojë në kuadrin e kësaj sfere të krijuar pa dashjen e saj. Sfida e tretë e rëndësishme është integrimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Plotësimi i parakushteve për këtë nga politika jonë është një domosdoshmëri e kohës⁸⁴.

Ministri i Punëve të Jashtme i Italisë, Angelino Alfano thekson se e ardhmja nuk është një fat i pashmangshëm, por sesi popujt i japin kuptim kohës dhe hapësirës. Ne jemi për t'i dhënë kuptim politikës së jashtme të Kosovës, të paktën për vitin 2017. Por është një pikëpamje e ngushtë nëse mendohet se vetëm diplomacia mund t'i japë kuptim. Asaj mund t'i japë kuptim çdo institucion, secila organizatë joqeveritare, media, universitet apo individ, qoftë në politikë ose jashtë saj⁸⁵.

Sipas tij, sot jetojmë në një kohë kur ndryshimi brenda një periudhe dhjetëvjeçare është më i madh sesa gjatë historisë që ishte përbrenda një shekulli. Në një kohë ndryshimesh të tilla shteti i ri i Kosovës duhet të shihet dhe të kuptohet jo vetëm si entitet institucional dhe gjeografik, por edhe si entitet kohor. Për diplomatin Zeqirija Idrizi, ndër pyetjet bazike për vitin 2017 është se “me çfarë shpejtësie vendi ynë mund të lëvizë në raport me të tjerët? Kjo do të thotë se sa do të reformohet Kosova në planin e saj të brendshëm për t'i përmbushur kërkesat e qytetarëve? Sa do të hapet vendi ynë në raport me botën e jashtme, që do të thotë sa do të integrohemi në shoqërinë ndërkombëtare? Kjo ka të bëjë me faktin se sa do të jemi të barabartë me të tjerët me të drejtat dhe mundësitë? Dhe sa do të ecim në hap me kohën?”⁸⁵.

Sipas tij, vetë fakti se po krijohen rrethana të reja në politikën ndërkombëtare, me çka vëmendja e bashkësisë ndërkombëtare nuk është e fokusuar në Kosovë siç ishte dikur, pra Kosova nuk përbën temë edhe aq atraktive kur merren “të mëdhenjtë”, atëherë mendoj se kjo përbën njërin nga sfidat.

⁸⁴ Intervistë e zhvilluar me ambasadorin e parë të Kosovës në Australi, Sabri Kijmari, 27.08.2017

⁸⁵ <http://zeri.info/zerat/123717/politika-e-jashtme-e-kosoves-dhe-faktori-kohe-ne-vitin-2017/>

Në fakt, thekson ai, kjo e pengon edhe mundësinë e njohjeve të reja për Kosovën, duke përfshirë këtu edhe ato shtete evropiane që nuk e kanë njohur ende, integrimi në NATO dhe BE etj., përbëjnë disa sfida me të cilat do të ballafaqohet Kosova dhe politika e saj e jashtme.

“Mirëpo, si prioritet do të duhej të jetë edhe kultivimi i marrëdhënieve me SHBA-në, BE-në, Gjermaninë, Francën, pa lënë anash këtu kujdesin dhe angazhimin për një fqinjësi të mirë me shtetet e rajonit, por jo me logjikën e nënshtrimit dhe partneritetit. Shtimi i njohjeve të shtetësisë së Kosovës, normalizimi i raporteve sidomos me Serbinë, ruajtja e marrëdhënieve me partnerët strategjik, anëtarësimi në organizmat ndërkombëtare, përbëjnë sfidat shtesë dhe afatgjata”.⁸⁶

Profesori Ibrahim Gashi thekson se kompletimi i procesit të njohjes është prioritet absolut i MPJ-së dhe i diplomacisë së Kosovës. Sipas tij, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare mbetet objektivi madhor për diplomacinë dhe shtetin e Kosovës, para së gjithash OKB. Kështu anëtarësimi në organizata rajonale e globale, integrimet evropiane, konsolidimi i mëtejshëm i pozitës së Kosovës në skenën ndërkombëtare. Pra, vë në dukje ai, detyra të shumta e serioze për diplomacinë e Kosovës në procesin e njohjeve të reja, avancimin pozitiv të imazhit të shtetit të Kosovës, ruajtjen e miqësive të vjetra dhe sigurimin e miqësive të reja, për t'i mposhtur paragjykimet e krijuara nga propaganda e ligë antikosovare ose nga mungesa e informacioneve të plota lidhur me Kosovën dhe popullin e saj, të tashmen dhe të kaluarën e saj.

“Disa nga këto prioritete janë të natyrës imediate, ndërsa disa të tjera që kanë të bëjnë me promovimin e vlerave dhe interesave vitale të shtetit të Kosovës, janë të natyrës së përhershme dhe do të jenë gjithmonë detyrë e diplomacisë së Kosovës, përkatësisht si pikë rereference dhe kriter i matjes së rezultatave të saj.

⁸⁶ Intervistë e zhvilluar me prof.dr. Zeqirija Idrizi, 05.10.2017

Njohjet janë aktivitet shumë kompleks në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe më shumë bëjnë pjesë në fushën e marrëdhënieve bilaterale. Derisa nuk kemi një rezolutë të re të KS të OKB-së për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë, çështja e njohjeve mbetet vullnet dhe interes i shteteve veç e veç në raport me shtetin e Kosovës.

Pas shpalljes së pavarësisë ne kemi patur një proces shumë të suksesshëm të njohjeve të shtetit të Kosovës, më pastaj ka ngelur komuniteti i shteteve që nuk kanë disponim dhe interes të mjaftueshëm për ta njohur shtetin e Kosovës. Rrjedhimisht lobimi për njohje nga këto shtete bëhet më i vështirë dhe më sfidues”.⁸⁷

Në intervistën e realizuar, autori Gani Mehmetaj vë në dukje: “Në nëntëvjetorin e pavarësisë Kosovën e shoh ndryshe nga ajo si e kam imagjinuar dhe projektuar në mendimet dhe ëndrrat e mia”. E kam menduar si një shtet normal, thekson ai, si shtet të mundësive dhe energjive të mëdha kreative. E kam menduar si shtet të së ardhmes, ku do të investohej nga Evropa Perëndimore e SHBA-ja. Mirëpo, nuk e kam menduar që elita politike e shtetërore do të jetë kjo që është. Nuk kam menduar që krimi i organizuar, korrupsioni e zhvatja, që nisën me administratën e UNMIK-ut, do të vazhdojnë me intensitet edhe më të madh pas shpalljes së pavarësisë. Për pjesën më të madhe të të rinjve Kosova është bërë shtet i paperspektivës, që nuk u ofron asgjë, prandaj ikin në Perëndim. Ikja është shqetësuese, por edhe më shqetësuese është mungesa e së ardhmes”.⁸⁸

⁸⁷ Intervistë e zhvilluar me Prof. dr. Ibrahim Gashi, 17.08.2017

⁸⁸ Intervistë e zhvilluar me shkrimtarin Gani Mehmetaj, 16.09.2017

Pjesa e 3

3. Pjesa empirike - intervista

3.1. Sfidat e formësimit të diplomacisë së Kosovës

Që nga pavarësimi, por edhe më herët, diplomacia e shtetit të Kosovës ka funksionuar në forma të ndryshme. Në shumë segmente ajo përfaqëson një vullnet historik për ta legjitimuar shtetësinë e saj në arenën ndërkombëtare. Angazhim i përhershëm në këtë drejtim, qysh para luftës dhe pas saj i ka patur aspektet e veta specifike. Pas pavarësisë së Kosovës ajo filloi t'i marrë dimensionet e nevojshme të një diplomacie sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare.

Pikërisht edhe në këto intervista që i kemi realizuar për punimin tonë, protagonistët e diplomacisë së Kosovës shpërfaqin gjithë trajektoren e krijimit dhe ndërtimit të këtij shërbimi me rëndësi jetike për funksionimin e një shteti. Nga protagonistët e orëve të para të diplomacisë së Kosovës, por edhe nga vrojtuesit që nuk janë përfshirë drejtpërdrejt në të, mund të kuptohet dhe të strukturohet gjithë grafikoni i zhvillimit të kësaj diplomacie, duke shkuar deri në format e parme të saj në kushtet e jashtëzakonshme të okupimit, duke u përvijuar në atë gjatë dhe pas kohës së luftës në Kosovë, si dhe duke vazhduar me shfaqjet e diplomacisë tipike institucionale, e cila duket pas pavarësisë dhe pranimit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës nga ana e shumë vendeve të botës.

Siç vihet në dukje në këto intervista, diplomacia e Kosovës ndërlidhet në mënyrë të pashmangshme edhe me vetë fatin e saj, me trajektoren historiko-politike, e cila siç dihet tanimë ka kaluar nëpër shumë kohë të turbullta, që në njëfarë mënyrë diplomacinë e Kosovës e kanë bërë specifike në periudha të ndryshme dhe me veprimtari nganjëherë joformale diplomatike, të cilat janë vendosur në funksion të lidhjeve ndërkombëtare, krijimit të miqësive dhe raporteve për njohje të kauzës së shtetndërtimit.

Diplomacia e Kosovës, sipas të intervistuarve për këtë punim, mbetet e ndërlidhur ngushtë me fazat e shtetndërtimit të saj, dhe në asnjë rast nuk mund të përjashtohet nga këto dimensione. Pikërisht nga këto intervista të aktorëve që kanë marrë pjesë në krijimin dhe performimin e diplomacisë dhe misionit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, por edhe nga vështrues që në njëfarë mënyre e njohin historinë politike dhe atë të diplomacisë së Kosovës, mund të kuptohet rrugëtimi disavjeçar i saj me të gjitha sfidat që i ka patur përpara.

Këto intervista shpalosin dhe faktojnë rrugën e ecjes së shtetësisë së Kosovës dhe bashkë me këtë edhe gjithë suazën dhe kontekstin historik dhe politik të lindjes dhe zhvillimit të diplomacisë së saj.

Për punimin tonë mbeten jetike shpalimet e këtyre protagonistëve, sepse nëpërmjet rrëfimit të tyre ne arrijmë t'i njohim të gjitha momentet e ngjizjes së diplomacisë së Kosovës, të gjitha rëniet dhe ngritjet e saj, problemet, strukturimet që janë shfaqur në rrugë e sipër.

Realisht shfaqen dioptri të ndryshme të shikimit të gjithë procesit dhe reflektimit të diplomacisë së Kosovës, me tone paksa kritike për shumë situata të shtrirjes së saj në arenën ndërkombëtare, por edhe me gjithë përpjekjet e shumta për të vendosur një mision diplomatik funksional dhe në përputhje me realitetin specifik të këtij vendi si një ndër shtetet më të reja në kontinentin e vjetër.

Nga intervistat dalin qartë retrospektiva dhe vizione të tjera, të cilat ndërlidhen ngushtë me vendosjen e një sistemi të diplomacisë, sistem ky që do t'i funksionalizonte pritjet diplomatike të shtetit të ri. Dhe këto ndëlidhje depërtojnë në specifikat e shtetndërtimit të Kosovës, në momentet historike të çlirimit të saj, në periudhën e pasçlirimit kur ky vend ishte nën një patronazh të theksuar ndërkombëtar i cili reflektohej me funksionimin e UMNİK-ut brenda Kosovës.

Pavarësisht nga këto realitete, në Kosovë qysh më herët ishte krijuar ideja e diplomacisë e cila funksiononte në rrethana të ndërlikuara shoqërore e politike. Mbase jo me ato përmasa që tashmë janë standardizuar në veprimtarinë e diplomacisë, por gjithsesi me forma të mundshme dhe efektive, të cilat ishin vendosur nga politikani dhe presidenti Ibrahim Rugova.

Fillet e diplomacisë së Kosovës, edhe sipas të intervistuarve, shkojnë pikërisht te figura e Rugovës, i cili arriti të vendoste një diplomaci të urtë, efektive dhe thellësisht shtetformuese.

Edhe gjatë kohës së luftës nuk kanë munguar veprimet diplomatike, të cilat duhet kuptuar në përputhje me rrethanat e konfliktit dhe me angazhimet ndërkombëtare për çlirimin e Kosovës.

Në njëfarë mënyrë këto dy momente mund të konsiderohen si fazat e para të diplomacisë së Kosovës, të përpjekjeve për të afirmuar shtetësinë dhe luftën e drejtë të saj. Më pas vjen faza tjetër e pranisë ndërkombëtare në Kosovë dhe kufizimit të veprimeve diplomatike, të cilat gjatë tërë kohës kanë qenë të ndërvarura nga misionet ndërkombëtare. Kjo është një fazë paksa e komplikuar, për arsye se ndërthhen brenda vetes raporte specifike në administrimin e Kosovës dhe bashkë me këtë edhe në funksionimin institucional të vetë diplomacisë. Nga të intervistuarit kjo fazë është definuar si një zvarritje në konsolidimin e diplomacisë së Kosovës.

Kuptimin e mirëfilltë me të gjitha synimet dhe strukturimet e saj, diplomacia e Kosovës do ta marrë pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, atëherë kur realisht fillon edhe konstituimi institucional i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës. Thënë më saktësisht, më 15 qershor të këtij viti themelohet Ministria e Punëve të Jashtme, e cila në vazhden e punës së vet do të përballlet me shumë sfida nga më të ndryshmet, duke filluar nga gjetja e vendeve për ambasadat dhe konsullatat, vendosja e kontakteve të para, rekrutimi i personelit diplomatik dhe deri te beteja e madhe e njohjes së shtetit të Kosovës.

Pikërisht kjo fazë, edhe nga të intervistuarit përshkruhet si ndër më të rëndësishmet për konstituimin e një diplomacie të vërtetë, me të gjitha atributet që nëkuptojnë një mision të këtyllë shtetëror. Kjo fazë paraqitet si shumë e vështirë për krijimin e infrastrukturës së nevojshme diplomatike, por edhe në konceptimin e gjithë veprimtarisë që shtrihet përpara shtetit të ri tashmë të pranuar ndërkombëtarisht nga shumë vende të fuqishme.

Sipas të intervistuarve, rekrutimi i stafit diplomatik ka qenë një punë urgjente, sepse nuk ka qenë e mundur të pritet më gjatë. Në fakt nuk ka patur kohë që të maturohen diplomatët për t'u dhënë grada. Kjo fazë ka pamundësuar selektimin në bazë të kriterëve, dhe në vend të kësaj është dashur të reagohet menjëherë, të hapet konkurs për përfaqësues diplomatik, për shërbyes në këtë fushë, për diplomatë, ndërkohë që numri i njerëzve të paraqitur ka qenë i madh. Ndërsa më pas, një komision ka bërë përzgjedhjen e tyre në mënyrë shumë rigorozë, ngase protagonistët e parë janë udhëhequr nga ideja për të patur një trup diplomatik të përgatitur që do ta përfaqësonte bërthamën e parë të diplomatëve të Kosovës në botë.

Objektivisht, pa një përvojë të duhur institucionale dhe pa një traditë në kuptimin e plotë të fjalës, diplomacia e Kosovës tashmë ngadalë po i vendoste themelet e një misioni gjithpërfshirës të saj, duke kaluar nëpër një fazë vetidentifikimi dhe strukturimi institucional. Të intervistuarit për punimin tonë i vënë në pah pikërisht këto aspekte të mungesës së një përvoje, por në të njëjtën kohë edhe të një vullneti të madh për të hedhur themelet të shëndosha mbi të cilat në vitet në vijim do të lëvizte diplomacia e Kosovës, e ngarkuar me shumë misione brenda vetes, por edhe me misionin e madh të njohjeve të shtetësisë që mbetet një nga sfidat kryesore.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe shërbimi diplomatik si mjet dhe instrument kryesor i saj, ishte e qartë se do të ballfaqoheshin me sfida shumë të mëdha. Pra sfida është shprehja e saktë për këtë situatë kur merret parasysh mungesa e përvojes së kësaj diplomacie kundruall detyrave që shtroheshin para saj. Dhe, natyrisht, kjo sfidë kishte shumë dimensione.

Ajo fillonte nga vetë formimi i Ministrisë së Jashtme, vendosja e kontrureve dhe strukturës së diplomacisë, strukturimi i brendshëm i saj, miratimi i kornizës juridike si bazë themelore e veprimit, ligjet, rregulloret, udhëzimet etj. Pastaj rekrutimi i stafit të MPJ-së, trajnimet, konkurset për grupin e parë të përfaqësuesve diplomatik dhe dërgimi i tyre jashtë vendit për hapjen e dhjetë ambasadave të para.

Ky ishte koncepti bazë i vendosur për ta funksionalizuar Ministrinë e Punëve të Jashtme, dhe mbi këto principe e strukturime themelore po vendosej misioni i vështirë i diplomacisë së Kosovës.

Pa dyshim kjo mbetet faza më e vështirë, sepse kërkonte një përqëndrim të jashtëzakonshëm të energjive dhe një angazhim të fortë të të gjithë atyre që në njëfarë mënyre kishin një ide të qartë mbi punët e diplomacisë, mbi tërë atë që e përfaqësonte shërbimi i saj, me gjithë planimetrinë e shumanshme të vendosjes së marrëdhënieve për herë të parë me shumë shtete.

Faktikisht, një gjë të tillë e theksojnë edhe të intervistuarit për punimin tonë, që kjo kohë kërkonte një vetëmohim të pashoq, një përpjekje të vazhdueshme për të krijuar suazën e nevojshme konceptuale të funksionimit të diplomacisë së Kosovës, me të gjitha rrethanat që vinin nga një kohë tjetër, e cila i kishte pamundësuar vetërealizimin dhe reprezentimin institucional në rrafshin ndërkombëtar.

Pa dyshim, kjo dalje në rrafshin ndërkombëtar nëpërmjet diplomacisë kishte një numër të madh barrierash, sepse mbështetej mbi një koncept të mëparshëm të saj, që kishte funksionuar në rrethana të jashtëzakonshme. Megjithatë, pikërisht ajo përvojë e pakët, por shumë domethënëse në peridhën paraprake, sidomos e kohës së presidentit Rugova, por edhe të formave të diplomacisë gjatë luftës, kishin krijuar motivin dhe vullnetin e duhur që në ngrehinën e diplomacisë së Kosovës të vendoseshin gurët e parë, të cilët me shumë detaje i sjellin të intervistuarit.

Pikërisht në këtë rrafsh qëndrojnë edhe optikat e ndryshme të të intervistuarve, të cilët dallohen për intepretimin dhe për faktin se si i shohin këto periudha të diplomacisë së Kosovës.

Kemi dëshmi se jo gjithçka ka shkuar si duhet, ndërkohë që argumentohet edhe ideja se përveç formës së diplomacisë së promovuar nga presidenti Rugova, nuk mbetet diçka tjetër për t'u shënuar në fazën para shpalljes së pavarësisë.

Sidoqoftë, të intervistuarit dakordohen për faktin e pamohueshëm se periudha e formimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme e Kosovës, bashkë me angazhimet për të krijuar tërë infrastrukturën dhe konceptin e nevojshëm të diplomacisë, mbetet një periudhë e suksesit, përkatësisht njëra nga periudhat që i vuri themelet e diplomacisë institucionale të Kosovës.

Pa dyshim, gjithmonë sipas të intervistuarve, kjo periudhë konsiderohet si më e frytshme dhe më substanciale për diplomacinë e Kosovës, për shkak se gjatë kësaj realisht fillon edhe procesi i njohjes së shtetësisë së Kosovës si një proces i rëndësishëm me shumë sfida përpara. Kjo realisht është edhe periudha e një bashkëpunimi të ngjeshur me shtetet dhe diplomacitë më të fuqishme në botë, që e hapi rrugën e njohjes dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me shumë vende anembanë globit. Gjithsesi ky proces kërkonte shumë energji e përkushtim, sepse pengesat në këtë rrugë ishin të natyrave të ndryshme.

Gjatë kësaj kohe, një sinergji diplomatike do të vendosej edhe me shërbimin diplomatik shqiptar, i cili pa ngurrim do të vihej në funksion të diplomacisë së re të Kosovës. Kjo do të thotë se përvoja me ambasadorët e Shqipërisë ishte e shkëlqyer. Sipas mendimit të të intervistuarve, që në ditët e para ambasadat e Shqipërisë i kanë mbështetur në të gjitha drejtimet, për çka përfaqësuesit e Kosovës janë shumë mirënjohës.

Por ka edhe një konstatim tjetër i cili realisht e pasqyron forcën e diplomacisë shqiptare me gjithë sfondin e saj historik. Nga ana e protagonistëve dhe vlerësuesve theksohet fakti se diplomacia shqiptare ka ndihmuar shumë, sidomos në fazën fillestare shpesh i ka hapur rrugët e veprimit të mëtejshëm. Mirëpo duhet theksuar se edhe kjo diplomaci vuan nga sindroma e shtetit shqiptar, pra i ka kufizimet e veta, ngurtësinë, paaftësinë dhe shtrëngesat e shtetit për shkak të turbulencave të brendshme. Megjithatë, raportet dëshmojnë qartë se diplomacia shqiptare, e cila kishte një përvojë shumë më të madhe, e ka dhënë kontributin e saj të çmuar.

Vlerësimi i diplomacisë së Kosovës, sipas të intervistuarve, duhet të shihet pikërisht në dritën e këtyre rrethanave specifike, të shtetndërtimit, të mungesës së një përvoje paraprake, të mungesës së një misioni të konsoliduar me gjithë infrastrukturën e nevojshme. Mbetet konstatim i përgjithshëm se kjo periudhë nëntëvjeçare e diplomacisë së Kosovës është një histori e suksesit, me gjithë dobësitë dhe të metat që mund të jenë shfaqur brenda kësaj kohe. Po ashtu, të intervistuarit konstatojnë faktin se diplomacia e Kosovës gjatë kësaj kohe mund të konsiderohet si më e suksesshme në rajon në aspektin e vëllimit të punëve që ka bërë dhe në atë të konsolidimit profesional që kishte ndodhur.

Sipas protagonistëve të parë Kosova ka bërë përparime të jashtëzakonshme. Ajo ka një shërbim diplomatik me të cilin mund të mburret dhe ndoshta e ka më të mirë se të gjitha vendet e rajonit, më profesional, më efikas. Mbase arsya është se ka patur mundësi të mos i bëjë gabimet që i kanë bërë të tjerët, domethënë ka nxjerrë mësim nga gabimet e të tjerëve dhe ka ndërtuar një shërbim diplomatik solid dhe funksional.

Por, sidoqoftë, mbizotëron edhe mendimi se me kalimin e kohës është humbur ai zelli fillestar, ai motivim i jashtëzakonshëm që kishte mundësuar njohjet e shumta të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në këtë drejtim bëhen edhe vërejtjet e para që shkojnë në adresë të diplomacisë së mëvonshme, sidomos me ndryshimet e mëdha në arenën ndërkombëtare dhe me ndryshimin e kontekstit që nënkupton edhe ndryshimin e qasjes diplomatike.

Në këtë aspekt konstatohet fakti se ka një ndërrim gjeneratash, për Kosovën thuhet se 90 për qind të këtyre përfaqësuesve nuk e kanë ndjesinë e diplomatëve që ishin në vitet '90, '92, '93 në zyrat e vendeve përkatëse, dhe kjo tash duhet të krijojë një kujdes dhe vetëdije për një kontekst tërësisht të ndryshëm nga ai kur pat lindur shteti i Kosovës.

Por bashkë me këto paralajmërime që ofrohen nga diplomatët e parë, përgjithësisht vlerësimet janë pozitive për sa i përket kuadrit të krijuar gjatë këtyre viteve.

Është konstatim i përgjithshëm se gjithmonë ka vend për të dëshiruar më shumë dhe ndonjëherë ka ngathtësi aty - këtu në punën e diplomatëve të Kosovës, por në përgjithësi vendi ka një shërbim dinamik diplomatik dhe konsullor që po e kryen punën e vet.

Pa dyshim, vlerësimet për këtë periudhë të diplomacisë janë tepër të kujdesshme dhe anashkalojnë dobësitë e vogla që janë shfaqur në raport me misionin e madh që kishte para vetes diplomacia e Kosovës. Të intervistuarit për punimin tonë konstatojnë një trajektore konstante dhe tepër energjike të diplomacisë, ndërkohë që nuk harrojnë të theksojnë edhe kontekstin e ri të krijuar, i cili kërkon më shumë energji dhe kreativitet diplomatik.

Gjithsesi profesionin e diplomacisë ata e ndërlidhin edhe me zhvillimet politike në vend, të cilat në njëfarë forme edhe e determinojnë diplomacinë e Kosovës. Njëri nga konstatimet është se duke i marrë parasysh sfidat dhe faktin se diplomacia e Kosovës është ndeshur që në hapat e parë të saj me disa sfida me të cilat nuk janë ndeshur shumica e vendeve të tjera të reja, domethënë ka ecur përpara me kujdes e vëmendje të veçantë.

Ka shumë veprime diplomatike për të cilat shpresohet se do të bëhen në të ardhmen, sidomos në mbulimin e hapësirës gjeografike të përfaqësimit. E për për këtë çështje vendos politika dhe jo diplomacia e Kosovës.

Në këtë drejtim ata kërkojnë më shumë aktivizëm diplomatik të të emëruarve politik në Prishtinë. Dhe nuk kanë shumë ankesa për sa i përket shërbimit diplomatik që është një shërbim profesional dhe jo politik. Por në mesin e të emëruarve politik, te ministrat, zëvendësministrat, këshilltarët, do të duhej të kishte më shumë aktivizëm, qasje më agresive në kuptimi pozitiv, sidomos për të fituar më shumë njohje të reja, sepse Kosova ka nevojë për to.

Disa nga dobësitë e shfaqura shihen te mospuna e të emëruarve politik në MPJ, pra duhet të jenë më energjik dhe më këmbëngulës në kërkimin e njohjeve, thjesht nevojitet që të angazhohen më shumë. Sidoqoftë, edhe pse ka vend për pakënaqësi, është konstatim i përgjithshëm se Kosova ka bërë progres të jashtëzakonshëm në të gjitha fushat.

Në momentin aktual, diplomacia e Kosovës mund të vlerësohet se është një diplomaci e veprimit të konsoliduar, me përvoja solide dhe rezultate të konsiderueshme. Tashmë dihen të dhënat për numrin e njohjeve, organizatava ku Kosova është anëtare, përfshirë këtu edhe Bankën Botërore, FMN etj., si dhe shumë organizata të tjera rajonale. Duke iu përmbajtur temës qendrore lidhur me portretizimin e diplomacisë së Kosovës në momentin e pikërisht, nga të intervistuarit vlerësohet se kjo është periudhë specifike për faktin se është një diplomaci në zhvillim, në veprim e sipër, për përmbushjen e misionit të saj dhe detyrave të cilat, edhe në këtë fazë, kanë përmasat e sfidave.

Çështja e riformatimit të diplomacisë së Kosovës nuk shihet si një temë tabu, përkundrazi, nga të intervistuarit shihet si një proces që duhet të ndodhë në vazhdimësi. Sipas konstatimit të tyre, një shërbim i jashtëm diplomatik duhet të jetë në rikonstruim të përhershëm për t'iu përshtatur rrethanave të reja.

Duhet përshtatur edhe shërbimi diplomatik i rrethanave të reja të përgjithshme jo vetëm tekniko-teknologjike, por edhe politike, ekonomike dhe rikonstruimeve të ndryshme në botë.

Në përgjithësi vlerësimet mbi këtë fazë shkojnë drejt konstatimeve se diplomacia e Kosovës ka funksionuar në përputhje me realitetin e brendshëm politik të Kosovës, por në vijat e përgjithshme ajo është ngritur në një nivel veprimtarie profesionale që ka ditur ku t'i vendosë koordinatat e funksionimit të vet. Shpallja e pavarësisë ka determinuar procesin e njohjeve, dhe kjo ka kërkuar një bashkëpunim shumë të madh me aleatët e medhën, të cilët shihen si bashkëveprues vendimtarë në suksesin e diplomacisë në gjithë atë proces të vështirë të njohjeve në arenën ndërkombëtare.

Së këndejmi, ndërveprimi i politikës së brendshme në Kosovë shihet si një faktor tepër i rëndësishëm në rrugën e afirmimit diplomatik të shtetit, të anëtarësimit në shumë organizma ndërkombëtarë që përfaqësojnë legalitetin dhe legjitimitetin e shtetit të Kosovës. Për këtë arsye reflektimet diplomatike shihen edhe në kuadër të funksionimit normal të institucioneve të tjera të vendit, të cilat krijojnë hapësirën e nevojshme për diplomaci shumë më efektive.

Por, të intervistuarit, përveç që e vlerësojnë lart fazën e parë të diplomacisë së Kosovës, nga përvoja dhe krahasimet e shumta hapin edhe një horizont të ri drejt të cilit duhet të rrugëtojë ajo. Dhe ky horizont ndërlidhet pikërisht me gjithë planimetrinë e organizatave ndërkombëtare, në të cilat duhet të njihet dhe të anëtarësohet Kosova si shtet i pavarur. Integrimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare është një sfidë jo e lehtë për politikën e jashtme të saj, për faktin se disa prej tyre kanë mekanizma të tillë pengues në procesin e pranimit (p.sh. e drejta e vetos në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara).

Rreshtimi i Kosovës pa ekuivoke drejt perëndimit ka si rezultat qëndrimin rigjid të Rosisë. Politika e jashtme e Kosovës përpiqet të notojë në kuadrin e kësaj sfere të krijuar pa dashjen e saj. Sfida e tretë e rëndësishme është integrimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Plotësimi i parakushteve për këtë nga politika është një domosdoshmëri e kohës, theksohet në mes të tjerash nga të intervistuarit tanë.

Njohja e një shteti është akt i pavarur i tij me të cilin e njeh shtetin tjetër. Pikërisht në këtë funksion shihet edhe procesi i njohjeve të tjera që duhet të ndodhin dhe që në esencë kërkojnë një angazhim të gjithanshëm. Diplomatët e Kosovës mund të kontaktojnë, të informojnë, të llobojnë, por vendimin e merr shteti përkatës.

Sipas të intervistuarve, janë një numër arsyesh për mosarritjen e një shkalle më të madhe të njohjes: fakti se dy nga vendet anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit (Rusia dhe Kina) nuk e kanë njohur Kosovën, lobimi i fortë rus kundër njohjes, manipulimi që bën Serbia te disa vende të Afrikës dhe Azisë me Lëvizjen e Mosinkuadrimt, manipulimi i saj me disa vende të Amerikës Latine përmes religjionit, rezervat që i kanë disa vende islamike për lidhjen e ngushtë politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore me perëndimin që ka Kosova.

Në këtë pikëpamje mbetet imperativ që të ndryshojë edhe qasja e përzgjedhjes dhe të kuptuarit e diplomacisë. Dhe pikërisht kjo qasje nënkupton edhe aftësi të tjera diplomatike të cilat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, sidomos të vendeve perëndimore që kanë një traditë më të gjatë në këtë drejtim. Për t'i sintetizuar këto pritje të diplomacisë në një formulim më gjithpërfshirës, mund të vijmë në përfundim se në Ministrinë e Jashtme duhet të ndryshojë mëndësia e rekrutimit të kuadrove, përkatësisht e diplomatëve. Thjesht duhet të ketë më pak interferenca politike. E para e punës ata duhet të jenë të arsimuar, të kultivuar, me njohuri të thella nga marrëdhëniet ndërkombëtare, të jenë diplomatë të karrierës që e duan dhe e njohin punën. Po ashtu, ata duhet të jenë njerëz me finesa diplomatike, të nuancuar dhe të shkathët, përveç faktit kryesor që duhet t'i njohin disa gjuhë të huaja, krahas asaj që duhet të dinë gjithçka për shtetin ku shkojnë, si dhe për rrjedhat ndërkombëtare në përgjithësi.

Ky konstatim hap horizontin e një profesionalizmi të skajshëm, njohjeve të thella të rrjedhave ndërkombëtare dhe gjithë kontekstit ndërkombëtar që i ka angazhimet e veta edhe në diplomacinë e Kosovës. Ky horizont përcakton në njëfarë mënyrë edhe një qasje dhe dinamikë krejtësisht të re, por edhe një kualitet të ri përzgjedhesh profesionale për të patur mundësi t'u përgjigjen sfidave që i ofron procesi i komplikuar i njohjeve dhe gjithë afirmimi tjetër i shtetformimit të Kosovës.

Përpara diplomacisë së saj tashmë ndodhen sfidat e radhës, por pa i përjashtuar edhe ato të deritanishmet që kanë të bëjnë me njohjet. Natyrisht, është konstatim i përgjithshëm se kompletimi i procesit të njohjes është prioritet absolut i MPJ-së dhe i diplomacisë së Kosovës. Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare mbetet objektiv madhor për diplomacinë dhe shtetin e Kosovës, para së gjithash OKB-ja. Pra, anëtarësimi në organizatat rajonale e globale, integrimet evropiane, konsolidimi i mëtejshëm i pozitës së Kosovës në skenën ndërkombëtare.

Siç mund të shihet, shfaqen detyra të shumta e serioze për diplomacinë e Kosovës në procesin e njohjeve të reja, avancimin pozitiv të imazhit të shtetit të Kosovës, ruajtjen e miqësive të vjetra dhe sigurimin e miqësive të reja, për t'i mposhtur paragjykimet e krijuara nga propaganda e ligë antikosovare ose nga mungesa e informacioneve të plota lidhur me Kosovën dhe popullin e saj, të tashmen dhe të kaluarën e saj. Disa nga këto prioritete konsiderohen si imediate, ndërsa disa të tjera që kanë të bëjnë me promovimin e vlerave dhe interesave vitale të shtetit të Kosovës, janë të natyrës së përhershme dhe do të jenë gjithmonë detyrë e diplomacisë së Kosovës, përkatësisht pikë rereference dhe kriter i matjes së rezultateve të saj.

Gjithë ky kuadër shihet si një angazhim permanent që duhet ta ruajë vazhdimësinë, por njëherazi edhe që duhet të promovojë një shtytje më të madhe për t'iu përgjigjur rrethanave të reja dhe të gjitha specifikave që ndëlidhen me dy objektiva madhore, siç është procesi i njohjes dhe ai i afirmimit të vlerave demokratike të shtetit të Kosovës në gjithë planimetrinë e vet politike dhe konstitucionale.

Për t'i arritur këto objektiva, sipas të intervistuarve, nevojitet një diplomaci cilësore e cila do të jetë në përputhje me synimin për ta futur diplomacinë e Kosovës në një paradigme të re shumë më profesionale dhe efikase.

Nuk mund të imagjinohet një diplomaci cilësore dhe efikase nëse bartësit e saj nuk janë njerëz të duhur për këtë punë. Parimisht kudo vlen rregulli i njohur: Njeriu i duhur në vendin e duhur, është çelësi i suksesit edhe në këtë fushë.

Mund të themi se Kosova ka diplomatë shumë të mirë, por në shpejtësinë me të cilën është dashur të bëhen misionet diplomatike e konsullore, sigurisht që janë bërë edhe gabime.

Me rëndësi është që proceset të vazhdojnë. Dhe kjo nënkupton korrigjimin dhe krijimin e klimës ku nuk do të ndihen mirë ata që nuk janë të përgatitur për t'u ballafaquar me këtë profesion. Kosova meriton të përfaqësohet vetëm nga diplomatë seriozë, të përkushtuar, të devotshëm dhe të përgatitur me të gjitha cilësitë që duhet të ketë një diplomat i mirë. Për të intervistuarit kjo mbetet një çështje jetike. Sipas tyre, diplomacia është e rëndësishme dhe vitale për çdo shtet, qoftë ai i madh apo i vogël.

Por sidomos për shtetet e vogla, ajo është me rëndësi të veçantë, sepse krijon mundësi për amplifikimin e zërit të tyre, shton shanset që përmes bashkëpunimit të maksimalizojë ato për të qenë pjesë e rëndësishme e strukturës dhe familjes ndërkombëtare.

Optikat e vlerësuesve të rrugëtimit diplomatik të Kosovës janë të dallueshme në disa raste të veçanta. Eksistojnë edhe konstatime të atilla që vënë në dukje edhe rezultatet e munguara, përkatësisht që synojnë caqe më të largëta dhe më substanciale. Sipas këtyre konstatimeve, diplomacia e Kosovës është dashur të jetë më energjike, më e konsoliduar dhe më pragmatike në misionin e saj.

Së këndejmi dalin edhe sfidat aktuale të diplomacisë së Kosovës, të cilat përsëri ndalen te njohjet, te normalizimi i raporteve sidomos e Serbinë, ruajtja e marrëdhënieve me partnerët strategjik, anëtarësimi në organizmat ndërkombëtarë, si dhe krijimi i një koherence të përhershme kualitative në afirmimin e shtetformimit të Kosovës. Sipas këtij konstatimi, diplomacia publike nuk mund të jetë edhe më tej e qendëruar kryesisht te shteti, por duhet të përhapet dhe të ndahet me një mjedis gjithnjë e më fluid global dhe në kontekste të reja. Në këtë pikëpamje lind nevoja për më shumë lidhje e kontakte të diplomacisë publike dhe ekonomike me disiplina akademike, për një komunikim tjetër edhe me historinë. Në thelbin e saj diplomacia konsiderohet një aktivitet politik i menduar mirë.

Këto konstatime hapin edhe një dimension tjetër tepër të rëndësishëm të diplomacisë që ndërlidhet me idenë ekonomike, me gjithë kuadrin e gjerë të këtyre zhvillimeve, që mund të jenë një faktor plus në afirmimin e shtetit të Kosovës, por edhe një faktor njohjesh të reja që si bazament e kanë ekonominë.

Nga të intervistuarit tanë theksohet pikërisht edhe ky dimension si jetik, por akoma problematik në strukturimin dhe perceptimin në raportet me shtetet e tjera.

Me këtë çështje drejtpërdrejt ndërlidhet edhe ekzistenca e departamentit të diplomacisë ekonomike, e që është një subjekt institucional i cili ka për detyrë të promovojë strategji të mirëmenduara për thithjen e investimeve të huaja, por përgjithësisht edhe për vendosjen e raporteve ndërshtetërore duke patur në epiqendër ekonominë si faktor të rëndësishëm.

Është pothuajse i përbashkët konstatimi se një departament i këtillë është me shumë rëndësi, sepse është një bërthamë e cila duhet t'i bindë investuesit seriozë. Diplomacia ekonomike po bëhet gjithnjë me e rëndësishme, si një tregues i mirëfilltë i nivelit të performancës së diplomacisë në përgjithësi. Organizimi struktural nëpër vende të ndryshme bëhet në mënyra të ndryshme, me specifika etj. Diku është si departament i veçantë, diku ka emërtim tjetër, por kudo ka një qëllim, e që është forcimi i fokusit në çështjet ekonomike.

Madje diku është normë e misionëve dhe ambasadave gjatë punës së tyre nga të cilat kërkohen kuota të caktuara të investimeve, eksporteve etj. Sidoqoftë është në kuadër të asaj që është promovim i potencialeve ekonomike, instrument, mekanizëm dhe parakusht për zhvillim ekonomik.

Ekonomia po bëhet si tregues i vlerësimit të një ambasade nëse është e suksesëshme ose jo. Në MPJ-në e Kosovës kjo është si departmanet i veçantë me këtë emër. Pra departament i përkushtuar për çështjet ekonomike dhe funksionimi i tij ka një rëndësi shumë të madhe. Pra është me rëndësi, për arsye se fokusohet në çështjet ekonomike, koordinon aktivitetet me ambasadat dhe ministrinë përkatëse me qëllim të intensifikimit të punës në këtë sektor.

Përgjithësisht vlerësohet se ky departament nuk qëndron keq në këtë drejtim, sepse ka organaizuar shpesh forume ekonomike, konferenca me karakter ekonomik, vizita biznesmenësh, për t'u shpjeguar potencialet dhe specifikat sistemore, gjithnjë me shpresë se do të bëhet edhe rritja adekuate ekonomike e vendit.

Edhe nga të intervistuarit ky institucion dhe misioni i tij shihet si një mundësi shumë e madhe për zhvillimin ekonomik, por edhe për krijimin e lidhjeve të reja mbi bazë të këtyre lidhjeve.

Nuk ka dilemë se diplomacia ekonomike është shumë me rëndësi, çështja është se si mund jetë sa më funksionale dhe sa më efikase. Shprehur në një mënyrë pak më simplistike, është me rëndësi të ketë ekonomi, prodhime e pastaj të shihet se si mund të eksportohen ato, për çka diplomacia mund të ketë ndikim dhe rol të rëndësishëm. Pastaj, sa ka bashkëveprim e mirëkuptim me institucionet e tjera qeveritare e joqeveritare të cilat janë aktive në planin ekonomik. Ministria e Jashtme, përkatësisht departmentet e ngarkuara për këtë sektor mund të bëjnë punë shumë të mirë.

Sa i përket kësaj çështjeje, theksohet fakti se ekonomia gjithmonë ka qenë pjesë shumë e rëndësishme e secilës diplomaci, por ky emërtim specifik saj ka ardhur si nevojë për më shumë vëmendje në çështjet ekonomike.

Të intervistuarit për punimin tonë, në kuadër të gjithë asaj që nënkupton diplomacia, kanë veçuar edhe mungesën e një tradite të saj, përgjithësisht në historinë politike të shqiptarëve.

Edhe përkundër ekzistencës së shtetit shqiptar, dihet fare mirë se diplomacia një kohë të gjatë ka qenë e cunguar, e kufizuar në aspektin e funksionimit të saj për asrye ideologjike. Si pasojë e kësaj ka ekzistuar një vakum disavjeçar i komunikimeve diplomatike në krahasim me atë që e kanë patur shtetet e tjera normale.

Vetëm me ardhjen e demokracisë sërish diplomacia e ka fituar prestigjin dhe vendin e duhur, por edhe gjatë kësaj kohe konstatohet se nuk ka patur ndonjë diplomaci strategjike, e cila do të kishte mundësi të krijonte një ambient shumë më të përshtatshëm për pritjet historike të Shqipërisë dhe më pas edhe të shtetit të Kosovës.

Megjithatë, pavarësisht nga këto dobësi, diplomacia e Shqipërisë kurdoherë i ka dalë në ndihmë diplomacisë së re të Kosovës me ato mundësi që i ka patur në dispozicion, të cilat edhe theksohen nga protagonistët e diplomacisë së asaj kohe.

Në kuadër të kësaj tradite, të intervistuarit vlerësojnë edhe fazat e para të diplomacisë së shqiptarëve që ndërlidhen me figurën e Faik Konicës dhe Fan Nolit, të cilat në njëfarë mënyre e kanë afirmuar në atë kohë shtetin shqiptar në arenën ndërkombëtare, kuptohet në format dhe strategjitë tipike për atë kohë.

Kjo na bën të kuptojmë faktin se diplomacia në përgjithësi të shqiptarët ka një traditë mbi të cilën është ngritur edhe funksionimi i saj në kohët në vazhdim.

Për të intervistuarit tanë, skandalet e ndryshme janë krejtësisht të papranueshme për diplomacinë, dhe si të tilla në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë pjesë e saj, për shkak se ndikojnë drepërdrejt në imazhin e shtetit që e përfaqësojnë, përkatësisht në këtë rast të Kosovës. Sipas tyre diplomacia kërkon njerëz që janë të sprovuar, me dinjitet, të përgatitur profesionalisht, që dinë të komunikojnë dhe që çdo gjë e vënë në të mirë dhe në funksion të imazhit të vendit që përfaqësojnë.

Gjerësisht kjo është pamja e zhvillimit të diplomacisë së shtetit të Kosovës që ndërlidhet me shumë sfida dhe me shumë konstatime të vlefshme nga ana e të intervistuarve për punimin tonë. Trajektorja e vlerësimit të kësaj diplomacie shkon deri në format e para të një lloj diplomacie, e cila ishte vënë në funksion të afirmimit të pavarësisë së Kosovës dhe që mishërohet me figurën e presidentit Ibrahim Rugova, pastaj diplomacia e kohës së luftës, e pasçlirimit dhe deri te faza institucionale e saj, e cila tashmë kërkonte angazhime të tjera, si dhe një profesionalizëm shumë më të madh.

Pa dyshim që secila fazë i ka patur specifikat e veta që mbeten të ndërlidhura me rrethanat e dhëna të kohës që përfaqëson. Mbretëron mendimi i përgjithshëm se secila fazë pasqyron edhe vetë rrugëtimin historik të Kosovës me gjithë kontekstin e marrëdhënieve të cilat shpeshherë kanë qenë komplekse.

Fillet e diplomacisë institucionale të periudhës pas pavarësisë përshkruhen si tepër të vështira, me shumë sfida përpara, por njëkohësisht edhe me angazhime të ndryshme, të cilat ishin thellësisht në funksion të synimit për ndërkombtarizim të shtetësisë së Kosovës.

Sigurisht, në të gjitha këto vlerësime që dalin nga intervistat në fjalë, mund të shihen edhe optika të ndryshme, të cilat vënë në spikamë si suksesin, ashtu edhe dobësitë e shfaqura në rrugë e sipër.

Përgjithësisht pranohet fakti se diplomacia e Kosovës, misionet e saj kanë filluar pothuajse nga pika zero, pa asnjë përvojë parapake dhe pa asnjë shtrirje në arenën e gjerë ndërkombëtare.

Këtij vlerësimi i bashkangjitet edhe motivacioni, ambicia e jashtëzakonshme e protagonistëve të parë të diplomacisë së Kosovës për t'u futur në kuadrin e komplikuar të saj si një veprimtari që kërkon edhe kushte specifike për vendosje dhe lidhje me shtetet ku është shtrirë arti i diplomacisë.

Është konstatim i përgjithshëm se pavarësisht nga pengesat, nga mungesa e përvojës, nga mungesa e një tradite, orët e para të diplomacisë kanë qenë shumë ambicioze dhe në funksion të afirmimit të shtetësisë së Kosovës.

Pikërisht në këtë pikë vlerësohet edhe puna e jashtëzakonshme e njohjes nga shtetet e pavarësisë që ishte organikisht e lidhur me misionin diplomatik të fillimeve. Për një kohë të shkurtër diplomacia e Kosovës ka arritur të vendosë suazën e nevojshme të misionit të vet, që ishte gjithnjë në përputhje me zhvillimet brenda vendit dhe sidomos me praninë ndërkombëtare, hapave të ndërmarrë për të krjuar imazhin e duhur dhe për të shpjeguar të gjitha specifikat e një shteti që tashmë e kishte shpallur pavarësinë.

Gjithashtu, nga të intervistuarit mund të kuptohet edhe gjithë evoluta e diplomacisë së Kosovës, që shënon një periudhë të rëndësishme në planin ndërkombëtar, si një angazhim permanent për ta çuar përpara procesin e njohjeve, por edhe atë të anëtarësimeve të Kosovës në organizmat ndërkombëtarë, që gjithnjë shfaqet si një proces i komplikuar i cili kërkon shumë energji shpjeguese dhe shumë

angazhime përballë konstelacioneve ndërkombëtare të cilat jo gjithmonë kanë qenë në favor të Kosovës.

Pavarësisht nga sukseset e arritura, po ashtu të intervistuarit theksojnë nevojën e një konsolidimi permanent, në mënyrë që diplomacisë t'i jepet gjithë fuqia e nevojshme për t'i çuar përpara synimet e shtetit të Kosovës. Ata janë të bindur se ky proces duhet të jetë permanent dhe të përcillet me përzgjedhje kualitative të diplomatëve, si dhe gjithë trupit tjetër diplomatik.

Në kuadër të këtij konsolidimi si çështje imediate paraqitet orientimi drejt një diplomacie energjike, më pragmatike dhe gjithnjë në funksion të njohjeve të reja që duhet të ndodhin, por edhe në funksion të anëtarësimit në organizmat ndërkombëtarë, në mënyrë që Kosova të fitojë legjitimitetin e plotë ndërkombëtar si shtet.

Përgjithësisht këto mbeten sfidat kryesore të identifikuara për diplomacinë e Kosovës, ndërkohë që theksohet edhe nevoja e një diplomacie ekonomike si formë e re e afirmimit, bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik për Kosovën. Së këndejmi diplomacia dhe kuadri i saj në të ardhmen mbetet i determinuar nga kjo trajektore nëntëvjeçare, por edhe nga shumë zhvillime të brendshme institucionale të cilat e përcaktojnë drejtpërdrejt kualitetin dhe efektivitetin e saj.

Në këtë sens edhe pse diplomacia e Kosovës mund të konsiderohet si një histori suksesi, të gjitha pengesat dhe dobësitë e shfaqura mund të shërbejnë për një strukturim dhe konsolidim tjetër, me çka do ta forconte akoma më tepër rolin e diplomacisë kundruall sfidave të shumta me të cilat përballlet shteti i Kosovës, sidomos në procesin e njohjes. Në këtë drejtim theksohet nevoja e formave të tjera të ushtrimit të diplomacisë, të cilat do të ishin më plurale dhe do të përputheshin me synimet e përbashkëta për secilin shtet me të cilin pretendohet të krijohen lidhje të parteritetit.

3.2. Diplomacia dhe politika e jashtme e Kosovës pas pavarësisë

Analiza e politikës së jashtme të Kosovës pas pavarësisë, përcaktohet edhe nga dy fazat paraprake të zhvillimeve brenda saj. Kjo është faza para luftës, kur Kosova kishte një diplomaci në rrethanat e shtetit që kishte shpallur pavarësinë, por që realisht akoma nuk ishte njohur nga bashkësia ndërkombëtare, dhe periudhën e pasluftës, përkatësisht qeverisjen gati nëntëvjeçare të misionit të OKB-së në Kosovë, UNMIK-ut, që paraqet tërësisht një fazë specifike, sepse gjithë komunikimet me jashtë bëheshin nëpërmjet këtij misioni.

Ky fakt presupozon që politika e jashtme e Kosovës merr kuptimin e mirëfilltë vetëm pas shpalljes së pavarësisë, përkatësisht pas bisedimeve dhe pranimi të “Pakos së Ahtisarit” e cila nënkuptonte një pavarësi të mbikëqyrtur.

Pas negociatave mbi njëvjeçare në mes Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare, ku Kosova ishte e përfaqësuar nga “Ekipi i Unitetit”, ndërmjetësuesi i OKB-së në bisedime, Marti Ahtisari hartoi Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, që ndryshe njihet edhe si “Pakoja e Ahtisarit”. Sipas këtij propozimi Kosova fitonte pavarësinë e mbikëqyrtur, me kompetenca të plota në politikën e brendshme dhe të jashtme të saj. Në mes të tjerash, në këtë propozim të tij thuhej se “Kosova do të gëzojë të drejtën e negociimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe të drejtën për të kërkuar anëtarësim në organizatat ndërkombëtare”

Ky është momenti kryesor, kur bashkë me procesin e shtetbërjes së mëvetësishme, realisht fillon edhe performimi i politikës së jashtme të Kosovës. Pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt të vitit 2008, Kosova zotohet se do ta zbatojë në tërësi “Pakon e Ahtisarit” dhe si shtet i pavarur do të përfshihet në marrëdhëniet ndërkombëtare, do të nënshkruajë marrëveshje të këtilla etj. Me një fjalë, në bazë të përcaktimeve kushtetuese, nga ky moment Kosova merr përsipër që ta dimensionojë vetë politikën e jashtme dhe gjithë procesin me të cilin nënkupton diplomacinë për një shtet.

Realisht, nga ky moment fillon rrugëtimi i shtetësisë së Kosovës dhe, bashkë me këtë, edhe i diplomacisë që tanimë ishte përcaktuar edhe me ligjet që buronin nga kushtetuta e shtetit të pavarur.

Tashmë Kosova po linte pas vetes një fazë ndërvarësie nga misioni i OKB-së, i cili deri në këtë moment kishte legjitimitetin e plotë të reprezentimit të saj në arenën ndërkombëtare. Nga ky çast Kosova duhej të krijonte politikë të jashtme autonome dhe të bazuar tërësisht në resurset e veta shtetërore. Kjo paraqiste një horizont të ri për politikën e jashtme të saj dhe për të gjitha ato marrëdhënie ndërkombëtare që e nënkuptonin diplomacinë si një veprimtari publike institucionale.

Janë këto rrethana krejtësisht të reja, të cilat kërkonin edhe një qasje tjetër, një vizion mbi gjithë planimetrinë e angazhimeve ndërkombëtare që Kosova duhej t'i merrte tashmë mbi supet e veta. Dhe kjo fazë paraqitet me shumë sfida përpara, një tokë e panjohur më parë në arenën ndërkombëtare e cila duhej të strukturohej në planin strategjik të veprimeve dhe ndërveprimeve diplomatike, për të qenë në koherencë të plotë me një realitet të ri, pra me realitetin e pavarësisë së Kosovës. Nga të gjithë njohësit e kësaj faze dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare theksohet se kjo fazë paraqet njërën nga më të rëndësishmet, për arsye se krijonte për vete suazën e madhe ndërkombëtare të shtetësisë së Kosovës.

Pikërisht në këtë kohë po performohej një vizion tjetër për zhvillimin e Kosovës dhe një strategji e cila synonte me shumë energji dhe përkushtim të vendoste themelet e një politike të jashtme moderne të këtij shteti. Sfidat ishin të shumta dhe njohësit e këtyre rrethanave vënë në dukje se kjo është një nga fazat më të vështira të politikës dhe diplomacisë së Kosovës, por edhe më e suksesshmja, qoftë për nga vëllimi i punëve të bëra, shtrirjes gjeografike, vendosjeve, por edhe krijimit të lidhjeve të para nga një staf diplomatik që nisej për në shtetet e tjera me nga një laptop dhe kushte minimale për të ushtruar profesionin e vështirë të diplomatit.

Me dhjetëra rrëfime, analiza, reflektime nga diplomatë dhe analistë të tjerë, lidhur me këtë periudhë vënë në dukje pikërisht situatën e vështirë, por edhe tepër të frymëzuar për të qenë pjesë e arenës ndërkombëtare me gjithë subjektivitetin e një shteti të pavarur siç ishte tashmë Kosova.

Siç është theksuar deri tani, diplomacia e Kosovës duhej të ndërtohej nga hiçi, nga një pikë zero në aspektin institucional, për t'iu përgjigjur sfidave të shumta që po shfaqeshin përpara ndërtimit të një shteti.

Në këtë kontekst politika e jashtme e Kosovës dhe diplomacia, siç theksohet nga njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare, duhej të vendoste një model të ri funksionimi të institucionalizuar dhe të standardizuar.

Në këtë pikë fillojnë menjëherë rekrutimet e para të stafit të diplomatëve, të cilët po merrnin përsipër misionin e madh të politikës së jashtme të Kosovës në gjithë atë hapësirë ndërkombëtare, që paraprakisht, siç theksohet nga shumë vëzhgues të rrjedhave të politikës së jashtme, ishte përpunuar nga Serbia si një strategji për të parandaluar shtetformimin dhe njohjen ndërkombëtare të Kosovës.

Kjo ishte një sfidë që kërkonte dije, shkathtësi profesionale, koordinime dhe komunikime të pafundme për të krijuar një suazë tjetër reflektimesh mbi subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës si një realitet i ri që përcaktonte politika të drejta, lidhje korrekte dhe imazh pozitiv për Kosovën.

Gjithë këto realitete të reja përfaqësonin sfidën e jashtëzakonshme të një politike të jashtme pa ekperiencën e duhur dhe pa resurset e nevojshme që krijojnë komoditetin e diplomacisë dhe të politikës së jashtme. Sidoqoftë, kjo fazë e parë e politikës së jashtme do të rezultojë e suksesshme, sidomos në krijimin e suazës së përgjithshme prej nga më pastaj do të lëvizte diplomacia dhe prej nga do të performohej gjithë angazhimi i deritanishëm i politikës së jashtme të Kosovës.

Procesi i njohjes së shtetit të Kosovës mbetet në epiqendër të filozofisë dhe konceptit të politikës së jashtme. Ky ishte një proces imediat që nënkuptonte rrumbullaksim të një rrugëtimi historiko-politik të Kosovës dhe që tashmë po merrte gjithë vëmendjen e duhur me njohjet e para, për të cilat një meritë të jashtëzakonshme e kanë diplomatët e parë që u përfshinë në misionin e madh për t'ia dhënë shtetit legjitimitetin e plotë ndërkombëtar nëpërmjet njohjeve.

Kjo fazë përshkruhet edhe me një bashkëpunim të ngushtë të diplomacisë së Kosovës me aleatët strategjik siç janë SHBA-ja dhe vendet evropiane të cilat në njëfarë mënyre ishin pjesë e gjithë këtij procesi të shtetformimit dhe etablimit në arenën ndërkombëtare.

Nga vetë diplomatët është theksuar disa herë ky bashkëpunim i ngushtë dhe i frytshëm, pa të cilin gati do të ishte e pamundur të krijohet gjithë ai momentum njohjesh, sidomos nga vendet e botës perëndimore.

Më vonë, diplomacia e Kosovës, duke i konsoliduar koordinatat e veprimit të vet, do të arrijë që procesin e njohjeve ta çojë përpara edhe në vende të tjera të globit. Pa dyshim se ky ishte një proces gjithëpërfshirës dhe i suksesshëm në këtë fazë, ndërkohë që me kalimin e kohës në këtë drejtim do të shfaqen edhe kritikë e para që do të vënë në spikamë punën e pamjaftueshme të diplomacisë dhe politikës së jashtme për sa u përket njohjeve të reja. Në këtë fazë do të fillojnë edhe kritikë e para mbi profesionalizimin, dëmtimin e imazhit nga disa diplomatë dhe mungesës së energjisë dhe efektivitetit përgjithësisht në procesin e njohjes.

Pas pavarësisë, si pjesë e diplomacisë dhe politikës së jashtme do të jetë edhe anëtarësimi i Kosovës në institucionet e tjera ndërkombëtare që përfaqësonin subjekte ndërkombëtare në fushën e sigurisë, ekonomisë, kulturës dhe sportit.

Përballë këtyre institucioneve ndërkombëtare diplomacia e Kosovës do të ndodhet përpara një sfide të vërtetë, sepse anëtarësimi në to do të jetë i komplikuar dhe me shumë pengesa që vinin nga marrëdhëniet, aleancat dhe miqësitë e ndryshme ndërmjet shteteve.

Gjatë kësaj kohe do të dominojnë dy optika vlerësimesh mbi tërë atë që është bërë gjatë kësaj periudhe pas pavarësisë në aspektin e politikës së jashtme të Kosovës. Njëra palë do ta vlerësojë si të suksesshëm gjithë trajektoren e politikës së jashtme dhe të diplomacisë, ndërsa pala tjetër do të vlerësojë së jo gjithçka ka shkuar si duhet dhe se në rrugë e sipër janë shfaqur shumë defekte, të cilat kanë ndikuar në konsolidimin e plotë të politikës së jashtme dhe në afirmimin sa më të madh të Kosovës në arenën ndërkombëtare, qoftë duke shtuar numrin e njohjeve, qoftë duke arritur që të bëhen anëtarësime sa më të mëdha në institucionet e tjera ndërkombëtare.

Pikërisht këto dy optika vlerësimesh tregojnë qartë për rrugën e vështirë dhe me shumë sfida të politikës së jashtme të Kosovës, e cila gjatë tërë kohës është përballur me dy aspekte të disfavorshme, me mungesën e eksperiencës së nevojshme dhe me një kontekst ndërkombëtar ndikimesh dhe ndërvarësish të cilat nuk i jepnin dorë një afirmim më të plotë të Kosovës në planin ndërkombëtar.

Dobësitë e shfaqura pranohen edhe nga një pjesë e diplomatëve, të cilët vlerësojnë se megjithatë ky ka qenë një dimension tepër i komplikuar i reflektimit të sovranitetit shtetëror të Kosovës në planin ndërkombëtar. Pavarësisht nga theksimi i momenteve vendimtare me shumë angazhime shumëplanëshe, gjithashtu theksohen edhe dobësitë e shfaqura në rrugë e sipër, të cilat nga vështrues të tjerë të pavarur vlerësohen si mungesë profesionalizmi, përzgjedhje joadekuate dhe deri tek akuzat për përzgjedhje partiake të stafit të diplomatëve.

Megjithatë, po ashtu theksohet edhe prirja dinamike e diplomacisë së Kosovës dhe sensi për të vështruar brenda punës së vet, që nëkupton edhe korrigjimet në dobi të një politike të jashtme sa më produktive dhe sa më efikase. Gati nga të gjithë theksohet nevoja e një konsolidimi të përhershëm dhe një përgjedhjeje që do të jetë në funksion të profesionalizimit të plotë të të gjitha shërbimeve diplomatike.

Gjithashtu, nga shumë njohës të kësaj fushe vihet në dukje fakti se edhe politika e jashtme nuk është kursyer nga dinamikat e politikës së brendshme të cilat jo gjithmonë kanë qenë në favor të krijimit të një klime sa më të favorshme për afirmimin e vlerave fundamentale demokratike të shtetit të Kosovës. Në rrugë e sipër janë kritikuar edhe format e diplomacisë dhe politikës së jashtme të cilat janë konsideruar si tepër tradicionale dhe pa energjinë e duhur për të hapëruar në arenën ndërkombëtare.

Në këtë drejtim janë theksuar disa herë mungesat e formave të reja të diplomacisë, të cilat janë më të shpejta, më të dretpërdrejta dhe më efektive në vendosjen sidomos të raporteve bilaterale. Përkundër faktit se ekziston një departament për diplomaci ekonomike, ky dimension tepër i rëndësishëm i afirmimit dhe vendosjes së marrëdhënieve ekonomike me shtetet e tjera ka qenë shumë pak i pranishëm.

Ky fakt theksohet nga diplomatët dhe nga analistët e tjerë të pavarur, të cilët pikërisht në konceptin e lidhjeve ekonomike, shohin edhe mundësinë për përforcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës në arenën ndërkombëtare, edhe një zhvillim më të hovshëm ekonomik në planin e brendshëm, që mbetet një ndër parakushtet kryesore për promovimin e një politike konsistente demokratike dhe për respektim të vlerave fundamentale demokratike në jetën institucionale të Kosovës.

Nga shumë njohës të rrethanave, gjithashtu theksohet kjo ndërvarësi mes politikës së brendshme, gjithë kuadrit të funksionimit të jetës institucionale dhe sistemit demokratik në përgjithësi dhe politikës së jashtme, që në njëfarë mënyrë i reflekton këto situata të brendshme. Jo njëherë është adresuar si problem se pikërisht këto politika të brendshme nganjëherë krijojnë edhe plogështi në diplomacinë e Kosovës.

Sidoqoftë, kohëve të fundit, pavarësisht gjithë këtij vëllimi të punës që identifikohet me politikën e jashtme, gjithnjë e më tepër përmendet një strategji e politikës së jashtme e menduar mirë, e cila duhet të ngërthejë brenda vetes një angazhim më të madh dhe një impenjim më të gjerë dhe me forma më moderne të përfaqësimit. Në këtë drejtim theksohet nevoja që të kalohet në modelin e diplomacisë publike si një koncept më fleksibil dhe më produktiv.

Ky fakt theksohet edhe nga shumë ish diplomatë, të cilët tashmë kanë një përvojë dhe një njohje shumë të madhe mbi artin e diplomacisë dhe politikës së jashtme. Sipas tyre, një kalim i këtillë bëhet i domosdoshëm, sepse është vërtetuar gjithmonë se format klasike të diplomacisë nuk i japin ato rezultate që mund të priten. Ky debat fuqizohet sidomos pas sfidave që akoma e presin Kosovën në planin ndërkombëtar, në procesin e njohjeve, por edhe në atë të afirmimit të subjektivitetit në të gjitha organizmat ndërkombëtarë.

Mes suksesit dhe dobësive që janë kritikuar ka lëvizur diplomacia dhe politika e jashtme e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë. Një rrugë e shkurtër, por me shumë të panjohura dhe sfida të panumërta përpara. Nga të gjithë protagonistët dhe njohësit e kësaj fushe theksohet fakti se politika e jashtme duhet t'i nënshtrohet një konsolidimi permanent, ndërkohë që debatohen edhe strategjitë e reja në fushën e diplomacisë në rrugën afatgjatë të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

3.3.Një dekadë rezultate dhe ngecje

Parametri i parë që ka determinuar politikën e jashtme të Kosovës ka qenë fakti që pas pavarësisë nuk ka mundur të arrihet edhe anëtarësimi në OKB. Ky fakt i ka shtruar sfida të tjera përpara dhe e ka përcaktuar karakterin e politikës së jashtme që mbetet specifik për nga qasja, metodologjia dhe prioritetet. Sipas përfaqësuesve që kanë qenë drejtpërdrejt pjesë e diplomacisë në këtë periudhë, një mangësi tjetër gjatë ka qenë edhe mosnjohja e Kosovës nga të gjitha shtetet e Evropës, me çka e ka

përcaktuar sjelljen ndryshe të diplomacisë. Gjithsesi, mungesa e një tradite e ka pamundësuar një vizion kuptimplotë mbi politikën e jashtme, e cila është dashur të ndërtohet me shumë mund e përkushtim përgjatë periudhës nga viti 2011 deri më vitin 2017. Një parametër tjetër që ka qenë specifik për politikën e jashtme të Kosovës, ka qenë edhe prania e madhe e faktorit ndërkombëtar, e cila e ka kufizuar veprimin e jashtëm, përkatësisht politikën e jashtme të saj.

Sigurisht, këta organizma ndërkombëtarë në Kosovë kanë vepruar gjithnjë në drejtim të fuqizimit të shtetësisë së Kosovës, pra kanë qenë komplementarë me idenë për politikë të jashtme të Kosovës. Si një vështirësi tjetër në konsolidimin e politikës së jashtme të saj theksohet edhe jostabiliteti i brendshëm, ndërrimi i qeverive, zgjedhjet e parakohshme, bllokadat institucionale etj. Të gjitha këto e kanë determinuar politikën e jashtme të saj, e cila në njëfarë formë mbetet pasqyrim i gjendjes së brendshme politike dhe institucionale të një vendi.

Sidoqoftë, pavarësisht nga këto vështirësi të dukshme, aktorët pjesëmarrës në politikën e jashtme bëjnë të ditur se janë përpjekur vazhdimisht që Kosova të vendoset në hartën rajonale dhe ndërkombëtare të marrëdhënieve diplomatike. Në këtë drejtim është dashur të bëhen shumë levizje diplomatike, por edhe të përdoret një diskurs i menduar mirë për të arritur deri të njohjet, për të vendosur një platformë të mirëqenë të politikës së jashtme në përputhje me realitetet specifike të shtetit të Kosovës. Në mesin e shumë angazhimeve të tjera, politika e jashtme e saj është dashur të parashtrojë argumentet e padiskutueshme se pse duhej të njihet pavarësia e Kosovës nga ana e atyre shteteve që ende nuk e kishin njohur.

Gjatë kësaj periudhe, një prioritet tjetër ka qenë anëtarësimi i Kosovës si shtet në organizatat e ndryshme botërore dhe rajonale. Politika e jashtme ka qenë e angazhuar në mënyrë aktive që ta përmbushë këtë mision të anëtarësimit nëpër këto organizata me subjektivitet të plotë shtetëror. Në këtë drejtim Kosova ka patur një traditë të mirë që nga vitet '90, pastaj me UMNİK-un. Prishtina përgjatë një periudhe tetëvjeçare ka pasur shumë marrëdhënie multilaterale, të cilat më pas janë inkorporuar si përvojë në politikën e jashtme. Diplomacia e jashtme ka qenë e përbërë nga njerëz që kanë patur përvojë bashkëpunimi me miqtë ndërkombëtarë

dhe e kjo e ka lehtësuar rrugën e konsolidimit dhe krijimit të një politike të jashtme koherente dhe në sinkroni me pritjet e shtetit të ri të Kosovës.

Pavarësisht nga kjo përpjekje e vazhdueshme, nga gjithë ky mund i investuar në politikën e jashtme, theksohet fakti se në vitet e fundit, pra aktualisht, ka një rënie në këtë aspekt dhe që paraqet një shqetësim serioz. Si fakt përmendet pengesa që bëhet nga ana e Serbisë, për të pamundësuar një politikë të jashtme dhe për ta reduktuar komunikimin ndërkombëtar vetëm në dialogun Kosovë - Serbi. Sipas aktorëve të diplomacisë, kjo situatë është dashur të tejkalohet nëpërmjet një angazhimi më aktiv dhe thellimit të marrëdhënieve bilaterale me shtetet që e kanë njohur Kosovën. Në këtë drejtim vihet theksi te rigrupimet ndërkombëtare dhe te aderimet diplomatike të cilat do të ishin në funksion të këtij realiteti të ri që kërkon më shumë hapje dhe komunikim për të qenë e pranishme Kosova në arenën ndërkombëtare.

Pavarësisht nga këto vështirësi, brenda kësaj kohe Kosova si shtet ka arritur të krijojë marrëdhënie të qëndrueshme ndërkombëtare, duke u mbështetur në specifikat e veta, por njëherazi edhe duke kultivuar një politikë të jashtme aktive dhe një diskurs politik që njeh hapjen dhe angazhimin për një marrëdhënie me BE-në. Fryt i kësaj është nënshkrimi dhe fillimi i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit.

Çështja e mosliberalizimit të vizave shihet në optikën e përplasjeve të brendshme, sidomos tejzgjatja e çështjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, që në masë të madhe e ka vonuar këtë proces.

Gjithashtu, theksi vihet edhe te keqpërdorimi i politikës së jashtme për qëllime të brendshme. Sidoqoftë, besohet se deri në fund të këtij viti mund të bëhet liberalizimi i vizave. Varianti më optimist mbetet që Kosova të udhëtojë pa viza në vitin 2019.

Pavarësisht se si do të përfundojë dialogu mes Kosovës dhe Serbisë, dhe që duhet të përfundojë me njohjen e ndersjellë, aktualisht nga protagonistët e diplomacisë theksohet nevoja për një politikë të jashtme aktive dhe të kultivuar.

Në aspektin rajonal kërkohet një bashkëpunim bilateral në kuptimin politik, ekonomik dhe të sigurisë, një politikë e jashtme që do t'i pamundësonte Serbisë për t'i goditur fqinjët. Në rrafshin evropian mbetet imperativ që të ndërtohet një politikë e nivelit të dyfishtë, të kenë marrëdhënie të mira me politikën me shërbimin e jashtëm të cilin e udhëheqë zonja Federika Mogherini dhe marrëdhënie të mira me Komisionin për zgjerim dhe, mbi të gjitha, me shtetet e Evropës të cilat i determinojnë politikat e jashtme në nivel ndërkombëtar. Pra kërkohet një politikë më aktive me të gjitha shtetet e fuqishme të globit, në mënyrë që të përforcohet dhe fuqizohet subjektiviteti ndërkombëtar i shtetit të Kosovës.

Përgjithësisht vlerësohet që Kosova ka diplomaci të denjë për ta përfaqësuar si shtet, që në aspektin kualitativ është para shteteve të rajonit të cilat kanë një ekzistencë shumë më të hershme. Në këtë drejtim shihet edhe integrimi i Kosovës në BE, që do të varet shumë edhe nga zgjedhjet që do të mbahen atje në vitin 2019. Sipas protagonistëve të diplomacisë së Kosovës, koordinimi me diplomacinë e Shqipërisë gjithnjë ka qenë në nivele të larta, ndërsa me Maqedoninë e Veriut shënohet një komunikim më i ngjeshur dhe më i hapur pas ardhjes në pushtet të kryeministrit Zoran Zaev, përkundër pushtetit të mëhershëm të Nikolla Gruevskit, i cili në politikën e jashtme më tepër ka qenë i orientuar nga Serbia, por për shkak të një presioni të brendshme nga partia shqiptare në pushtet BDI-ja ka qenë i detyruar ta përkrahë Kosovën dhe pavarësinë e saj.

Vlerësohet që brenda këtyre dhjetë viteve, Kosova ka zhvilluar një politikë të jashtme shumë të qëndrueshme dhe me rezultate konkrete. Besohet se kjo dekadë ka përmbyllur shumë nga objektivat e politikës së jashtme, ndërkohë që po ashtu besohet se në dekadën e ardhshme do të përmbillet përfundimisht sovraniteti i njohjes së Kosovës, e kjo e nënkupton edhe dialogun me Serbinë, me ç'rast duhet të merren përgjegjësitë dhe të mos bihet pre e viktimizimit.

Vlerësohet se politika e jashtme duhet të shihet në suaza të një kornize intelektuale. Shtetet e vogla nuk janë vetëm prodhim i kontekstit të brendshëm, i vullnetit politik, identitetit nacional, i aspiratave, por njëkohësisht janë edhe prodhim i kontekstit ndërkombëtar, i cili është në një ndryshim të madh dhe të përhershëm.

Sigurisht, procesi i pavarësisë së Kosovës, i subjektivitetit të saj ndërkombëtar ka kaluar nëpër shumë sfida të cilat nuk kanë pasur një traditë paraprake, por që me shumë angazhim është arritur të vendoset një platformë e gjerë bashkëpunimi në gjithë këtë rrugëtim. Lindja e një shteti është përcjellë me shumë bashkëpunime dhe komunikime ndërkombëtare, pa dyshim, i udhëhequr nga diplomati Marti Ahtisari. Një rrugëtim që njeh përpjekjet e lëvizjes paqesore të viteve '90 dhe të luftës së UÇK-së, por që ende nuk e ka arritur cakun final të njohjes së plotë ndërkombëtare, në të gjitha organizmat dhe nga të gjitha shtetet.

Mes optimizmit për një politikë të jashtme aktive dhe efektive, theksohen edhe ngecjet në vitin e fundit 2018, të cilat duhet të tejkalohen për të patur një konstantë në komunikimet ndërkombëtare që nganjëherë dinë edhe të komplikohen. Si një vlerë qendrore në vëmendjen ndërkombëtare theksohet kreativiteti.

3.4. Konkluzioni i intervistave

Para se të japim konkluzionet e intervistave duhet të theksojmë se si material empirik për punimin tonë janë shfrytëzuar disa intervista me protagonistë dhe njohës të jetës diplomatike të Kosovës. Për intervistat kemi shfrytëzuar një pyetësor unik. Për nevojat e punimit tonë, ne kemi intervistuar ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, Enver Hoxhaj, ministrin e parë të Punëve të Jashtme të Kosovës, Skënder Hysenin, ambasadorin e Kosovës në Malt të Zi, Skënder Durmishin, ambasadorin e Kosovës në Australi, Sabri Kiçmarin, profesorin e lëndës së diplomacisë, Zeqirja Idrizin, shkrimtarin dhe publicistin, Gani Mehmetaj dhe profesorin e lëndës së diplomacisë në Universitetin e Prishtinës, Ibrahim Gashin.

Duke analizuar me vëmendje intervistat e tyre, ne kemi arritur të kuptojmë gjithë trajektoren e diplomacisë së shtetit të Kosovës dhe të gjitha ato objektiva që mbeten sfida të përhershme në horizontin e diplomacisë së saj. Nga ky material empirik, ne kemi mundur që të analizojmë, por edhe të sintetizojmë gjithë momentet reflektuese, por edhe sfidat me të cilat është përballur diplomacia e Kosovë që nga fillimet e saj e deri më sot.

Realisht, politika e jashtme e Kosovës njih tri faza specifike të formësimit, të cilat konvergjojnë në idenë për të njohur subjektivitetin ndërkombëtar të shtetit të Kosovës. Fazat para luftës, gjatë luftës dhe pas shpalljes së pavarësisë, ruajnë brenda vetes angazhime specifike, sfida të shumta të cilat vijnë si rezultat i procesit të formësimit të Kosovës si shtet, por edhe të njohjes në arenën ndërkombëtare me të gjitha sfidat dhe angazhimet diplomatike që shfaqen si imperativ i këtyre periudhave historike.

Së këndejmi, politika e jashtme e Kosovës nuk mund të mendohet jashtë këtyre determinimeve historike dhe aspiratave politike të cilat ndërlidhen me procesin e çlirimit si shtet, por edhe të përpjekjeve që dalëngadalë për ta pushtuar hapësirën ndërkombëtare dhe gjithë spektrin e njohjeve dhe komunikimeve që vijnë në sinkroni me vetë procesin e brendshëm historiko-politik të pavarësimit si shtet.

Mund të konkludojmë që politika e jashtme e Kosovës nuk njih një traditë të konsoliduar të diplomacisë, por në secilën fazë specifike të ekzistencës së saj ka demonstruar një sensibilitet ndërkombëtar që ndërlidhet me kontekstin e dhënë të një procesi historik të formësimit si shtet, duke arritur kështu që t'u përgjigjet me shumë përgjegjësi raporteve të komplikuar ndërkombëtare, por edhe duke arritur që në vazhdimësi ta rrisë kualitetin e përfaqësimit diplomatik si një dimension kryesor i njohjes së Kosovës si entitet i mëvetësishëm historik dhe si realitet i një shteti të pavarur që nga viti 2008.

Politika e jashtme e Kosovës, kuptimin e mirëfilltë të saj e fiton pas shpalljes së pavarësisë dhe determinohet nga "Pakoja e Ahtisarit" si dokument ndërkombëtar që performon gjithë planimetrinë e shtetësisë dhe raporteve ndërkombëtare si politikë e jashtme.

Faza e parë e politikës së jashtme pas pavarësisë përcillet me shumë sfida dhe me shumë angazhime për t'i vendosur themelet e një koncepti të ri të diplomacisë që transponohet dhe mbindërtohet mbi atë trashëgimi të hollë paraprake, duke konvergjuar edhe me diplomacinë e shtetit shqiptar si përvojë dhe si sinkronizim në raportet e gjera dhe tepër komplekse në arenën ndërkombëtare.

Gjithë kjo fazë e nënkupton trajnimin dhe inkuadrimin e një stafi profesionist që me shumë entuziazëm dhe përkushtim arrin të mbarështojë rrugën e njohjes ndërkombëtare të Kosovës si shtet. Kjo fazë e nënkupton edhe vendosjen e shumë marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale si forma specifike të funksionimit të politikës së jashtme, por edhe anëtarësimin e Kosovës në shumë organizata ndërkombëtare të cilat e përforcojnë dhe e bëjnë të suksesshme diplomacinë e Kosovës.

Gjithë trajektorja e politikës së jashtme të Kosovës pas pavarësisë njih një funksionim shumëplanësh dhe angazhim në shumë drejtime për të konsoliduar një diplomaci konform realitetit historiko-politik dhe konform njohjes sa më të plotë të subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit. Kjo diplomaci njih sfidat dhe lartësinë e përgjegjësisë dhe njih angazhimin permanent për të kultivuar një politikë të jashtme koherente dhe kualitative, që si e tillë mbetet më përpara prej shteteve të rajonit.

Politika e jashtme e Kosovës, gjithashtu i njih edhe vështirësitë e veta, rënien e intensitetit, por në asnjë rast duke mos e humbur fokusin kryesor të një diplomacie kreative dhe shumëdrejtimëshe. Kompleksiteti i marrëdhënieve ndërkombëtare që ndërlidhet edhe me mosnjohjen nga shtete të caktuara, e vendos politikën e jashtme të Kosovës në një situatë dinamizmi të përhershëm të marrëdhënieve me BE-në, por edhe me shtetet e tjera që duhet ta njohin subjektivitetin ndërkombëtar të shtetit të ri. Në këtë drejtim shfaqen edhe sfidat e radhës, të cilat kërkojnë angazhime dhe përkushtime të tjera profesionale, por edhe kualitete reprezentimi diplomatik, gjithnjë në përputhje me vlerat më të larta të artit të diplomacisë dhe gjithnjë në përputhje me standardet e vendosura nga gjithë matrica e diplomacisë ndërkombëtare.

Politika e jashtme e Kosovës brenda kohës ka njohur një afirmim qenësor, ndërkohë që para saj shtrohen edhe shumë angazhime të tjera, nganjëherë të komplikuar, përmes të cilave rrugëton vetë subjektiviteti ndërkombëtar i shtetit të Kosovës.

4.Përfundime

Diplomacia konsiderohet si forma më e vjetër e komunikimit ndërmjet shteteve. Kur flitet për të, vetvetiu mendohet edhe për politikën e jashtme.

Vetë nocioni diplomaci përdoret në situata kur një i dërguar special nga shteti sovran sjell një dokument të mbështjellë (të fshehur, i paqasshëm për gjithkënd) dhe i autorizuar për t'ia bartur një sovрани tjetër, ndërsa njëkohësisht diplomacia publike duhet t'i sigurojë shtetit të saj sa më shumë liri për aktivitete në komunikimin ndërkombëtar. Diplomacia paraqet udhëheqje negociatash ndërmjet njerëzve, grupeve apo kombeve. E përdorur në formë formale, ajo ka të bëjë me diplomacinë ndërkombëtare, udhëheqjen e marrëdhënieve ndërkombëtare zakonisht me ndërhyrjen e diplomatëve profesionistë. Ekziston dallim i rëndësishëm midis diplomacisë dhe politikës së jashtme, edhe pse ato janë të lidhura ngusht midis tyre, janë komplementare dhe të domosdoshme me njëra-tjetrën. Politika e jashtme i përgjigjet zgjedhjes strategjike dhe politike të organeve më të larta shtetërore. Sa i përket diplomacisë, ajo paraqet zbatim të kësaj politike të jashtme me ndërmjetësimin e diplomatëve. Diplomacia publike ka për detyrë ta përforcojë pozitën e shtetit në skenën ndërkombëtare, duke i krijuar vendit përparësi dhe aleatë, e njëkohësisht duke i zbrapsur qëllimet e kundërshtarëve.

Politika e jashtme ose politika në përgjithësi është program veprimi, të cilin e realizon një shtet në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare, kurse diplomacia do të ishte metoda me ndihmën e së cilës kjo politikë mund të realizohet në praktikë. Pra, diplomacia nuk mund ta krijojë politikën e jashtme, por ajo e transmeton, e shpjegon, negocion dhe e përfaqëson vijën themelore politike të një shteti.

Rëndësia e këtij hulumtimi konsiston në faktin se Kosova si shteti më i ri vazhdon ende të jetë në fazën e krijimit të institucioneve të veta, të përpjekjeve për të arritur më tepër njohje të reja nga më shumë shtete dhe përmirësimin e imazhit të shtetit më të ri nëpër botë, meqë avancimi i sa më shumë njohjeve të Kosovës është një faktor determinues që ajo si shteti më i ri të bëhet faktor i rëndësishëm i paqes, i stabilitetit dhe i progresit në rajon dhe më gjerë, me çka do t'ua hapte rrugën integritimeve euroatlantike dhe do të kishte efekt mjaft pozitiv në zhvillimin e vendit në të gjitha sferat.

Diplomacia konsiderohet si forma më e vjetër e komunikimit ndërmjet shteteve. Format e para të krijimit të diplomacisë i hasim qysh në periudhën e bashkësive fisnore të cilat kanë qenë të afta jo vetëm për komunikime luftarake, por edhe për negociata e marrëveshje. Për zhvillimin e diplomacisë rol të rëndësishëm kanë patur qytetet-shtete greke.

Me anë të këtij hulumtimi konstatojmë se diplomacia që nga format e para të krijimit të saj e deri më sot, ka pësuar ndryshime të shumta, p.sh. kanë ndryshuar metodat e veprimit të përfaqësuesve. Përderisa në kohën e monarkive feudale kërkohet që të ishin oborrtarë të gatshëm për realizimin me sukses të detyrave, sot nga një diplomat kërkohet të ketë një arsim të gjerë, të flasë gjuhë të huaja, të ketë njohuri për rrethanat politike, ekonomike, kulturore, gjithashtu të ketë edhe një komunikim më të mirë për të arritur rezultat të mira për vendin etj. Tanimë është rritur edhe numri i personelit të cilët janë të angazhuar në përfaqësitë diplomatike, njëkohësisht është rritur edhe numri i organizatave ndërkombëtare etj.

Diplomacia kosovare ka korrur sukses, ndonëse të pjesëshëm, por në masën më të madhe është histori e suksesit. Kosova ka një shërbim diplomatik të lakmushëm, por që ende duhet të zhvillohet. Natyrisht se ka ende shumë punë për t'u bërë që të thuhet se kemi një shërbim të shkëlqyer.

Kosovës i duhen më shumë njohje të reja, por janë një numër arsyesh për mosarritjen e një shkalle më të madhe të tyre, për faktin se dy nga vendet anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit (Rusia dhe Kina) nuk e kanë njohur Kosovën.

Kosova është pranuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit. Serbia është ankuar dhe e ka vënë në dyshim legalitetin e aktit të vendimmarrjes dhe kjo do të shqyrtohet, por Kosova nuk e humb të drejtën e anëtarësisë.

Kosova ka ndërtuar marrëdhënie të mira me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe synon anëtarësimin në Unionin Evropian dhe në NATO, që të fitojë garanci shtesë për sigurinë dhe zhvillimin e vendit.

Si shtet më i ri, Kosova ende po përballet me vështirësi. Dhe në këtë rast ajo duhet të mësojë nga përvoja e vendeve të tjera, me anë të së cilës do të identifikojë disa segmente më specifike të cilat do të kenë prioritetet në politikën e jashtme të saj.

Bashkimi Evropian nuk është më ai që ka qenë në vitin 2012, kur Kosova e kishte marrë udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave. Kjo organizatë shpejt mund të përballet me zgjedhje të brendshme, të cilat do të ndikonin në raport me vizat për Kosovën. Kështu vlerëson zëvendëskryeministri i Kosovës Enver Hoxhaj, në një intervistë dhënë gazetës “Express”, i cili thotë se kjo është mundësia e fundit që duhet shfrytëzuar. Ish ministri i Punëve të Jashtme, sqaron edhe çështjen e Surinamit dhe propagandën e shtetit serb në raport me njohjet ndaj Kosovës. Po ashtu Hoxhaj flet edhe për demarkacionin e kufirit, pozitën aktuale të PDK-së pas zgjedhjeve, sikurse edhe dialogun Kosovë- Serbi.

5. Bibliografia

- ❖ Abdullahi, Jonuz, „Politika dhe Politika Publike“, Universiteti i Evropës Juglindore, Botimi i dytë, Tetovë, 2011
- ❖ Abazi, Hajdin, Diplomacia - Disiplinë e mëvetësishme, Trendi Global, Revistë shkencore, Prishtinë 2009
- ❖ Bashkurti, Lisen “Diplomacia shqiptare”, Diplomacia e vetizolimit , Vëllimi III, Geer, 2004
- ❖ Bajrami , Arsim “Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës” Prishtinë, 2011
- ❖ Bajraktari, Halim “Roli dhe perspektiva evropiane e Kosovës, Punim doktore, Tiranë, maj 2014
- ❖ Buja, Ramë “Konferenca e Rambujesë”, Prishtinë, 2006
- ❖ Beka, Adem “Shtetndërtimi dhe Paqendërtimi” - Ambiguiteti kreativ si politikë e administrimit ndërkombëtar në Kosovë, Specializimi; Shkenca Politike, Qershorë, 2016
- ❖ Baliqi, Bekim, „Hyrje në Diplomaci dhe Politikë të Jashtme“, Prishtinë, 2010
- ❖ Eric Neumayer, Distance, power and ideology: diplomatic representation in a world of nation-states, UK, 2008, p 228
- ❖ Haxhimehmeti, Gjenis, “Politika e Jashtme e Shteteve të Vogla”, ISPN, Shkup, 2016

- ❖ Hoxhaj, Enver „Ngritja e një shteti“ Politika e jashtme e Kosovës, Tiranë 2016
- ❖ Idrizi, Zeqirija, “Historia e Diplomacië” Prishtinë, 2013
- ❖ Hajrullahu, Ismet, “Lufta e fundshekullit XX për Kosovën” Prishtinë, 2012
- ❖ Jazbec, Milan, ”Bazat e Diplomacisë”, Tetovë, 2017
- ❖ Buxhovi, Jusuf, “Kosova –VI 199-2001 Lugina e Preshevës, Maqedonia” , Faik Konica-Prishtinë, 2018
- ❖ Jacson Robert & Sorensen Georg “Hyrje në marrëdhëniet ndërkombëtare – Teoritë dhe qasjet, Tiranë, 2013
- ❖ Kiçmari, Sabri, “Hyrje në Diplomaci”, Kolegji Universitar Victory, Mars, 2011
- ❖ Kiçmari, Sabri, “Bazat e Diplomacisë” Kolegji Universitar “Victory” Mars, 2011
- ❖ Krasniqi, Milazim, “Publicistika”, Vepra 7, Tiranë 2012
- ❖ Latifi, Veton, “Shekulli i ri i Politikës Shqiptare”, Tiranë, 2014
- ❖ L. Phillips David Çlirimi i Kosovës “ Diplomacia këmbëngulëse dhe ndërhyrja e SHBA-ve”, Tetovë, 2015
- ❖ Mehmetaj, Gani, “Sifdat e Pavarësisë”,Titanic, 2009
- ❖ Marleku, Alfred, “Shtetet e Vogla dhe Sigura Ndërkombëtare”, Punim Doktorate, Shkup 2016
- ❖ Nikolsoni, Sër Harold “Diplomacia”, Prishtinë, 2005
- ❖ Petric, Ernest, „Politika e Jashtme“, Prishtinë, 2012

- ❖ Reka Ylber, Bardhok Bashota, Ylber Sela, “Marrëdhëniet Ndërkombëtare“,
Instituti për studime politike dhe ndërkombëtare, Shkup, 2016
- ❖ Smith Steve, Hadfield Amelia, Dunne Tim, Foreign policy theories, actors,
cases, Oxford, University press, 2008
- ❖ Stavileci, Esat “Vepra XVII Pavarësia e Kosovës – fakt juridik që nuk mund të
zhbëhet – Dëshmi për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë”, Prishtinë, 2013
- ❖ Vukadinoviç, Radovan, “Marrëdhëniet Politike Ndërkombëtare”, Kolegji
“Victory” Prishtinë, 2006
- ❖ Vladimir, Benko, “Znanost o mednarodnih odnosih“ Lublanë, 1997
- ❖ Vukadinovic Radovan, Cehulic Lidija “Ideja Evropiane nga Karli i Madh deri te
Unioni Evropian”, Shkup, 2017
- ❖ Zenelaj, Eqrem, “Historia e Diplomacisë”, Shtëpia botuese “Vatra”, Prishtinë,
2013
- ❖ Z. Cana, “Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912”, Tiranë, 1982

Burime nga Interneti:

- ❖ <http://forumi.shqiperia.com/threads/mbreti-ahmet-zogu.15392/page-3>, rigjetur më 08.09.2017
- ❖ Neni 84 {Kompetencat e Presidentit}, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor, 2008
- ❖ Neni 93 {Kompetencat e Presidentit}, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor, 2008
- ❖ <http://www.mfa-ks.net/?page=1%2C37>, rigjetur më 17.09.2017
- ❖ <http://www.mfa-ks.net/?page=1,171> dt: rigjetur më 03.09.2017
- ❖ <http://www.mfa-ks.net/?page=1,67> dt: rigjetur më 03.09.2017
- ❖ <http://www.mfa-ks.net/?page=1,217,4447> rigjetur më 15.10.2017
- ❖ <http://www.gazetaexpress.com/intervista/bernard-kouchner-nuk-me-shqetesojne-idete-e-bashkimit-te-shqiptareve-256624/> rigjetur më 12.10.2017
- ❖ <http://zeri.info/zerat/123717/politika-e-jashtme-e-kosoves-dhe-faktori-kohe-ne-vitin-2017/> rigjetur më 08.12.2017